G J O K Ë D A B A J

K R I Z A E A R K I V I S T I T

(K R O N I K Ë B E O G R A D A S E)

~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

R O M A N

~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

“Sërbi, o nëna ime…!”

(Gjysmë vargu nga shënimet e Predrag Jovanoviqit)

~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

PARATHËNIA

Qëllimi i këtij romani është, që të pasqyrojë figurativisht, por gjithsesi me vërtetësi, pjesë të një të vërtete historike, në një hapësirë gjeografike të përcaktuar, pra në Beograd, kah fundi i shekullit XX. E kam konsideruar të domosdoshme që, sado kudo, të kontriboj në ndriçimin e një realiteti tejet të pandriçuar. Popujt e Ballkanit janë të thirrur që, më në fund, të kthjellohen. Vetë shprehja ***të***
~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

kthjellohen, nënkupton, në radhë të parë, njohjen e të vërtetavet. Vetëm atëherë kur popujt e Ballkanit do t'i kenë njohur të vërtetat, si të vetat, ashtu edhe rreth vetes, ata do të mund të ndërmarrin hapat e nevojshëm, edhe për ta përsosur vetëveten, edhe për t'u afruar njëri me tjetrin.

Konsideroj që këtë roman duhej ta kishte shkruar para meje psh një qytetar i Beogradit. Por nuk ka ndodhur kështu. Megjithatë, mendoj që thelbi i gjithëdobishëm i qëllimit tonë nuk ndryshon. Unë jam shqiptar për nga kombësia, por në veprat e mija nuk i kam kursyer kurrë, dhe as që kam ndërmend t'i kursej cilatdo dukuri negative në kombin tim. Përkundrazi, atje ku e kam parë të nevojshme, jam shfaqur dukshëm i rreptë. Prandaj, sado që kjo vepër e imja të duket e rreptë, unë i garantoj të gjithë lexuesit e mi shumë të nderuar që në mua nuk ka dhe kurrë nuk do të ketë asnjë thërrime shovinizmi.

Thelbi i kësaj vepre letrare, siç e thashë, është e vërteta historike e lakuriqtë, mirëpo, duke qenë kjo, një vepër letrare, një rikrijim i realitetit, vetëkuptohet që edhe personazhet e saj, ngjarjet, mjediset gjeografikë e urbanë, duhet të merren si një ansambël letraro-artistik. Kjo do të thotë që aty, për shembull, emrat e njerëzvet, pranemrat, emrat e vendevet etj, nuk duhen semplicizuar, sikur të ishin adresime konkretë. Synimi i romanit nuk është që të fyhet dikush, as si person e as në grup personash. Biles, edhe të përmendurit aty-këtu të ndonjë personi historic, nuk ka për qëllim të akuzojë, gjegjësisht të godasë dikënd personalisht, por ka për qëllim që, edhe me këtë formë të konkretizimit, të paraqesë sa më me besnikëri të vërtetat, në një kohë dhe në një vend të përcaktuar.

Po shpresoj që lexuesi im shumë i nderuar, gjatë leximit të këtij romani, do t'i ketë të gjitha këto parasysh.

Gj.D.

VORBULLAT QIELLORE

Nëpër rrugët e Beogradit këmbësorët lëviznin ngutshëm dhe çuditërisht pjerrtas. Përpiqeshin t'i mbronin veshët e vet dhe hundën, duke ngritur përpjetë jakat. Supet i nxirrnin përpara, herë të djathtin, herë të majtin, dhe afroheshin ashtu pikësynimevet të tyre thuajse duke vrapuar: shitores, pijetores, veturës, tramvajit,

zyrës. Dukej sikur, atë mëngjes, beogradasit s'kishin tjetër problem përveç erës dhe të ftohtit.

Gjyqtari hetues Risto Kilibarda, me gjithë dimrin e papërballueshëm, i cili ia shtinte të ftohtit gjer në palcë, nuk harroi të blejë, si dhe çdo ditë, tufën e gazetavet. I mori gazetat, por nuk arriti të lexojë as edhe një titull. Në ditët kur qielli do të ishte më i qetë, ai detyrimisht do të ndalej në mes të trotuarit, për t'i parë të paktën titujt kryesorë.

Pak vite më parë, kur pat punuar te Palillulla, Ristoja do të qe kthyer majtas te Jug Bogdanova, do të kish përshkuar një pjesë të Brankovës, një pjesë të Prizrenskës dhe një pjese të bulevardit Kral Aleksandar, pastaj sërish majtas, nëpër Takovska te Cvijiqeva dhe nëpër Cvijiqevën e te Gjura Gjakoviqa dhe djathtas, drejt te SUP-i në Palillullë. Tash, i duhej ta ngiste makinën goxha gjatë nëpër bulevardin Kral Aleksandar, deri sa të mbërrinte te rruga e Gospodar Vuçiqit. Aty do të merrte në të majtë nëpër të Gospodar Vuçiqit dhe do të arrinte ashtu te ajo ndërtesa që ai i thoshte ***"Te Trarët".***

Në të vërtetë, ky ishte Burgu Qendror i Beogradit, të cilin e përbëjnë 5 ngrehina. I quante ***trarë***, sepse ishin shumë të gjata, të vendosura paralel njëra me tjetrën dhe, shikuar së sipërmi, ngjanin me trarë më shumë se me çdo gjë tjetër. Korniza katërkëndëshe, te e cila mbështeten ndërtesat në formë trarësh, përbëhet prej një numri objektesh që I shërbejnë burgut, kuzhina, magazina, salla ngrënieje, zyra, kapanone për grupet e sigurisë, banja, lavanteri, axhusteri, rrobaqepësi, zdrukthtari, krejt ç'mund dhe i duhet një burgu dhe një numri të madh të burgosurish. Është një vepër e përkryer inxhinierike e ndërtimore, me të cilën Beogradi s'ka si të mos krenohet. Gjithë kohën plot e përplot me shkelës të ligjevet, me të pandehur dhe me të dënuar.

Është rrokullisur deri te korridori si një thes i mbushur me kashtë. Krejt qenien po ia përshkonte përshtypja e një thesi të mbushur me kashtë. Atë thes me kashtë po e çonin vorbullat nga të donin... Të ftohtit, atë produkt të çekuilibravet të qiellit, iu mbishtua papritur edhe trishtimi i shpirtit, produkt i çekuilibravet njerëzorë... Edhe këtë herë, si përherë, ish pësëritur grindja midis të birit, Cvetkos, dhe të atit, Miqunit, tashmë të tejplakur. Grindjen e kish acaruar, si përherë, ndërhyrja e pamend e së shoqes, Darinkës.

NUK KAM NERVA

Ia pat përgatitur të jatit kafen dhe gotën me raki rrushi. (Darinka kish vite që nuk i shërbente më, as me kafe, as me gjë tjetër, të vjehrrit.) Cvetkoja sapo ishte zgjuar, sepse kish luajtur në kompjuter deri vonë, deri pas mesnatës. Miquni po e shikonte me ngulm të nipin, me mendjen kushedi se ku, dhe, papritur, në mënyrë qartësisht provokuese, ia nisi deklamimit:

"Malazi, o mbret i vogël,

Kush këtu nuk të lëvdon!"

("Cërrnogorçe, care mali,

Ko te ovde josh ne hvali!")

Aty dhe filloi zënka. Cvetkoja nuk ndjehej malazias. Kish lindur në Beograd, shkollohej në Beograd. Gjysh Miquni mbronte pikëpanjen që njeriu mund të lindë edhe në anije, duke lundruar nëpër det, edhe në qiell, duke fluturuar me aeroplan përsipër malevet, e megjithatë nuk do të ish normale që dikush ta konsiderojë veten peshk nëpërujës apo zog fluturues. E krahasonte Cvetkon me nipin tjetër, lindur në Zvicër. „***Krahasoje veten me kushëririn tënd. Ai ka lindur në Bern, shkollohet në Bern, por nuk ndjehet kurrsesi zviceran." „Sërbët dhe malazezët flasin gjuhë të njëjtë." „Nuk është krejt ashut. Ne kemi gjuhën tonë, sado që i ngjan gjuhës sërbe." „Atëherë përse gjysma e malazezëve deklarohen sërbë?!" „Nuk e di!"***

Në atë çast ishte përzier edhe Darinka: „***Po kur nuk e di, përse po llomotit?!"*** Ish përzier edhe Ristoja: „***Darinka, të lutem! Mos e ofendo***!" „***Unë kurrsesi nuk po e ofendoj! Ai më ofendon mua tash më shumë se 10 vjet! Ai nuk është njeri normal! Ai është një vampir! Ai është një marran dhe kaq!***" Nuk i është përgjigjur askush. Kjo e ka nervozuar edhe më. ***"Risto, të lutem shumë, ndaloja llomotitjet! Nuk kam nerva për ta dëgjuar! Kam plot brenga të tjera! Nuk po mund ta dëgjoj as veten, le më të dëgjoj edhe këtë!!"***

Në të vërtetë, Darinka nuk kish kurrfarë brengash. Ajo ia krijonte vetëvetes brengat. Ristoja e dinte këtë prej kohësh.

RRUFA

Megjithse në makinë, me ngrohje dhe me xhama të mbyllur, Risto Kilibarda po mërdhinte. Nga skajet e trotuarevet, ku ishte ngurtësuar në formën e borës së shkelur, po i vinte akulli dhe po i hynte brenda trupit, nëpërmjet syvet ose me

ndonjë tjetër rrugë. Pastaj, nga brendësia, të ftohtit ia mësynte drejt lëkurës në formën e mornicavet. I ndiente të rrënqethurat ligështuese veçanërisht në shpinë dhe në ije.

Ishte e hënë. Fillimi i javës së punës. Kushedi sa vrasje janë paraqitur në ndërkohë, sa përdhunime, sa vjedhje, sa plagosje reciproke të dehurish, sa tradhti bashkëshortore, kurorëzuar me tentativa për vrasje apo vetëvrasje! Kinse pushime! Fundjavë grindjesh e ngatërresash! Buzëqeshi me ironi. Ish i sigurtë që do ta gjente mbi tavolinë, si çdo të hënë, një dosje të trashë plot me gjak. Megjithatë, u përpoq të grumbullojë sado pak shpresë, ndërsa po i tkurrej shpina sikur po derdhej sipër tij bora e të gjitha çative dhe e të gjitha tarracave të kryeqytetit. Bora, në shtresa të trasha, gjendej pikërisht atje, mbi çati dhe mbi tarraca. Ndërsa poshtë, në thellësi të rrugëvet, gjendeshin, si të thuash, vetëm rrënjët e asaj bore: akulli dhe të ftohtit e hidhur. Dimri më i hidhur që njerëzimi e mbante mend.

E pa veten në pasqyrë. Ish vërtet çehrevrarë dhe tepër i ftohur. S'kish kurrfarë disponimi. „***Trishtim.***" Murmuriti duke kaluar nëpër mendje shtëpinë e vet. „***Lashë prapa një tufë fjalësh të vrazhdëta të sime shoqeje, kam përpara një tufë fletëkallëzimesh, plot me thika, me plumba dhe kushedi me çfarë tjetër.***"

Bulevardi i gjërë dhe shumë i gjatë i Kral Aleksandrit, ish përplot me makina, edhe ato, sëmurë nga rrufa. Zhagiteshin me marsh të parë e gaz fare të ulët, si kolonë mortore. Hetuesia gjendej diku në të majtë, pas atyre bubrrecave emramëdhenj, por zvarritës: Folksvagen, Zastava, Fiat, Micubishi, Fiqo. Fiqoja i ynë, prodhim vendi!

MENÇURIRA (NË VAZHDIME)

Hyri në zyrë dhe i tha menjëherë Borkës që t'ia përgatisë një aspirinë dhe një çaj të nxehtë, mundësisht të valë. Mundësisht të skuqur! Iu lajmërua shefit në telefon dhe iu lut që të mos e ngarkonte si ditësh tjera. "***Sot më jep sa më pak, sepse të jam ftohur keqas. Mund të merrja edhe raport mjeku." "A ke temperaturë? Futja çaj edhe raki!***" "***Ashtu edhe porosita. Por me aspirinë, jo me raki***." Ristoja heshti, pastaj e pyeti shefin në vend të falenderimit: "***A ka ngjarje?" "Plot***." Iu përgjigj shefi. "***Në një ditë të këtillë me akull s'ka shans që qytetarët tanë të jenë më të mençur. Do të çuditeshim për të kundërtën***."

Sekretarja ia solli aspirinën. Ristoja e pa atë kokërr të bardhë midis gishtavet të saj thonjgjatë dhe i vetëtiu në ballë një rreze shprese. "***Kimia! Qe, pra! Kimia ka për të bërë tani një mrekulli të vogël në trupin tim. Do të m'i skuqë e do të m'i purpurojë indet, ngjashëm me manaferrën, dhe do të duket sikur jam shëruar."*** E përsëriti shprehjen "***do të më duket***".

Te hyrja e hetuesisë, midis, sipas tij, ***"traut"*** të parë dhe të dytë, pak parë kish pasë rastin të përshëndetë pikërisht njërin prej këtyre mrekullibërësve. Njërin prej kimistëvet më në zë në krejt Beogradin. Ishte Prof.Dr.Velko Velimiroviqi. "***Kimist i fortë***!" Mendoi Ristoja, duke e hedhur kokërrzën e aspirinës në fytin e vet. Pastaj e mori në tabaka një gotë porcelani goxha të madhe. Avulli i nxehtë ia mbushi hundët dhe gojën. Atëherë, ndërsa po i përhapej tretësira e aspirinës nëpër trup, duke ia larguar disi të rrënqethurat dhe dridhjen, Ristos i pëlqeu të filozofojë nga pak. „***Psikiatër, kimist, profesor-doktor, njeri i lumtur në kuptimin më të kuptimshëm të kësaj fjale! Në të vërtetë, një mjek i zakonshëm burgu! Shkencëtar me famë dhe kriminel me famë! Profesion mjeku, i përdorur në luftë! Dituri dhe talent kimisti në shërbim të shtytjes, nxitjes sonë kombëtare. Jo për të asgjësuar ushtritë armike, por për të sakatuar nervat e fëmijëvet të armikut! Fëmijëvet të armikut tonë të brendshëm, i cili synon potencialisht të na bëhet armik i jashtëm!"… "Ti, Borka, ç'mendon për të gjitha këto?"*** Tha me zë, ndërsa hunda dhe buzët i qenë puprruar me bula djerse. ***"Për çfarë?!"*** Pyeti e habitur sekretarja. ***"A mundet që njeriu të jetë hero, pa qenë njëkohësisht edhe kriminel?"*** Sekretarja rrudhi krahët dhe buzëqeshi ëmbëlsisht. ***"Ah, ti nuk i merr vesh fare këto punë! Je krejt analfabete në filozofi… A ke bërë dopak dashuri në këto 2 ditë?*** "Ajo buzëqeshi sërish me fytyrën e saj veçanërisht të freskët dhe të ndritur. ***"A mundet që njeriu të ketë plot ndodhi dashurore e të mos ketë edhe plot tradhtira?" "Ou!"*** Bërtiti vajza. ***"S'ka 'ou'! S'ka kurrfarë 'ou'!"*** Vazhdoi me ngulm Ristoja. ***"E marrim me mend që ti je një dashnore tepër e këndshme. Ashtu siç edhe je në të vërtetë. Por, nëse e ndërron të dashurin, o engjëlli im, ti automatikisht shndërrohesh në një tradhtare të pashpirt. Krijesë parajse, e cila u sjell mjerim viktimavet të veta!" „Po nëse jam unë ajo viktima?!"*** Pyeti vajza.

Pasoi një heshtje mjaft e gjatë. Borka dukej se priste një përgjigje. Ristoja nuk donte të thellohej më në atë drejtim.

„***A e njeh Velkon?***" Pyeti papritur. „***E njoh. E pse?!***" Iu nënshtrua Borka vijës bisedore të Ristos. „***Nuk e njeh! Nuk e njeh sa duhet***." E kundërshtoi Ristoja. ***„E di, or burrë, çka do të thuash! Është autori i helmimevet masivë të fëmijëvet në Kosmet." „Je krejt e përpiktë!"*** Gati sa s'thirri Ristoja, pothuaj me entuziazëm. ***„Ka bërë që kalamajtë e shqiptarëvet të hidhen përpjetë duke qarë dhe të qajnë duke u hedhur përpjetë. Ka qenë dhe është kryevepra e tij!"*** Askush s'ish në ata çaste dëshmitar sypamës: A kanë buzëqeshur apo janë zymtuar në fytyrë Ristoja dhe Borka në atë mbarim dialogu?

Sërish u bë një heshtje. Ristoja e vendosi gotën mbi tabaka. Borka po shfletonte disa shënime procesverbalesh. Lexonte, siç dukej, titujt apo fjalët aty-këtu dhe shfletonte thuajse kot. As Ristoja nuk po mund të punonte asgjë. Por, në anë tjetër,

të ndenjurit pa punë po ia shtonte edhe më shumë mërzitjen. ***„Pse s'na paska ardhur sot Momoja?"*** Pyeti, për ta plotësuar disi boshllëkun mërzitës. ***„Sa është dukur dhe ka shkuar në një këqyrje."*** E sqaroi Borka, pa e ndërprerë shfletimin.

PËR Ç'LLOJ PISLLËKU ËSHTË FJALA?

Më 11 e 25 ra zilja e telefonit. Ishte kryehetuesi. ***„A i dëgjove sirenat?" "Cilat sirena?" "Sirenat e milicisë... Ka ndodhur një vrasje e paparë dhe e padëgjuar!.. Je vetëm ti i lirë. Më vjen keq... Më the që ishe pa qejf."*** Ristoja i ndjeu djersët mbi ballë dhe në shpinë, por njëheresh edhe u lehtësua, se, megjithatë, i doli një punë. Një dosje të dundit që kish pasur në dorë, ia kish dorëzuar tashmë gjykatës. „***Epo mirë."*** I tha shefit. „***Na qoftë për hajr!"*** E mbylli telefonin dhe shtoi, pa e ditur, po i fliste vetes apo sekretares: „***Pikërisht tani më kanë mbuluar djersët. Çaji ishte i shkëlqyer.***"

Nuk po i pëlqente që, në këtë farë dimri, të merrej me ngjarje të rënda, sidomos me ngjarje që, siç iu tha, i kish vënë në punë sirenat e milicisë. Nuk e mbante mend, nuk po i kujtohej, sa vite kish që merrej me krimet e rëndë. Ish marrë me ato punë vite me radhë. E ngarkonin shefat, sepse besonin në aftësitë e tija. Mirëpo, këtë herë, s'ia kish ***"fajin"***shefi. Vetë i qe lutur për ta kursyer.

Shumica e lëndëvet, me të cilat qe marrë ndër vite, kishin qenë të vështira e shumë herë edhe tepër të vështira. Vrasje pa arsye, vrasje me pak arsye, vrasje për para, vrasje nga xhelozia, vrasje për shkak të trashëgimisë, për poshtërime, vrasje mafioze, vrasje, si vazhdim ***"i natyrshëm"*** i të rrahuravet me grushta dhe me karrike. Secila vrasje është e rëndë. Por, përse kryehetuesi këtë herë e theksoi aq dukshëm: "***Vrasje e paparë dhe e padëgjuar***"?! Ç'vrasje do të mund të ishte kjo?! Kryehetuesi s'para i përdorte të tilla shprehje.

Ristoja e pa goten e çajit. Kish kohë që rrinte e zbrazët. Nuk po i kujtohej: kish pirë atë mëngjes 2 apo 3 gota. I ndjeu prapë djersët poshtë qafës. Te shtëpia do të qe ndërruar. Iu lut Borkës që t'ia fërkonte shpinën me një peshqir. U pa prapë në pasqyrë. Këtë herë në pasqyrën e tavolinës. Ish tepër i skuqur, me buzë të fryra, me hundë të zmadhuar dhe me mollëza të ënjtura. "***Jam i mardhur si një patate***." Murmuriti brenda vetes.

Vendosi të mos shkonte me vrap në këqyrje, siç bënte zakonisht. I telefonoi milicisë. Kërkoi përshkrimin e ngjarjes, fotografitë, të dhënat e zakonshme profesionale, si dhe urdhërin e arrestit. „***A e ka kryer milicia arestin sipas ligjit?" „Po, por kryerësi i krimit po e kundërshton arrestimin me ngulm."*** Ristoja qeshi në mënyrën siç qeshet rendom në telefon. Oficeri i milicisë, siç duket, e kuptoi përmbajtjen ironike të asaj së qeshure. E njihte Dr.Risto Kilibardën prej vitesh,

prandaj dhe nxitoi për ta sqaruar: ***„Dihet që askujt s'i pëlqen të mbërthehet në hekura. Por ky po na kundërshton me mënyra tepër të çuditshme. Ka vrarë bashkëshorten e vet, bijën e vet dhe djalin e vet, dhe po e quan veten hero e po shpreh habi, përse ky heroizëm i tiji, në shërbim të atdheut, nuk po kuptohet.“*** U përsërit e njëjta e qeshur nga ana e oficerit të milicisë. Por Ristoja e ndërpreu disi rrëmbyeshëm dhe i kërkoi që t'ia përcillte të dhënat e kërkuara.

„***I ka kasaposur që të gjithë! Kushedi për çfarë pisllëku bëhet fjalë***!" I tha Borkës dhe iu lut që t'ia fërkonte edhe njëherë kurizin me peshqir.

RUTINË

Shtypi ditor nuk sillte asgjë të re. Sarajevën e kanë bombarduar edhe njëherë para dritet forcat tona të Jugosllavisë. Në Pale gjendja ish krejt në rregull. Srebrenicën e kishin ende nën kontroll forcat tona. Thashethemet sikur atje paskish ndodhur një gjoja gjakderdhje, ishin thjeshtë mashtrime. Muxhahedinët myslimanë as dinë të luftojnë, as dinë ç'kërkojnë e pse luftojnë. Në frontet e luftës, diku në rrethinë të Tuzllës, pasi muxhahedinët janë shpërndarë qyqarisht, në transhetë e tyre ushtarët tanë kanë gjetur 2 ekzemplarë të ***Kur'anit***, shtypur në gjuhën arabe. Kjo do të ishte një tjetër dëshmi e qartë mbi praninë e forcavet të huaja ushtarake në tokën tonë. Fotografitë e ***Kur'anit***, në arabisht, i kishin publikuar thuajse të gjitha gazetat… Pastaj, vatepolo në Hercegnovi. Futboll: Derbi ***"Crvena Zvezda"-"Partizani"***. Nja 10 kofshë tërheqëse femërore dhe gjinj femrash të ekspozuar në pozicione ofertash. "***Joshje femërore!***" Foli Ristoja nëpër dhëmbë. ***"Pa të këtillë truke, zor se do të shitej qoftë edhe 1 gazetë.***" Ishin aty edhe fjalëkryqet, rebuset dhe, më në fund, lajmvdekjet dhe ngushëllimet, nga 4 faqe për çdo gazetë. "***Nesër të gjitha këto faqe do të jenë plot me lajmvdekje dhe me ngushëllime për këta që u vranë sot. Fotografitë, kryqat, korrnizat sterrë të zeza. Shenjë e qartë se si mbahet më këmbë shtypi ynë i ditës."***

I PËLCET NJERIUT DELLI I BALLIT

Përshkrimi i ngjarjes ishte fare i shkurtër. ***"Para derës së një magazine, në afërsi të ndëtesës së ASSHA-së, i dyshuari si vrasës ka prurë me karrocë dore 3 trupa të masakruar: 2 femra dhe 1 mashkull. Vrasësi i dyshuar është kapur dhe arrestuar. I ngarkuar me hetimet: gjyqtari hetues, Zoti Risto Kilibarda."*** 2-3 gishta poshtë nënshkrimit dhe vulës, Ristoja lexoi një shënim me dorë: ***"Jemi të detyruar të veprojmë sa më shpejt. Krimineli i dyshuar ka asgjësuar krejt familjen e vet dhe çështja komplikohet për shkak të afërsisë me ASSHA-në… Miqësisht."*** (Sërish nënshkrimi.)

Muskujt e Ristos papritur i përshkuan një palë rrënqethje e fërgëllima. ***„Ja si ndodhin këto punë! Grinden: Darinka ime, Cvetkoja im dhe ati im Miquni. Unë duroj. Deri kur të duroj?! Mushkëritë tejmbushen. Pëlcet delli i ballit dhe njeriu, një njeri krejt normal, papritur shndërrohet në vrasës, bëhet keqbërës, kriminel.“*** Ristoja ndjeu njëfarë keqardhjeje për atë fajtor tash për tash të panjohur dhe gjithsesi tepër fatkeq. Ai përsëriti: ***„Njeriut i pëlcet delli i ballit!“*** Dhe shtoi: ***“Gjaku vërshon te kapilarët e syvet, sytë zgurdullohen! Gjymtyrët u nënshtrohen urdhëravet të çmendur të një truri të çakërdisur!..“***

VLERËSIMI VIZUAL I KRIMIT

Në fotografinë e parë ishte autori i veprës penale. Një fytyrë ngjyrë trëndafili, koka pa flokë, vetëm sipër veshëvet 2 tufa ngjyrë e hapur gështenje. Prapa syzevet, një palë sy, të cilët edhe në fotografi lëviznin shqetësueshëm. Quhej Prof.Dr.Stevan Jovanoviq. ***„Në cilat fusha të ketë doktoruar e profesoruar ky njeri?“*** Pyeti brenda vetes Dr.Risto Kilibardha... Në fotografinë e dytë ishte viktima e parë. Ristoja e njohu. Ishte një personalitet i njohur i industrisë tekstile. Shihej shpesh në emisionet televizivë. ***„Jasmina Golamadiq-Jovanoviq!“*** Bërtiti Ristoja. ***„A mund të besojmë që nuk jeton më kjo zonjë?!“*** E vuri sipër burrit. Mbuloi me të fytyrën tashmë kriminale të Stevanit. Në fotografinë e tretë ishte një trup pa krye. Në këmishë nate, trup mjaft i bëshëm. Në dysheme, poshtë qafës së prerë, një pellg mjaft i madh gjaku. Në fotografinë e katërt, 3 koka njerëzish në një thes. Thesi ishte i hapur, kurse kokat të fotografuara të 3-a së bashku. Llahtar! Llahtar i papërshkrueshëm! Fotografinë e pestë nuk mundi ta shikojë.

E mbështeti ballin mbi pëllëmbën e majtë, ndërsa me të djathtën e largoi dosjen. Kryehetuesi kish pasë të drejtë: Një e këtillë vrasje është vërtet e papërfytyrueshme. E papërfytyrueshme dhe e pakuptueshme. Ristos asnjëherë nuk i kishte ndodhur që të ndjehej aq i mbilodhur që në fillim të procesit. Ndoshta edhe për shkak se e kish njohur Jasminën. Kokë pa trupa dhe trupa pa kokë. Por ky sërish nuk ishte tmerri më i madh. Predrag Jovanoviqi, inxhinier ndërtimi. Svetllana Jovanoviq, studente në informatikë. Predragu s'i kish mbushur ende të 25 vjetët dhe ngjante shumë me Stevanin, vrasësin e vet. Svetllana, një vajzë e brishtë, shumë e bukur. Të fundit ishin 4 fotografi: 2 trupa pa koka, më vete, dhe 2 koka pa trupat e vet, më vete. 3 viktimave vrasësi ua kish çarë gojët me thikë, duke ua zgjatur të çarat në drejtim të veshëvet. Midis sendevet të gjetur në raftin e Predrag Jovanoviqit, ish gjetur edhe një bllok shënimesh me disa vargje pa autor, anonimë. Në ballë të atij blloku qëndronin 2 vargje: ***„Sërbi, o nëna ime, edhe e verbër, edhe e shurdhët! Atdhe jonjerëzor, atdhe mendjehumbur!“*** Ristoja kërkoi nëse kishte farë shënimi lidhur me atë prerje gojësh, por nuk gjeti asgjë përveç konstatimit: ***„Kokavet të të 3 viktimave u janë çarë gojët me thikë në dejtim të veshëvet.“***

PËRCAKTIMI

Kërkoi hartën e qytetit. Ia solli sekretarja. Duke lexuar raportin, i rrethoi me laps vendet ku ishin zhvilluar ngjarjet. Vrasja ish kryer në shtëpinë e vrasësit, ***"Dositejeva 204"***. Shtëpi private, dykatëshe, në formë vile, me 2 palë shkallë në 2 anët. Pronë e 2 familjeve. Njëri krah, edhe poshtë, edhe lart, i takonte familjes katëranëtarëshe të Prof.Dr.Stevan Jovanoviqit. ***"Tashmë familje e shpërbërë: 3 pjesëtarë me koka të prera, i katërti në pranga."*** Mendoi Ristoja dhe vazhdoi leximin, duke bërë viza mbi hartë. Krahu tjetër, edhe poshtë, edhe lart, i takon zonjës Vidosava Kërstiq-Jovanoviq, aktualisht shtëpi publike. Qe! Edhe kjo i kish munguar Ristos, në këtë dimër të akulluar!

"Vrasja është zbuluar papritur në sheshin përpara Akademisë Sërbe të Shkencavet dhe Artevet. Aty është parkuar me shpejtësi vetura e markës Zastava, regjistruar BG 02447. Ka frenuar para derës së një, siç thuhet, magazine, në të vërtetë, para portës së Arkivit të Akademisë. Vozitësi ka qenë vetë autori i krimit, Prof.Dr.Stevan Jovanoviq, arkivist shumëvjeçar i të sipërpërmendurit Arkiv të Akademisë. Ai ka tentuar, me një karrocë dore, për t'i shtirë kufomat në Arkiv. Kemi vrapuar ne, shërbimi i milicisë për qetësinë publike, dhe e kemi ndaluar me mundim të madh autorin e veprës penale, në prani të një shumice gazetarësh dhe reporterësh televizivë. Vëmë në dukje që, rastësisht, krejt rastësisht, në ata çaste është pritur të fillonte një simpozium shkencor brenda ASSHA-së, ashtu që ka qenë e pamundur shmangia e dëshmitarëvet të shumtë okularë: akademikë të njohur, nga të gjithë kontinentet, si dhe gazetarë, gjithashtu nga të gjithë kontinentet."

Ristoja nxori nga xhepi i pulovrit një kruajtëse dhëmbësh. Që nga koha kur e kish ndërprerë duhanin, mbante nëpër xhepa një kuti me kruajtëse dhëmbësh, dhe, kur i kruante dhëmbët, fuste brenda në gojë të 2 gishtat, edhe të madhin, edhe treguesin. Nuk i bëhej shumë vonë prej sqimatarëvet. Kurse tash vuri re se si Borka, sapo ai i futi gishtat në gojë, e ktheu kokën mënjanë. ***"Qe ku mu skandalizua sekretarja!"*** Tha me vete. ***"Ndjenjat e saj, pikël vese! Edukata e saj, delikate si një fije mëndafshi! Ndërsa gjithë javën nuk ëndërron tjetër, por si të gjuajë, për fundin e javës, një mashkull të fuqishëm! Le të jetë brutal si një kafshë ai mashkull!"*** Atëherë i foli Borkës me zë: ***„O mjegullorja ime delikate! Ç'po shikon andej nga muri!?"*** Borka u tkurr, e kapur në befasi. A ish Ristoja i drejtë në vlerësimin e sekretares së vet?!

E rrëmbeu regjistrin e telefonavet, e shfletoi me nervozizëm, gjeti atje një numër dhe i ra tasturës me gishtin ende të lagur nga pështyma. ***„Kurvat!"*** Bërtiti me zë të vrazhdët në receptorin e telefonit. „..." ***„A jeni ju Vidosava Kërstiq-Jovanoviq?"***

„...“ ***„Ju jeni pronarja e atyre kurvave! Dua që të jeni këtu bashkë me to për 30 minuta!”*** “…” ***“Po, po! Bashkë me vajzuket, me ato vajzuket e virgjëra, që banojnë në shtëpizën Tuaj!”*** “…” ***“Kush jam unë?!. Unë jam Risto Kilibardha, gjyqtar hetues në qytetin e Beogradit.”*** “…” ***“Nuk Ju lejon milicia?! Kanë mbetur pa punë vajzuket Tuaja?! Do t’i telefonoj unë milicisë dhe do t’Ju lejojnë të vini.”*** E kuptoi që kish vepruar gabim, por ish i tejmbushur me nervozë dhe nuk po e mblidhte dot veten kurrsesi.

MOS U BËNI MERAK

Ra telefoni. Ishte Akademia Sërbe e Shkencavet dhe Artevet. U paraqit një nëpunës. ***„Na kanë informuar që do t’i udhëhiqni Ju hetimet.“ „Po. Unë jam i ngarkuar me atë punë.”*** Shprehja “***jam i ngarkuar***” në vend të “***e kam atë detyrë***” e zbulonte qartë çrregullsinë e tij shpirtërore në ata çaste. ***“Jam i porositur që të Ju tërheq vëmendjen me dashamirësi, që, sidoqoftë, ta keni parasysh: Njeriu që e ka kryer sot atë krim, nuk llogaritet si punonjës i yni, ndonëse vendin e punës e ka pasur në fqinjësi të drejtpërdrejtë me arkivat tanë. Shpresojmë që do të na mirëkuptoni miqësisht.”***

Risto Kilibarda konsiderohej si njëri prej hetuesve më me përvojë në Beograd. Nuk e dinte as vetë se si i ishte krijuar një e tillë aureolë autoritative, por ashtu ish realiteti. Ai veten nuk e konsideronte shumë të aftë dhe as kushedi sa të shkathët. Por opinioni i përgjithshëm ishte i tillë dhe kjo, midis tjerash, e rëndonte, sepse vazhdimisht e ngarkonin me dosje veçanërisht të koklavitura dhe delikate. Vetëm atëherë kur i telefonuan prej Akademisë, madje edhe duke u sjellë keq, ai filloi të mbledhë dyshime se mund të kish të bënte me ndonjë problem të ngatërruar keqas. E mblodhi veten dhe iu përgjigj: ***“Profesor i nderuar, mos u bëni merak për asgjë. Le të shpresojmë që do të përfundojë çdo gjë bukur dhe më së miri. Keqbërësi i dyshuar ka për të marrë vetëm atë që do t’i takojë sipas ligjevet.”*** E quajti me qëllim “***profesor***”, kurse fjalën “***bukur***” e përdori gjithashtu me qëllim. Dihet që, në një të tillë gjakderdhje të pamend, nuk mund të kish asgjë të bukur.

SHKALLË E LARTË ZHVILLIMI

Erdhi Momo Gënçareviqi, kolegu i Ristos. Edhe ai, me detyrë gjyqtar hetues si dhe Ristoja, ndonëse nja 10 vjet më ri. Hyri si një thes, si një kashtore e rrukullisur nën trysninë e të ftohtit, ngjashëm me të rrukullisurit e Ristos sot në mëngjes. As të ngrohtit e hollit të poshtëm, as ashensori, as korridori I gjatë e I heshtur, nuk e kishin çliruar përshtypjesh të jashtme, përshtypjesh nga realiteti në rrugë, në fushat, në malet. Filloi sakaq të komentojë. Thyerja e marketit kish ndodhur në pjesën midis Zooparkut dhe Danubit, Rruga Jevrejska numër 362. Kish qenë vërtet

një vjedhje mjeshtërore. ***„Në të vërtetë“***, shpjegoi më tutje Momoja, ***„ai s'kish qenë fare një market. Kish qenë një shitore e rendomtë. Por thyerja qe mirëfilli profesionale, kurse vjedhja, gjegjësisht rrëmbimi, krejt i përpiktë. I meritojnë përgëzimet.“***

Zonjushë Borka nënqeshte tinëz. Ristoja as që e dëgjonte. ***„Por a e di ti për çfarë kam menduar duke hyrë në këtë lloj strehimi? Njerëzimi tani gjendet në një shkallë të kënaqshme zhvillimi. Teknologjia ka arritur në maja ambicioze. A do të mund të gjendej një mënyrë që dimri dhe erërat të frenoheshin?! Të mos ketë të ftohtë edhe erë! Thjeshtë të pushojë së fryri era dhe ngrica të pushojë së ekzistuari! A po më kupton ç'po them? Që, në një farë mënyre, të disiplinohen lëvizjet e ajrit, deri tash pa rregull e disiplinë.“***

Ristoja i telefonoi komandirit të milicisë: ***„Vrasësi i dyshuar a ka mbajtur armë?“ “Po, ka qenë i armatosur me një thikë kasapësh dhe me një sëpatë të pamprehur druvari. Krejt ishin të spërkatura me shkulme gjaku: Edhe sëpata, edhe thika, edhe pëlhurat, në të cilat qenë mbështjellë viktimat, edhe karroca e dorës, edhe vetë vrasësi. Pamja e ngjarjes në kuptimin e vërtetë të fjalës, ka qenë tepër rrënqethëse. Kemi qenë tmerrësisht të shokuar, ndërsa qytetarët, kalimtarë të rastit, një shumicë profesorësh, gazetarë, të gjithë pa përjashtim, ishin thjeshtë të llahtarisur. Kurse ai, ndërsa po u kundërshtonte furishëm milicëvet tanë, bërtiste duke hedhur ca parulla të çuditshme, midis të cilavet edhe një varg poetik i Jakshiqit: ‚Po guxove më këndej, të pret gjëmimi i rrufevet!‘ („Dëznesh li dale, çuqesh gromove!“) „Jemi të detyruar ta bëjmë këqyrjen në vendin e ngjarjes.“*** Tha Ristoja. ***„Po.“ „A mundet menjëherë?“ „Mundet.“***

Ristoja e ngjeshi revolen. Mori edhe pajisjet e lëvizshme të zyrës dhe u nis. Borkën e këshilloi të rrijë në zyrë, që delikatesa e saj të mos u nënshtrohej sprovavet. Pastaj, pasi u mendua pak, u kthye dhe i telefonoi zonjës Vidosava Kërstiq-Jovanoviq: ***„Mos u nisni, na prisni atje!***

NUMRAT 802 DHE 803

Vrasësi dyshuar kish një shtëpi private, pikërisht ashtu siç përshkruhej te raporti. Ishte një dykatëshe, e projektuar dhe e ndërtuar për 2 vëllezër. Për të 2 vëllezërit nga 1 portë hyrëse, oborri, i ndarë më dysh me një gardh metalik për midisi, nga 2 rrugica, të kufizuara me rreshta lulesh, te hyrjet nga 3 shkallë dhe nga 1 shesh pushimi, dyert dykanatëshe, dritaret simetrike, ballkonet simetrikë.

Në rrugë, jashtë portavet, qëndronin 2 milicë të armatosur me automatikë dhe me pistoleta. Në krah të djathtë të portës gjysmërrjetë qëndronte mbishkrimi: "***Jovanoviq Stevan. Nr.802***". Porta tjetër ishte identike, përgjysmë me rrjetë

metalike, por e lyer rishtas. Në pllakëzën e saj shkruante: "***Jovanoviq-Kërstiq Vidosava. Nr.803***".

Para nisjes Ristoja ishte informuar shkurt mbi përmbajtjen banimore të asaj shtëpie. Familja e Stevanit, tashmë ish-familja, ishte (kish qenë) katëranëtarëshe. Ai, arkivist i punësuar në njëfarë të quajturin "***arkiv pranakademik***", bashkëshortja e tij, Jasmina, inxhiniere tekstili, i biri, Predragu, inxhinier ndërtimi, e bija, Svetllana, studente në degën e informatikës. Stevani, tani i prangosur si i dyshuar për vrasjen e familjes së vet, 3 anëtarët e tjerë, tani të vdekur, por pa varrosur. Pamje e tmerrshme, vetëm me fjalë, jo më edhe me të shikuar.

Pronarja e gjysmës së dytë të asaj shtëpie ishte kunata e Stevanit, zonja Vidosava Kërstiq-Jovanoviq. I shoqi i saj, vëllai i Stevanit, kish qenë vrarë në rrethana të pasqaruara enigmatike, para nja 15 vjetësh, ndoshta edhe më. Vidosava kish jetuar shumë kohë e vetmuar, ndërsa, në vitet e fundit, dhomat e pjesës së vet ua kish lëshuar me qëra disa "***vajzave***". Ristoja kish lexuar në shënimet informues që ato "***vajza***" në të vërtetë ishin prostituta, kurse zonja Vidosavë ishte kujdestarja e tyre, dmth padronia. Ristoja ishte i bindur, me të drejtë, që shtëpia e zonjës Vidosavë, kunatës së Stevanit, nuk ish një banesë e rendomtë, lëshuar me qëra, por një shtëpi publike e pashpallur. ***"Pikërisht aty duhet ta kërkojmë shkakun e masakrës që ka ndodhur në krahun tjetër."*** Kish thënë me vete. Kjo e pat nxitur, madje, pak parë edhe në përdorimin e fjalëve aq të rënda në telefon.

VALLJA E BRANKOS

E shtypi butonin e ziles. Në sheshhyrjen, gjegjësisht, në sheshdaljen e gjysmëvilës, asaj me numër 803, doli një grua me një bukuri që të lë gojëhapur. Ristos iu duk që kurrë më parë s'kish parë femër aq të magjishme. Ajo i zbriti hijshëm të 3 shkallët, pastaj eci me ngadalë në rrugicën midis lulevet. Ish veshur krejt në të zeza. Ristoja, duke mos ditur si të sillet, e pyeti ashpër dhe në mënyrë të ngathët: „***Ju jeni pronarja?"*** „***Po. Unë jam pronarja e 803-shit. Ngjarja fatkeqe ka ndodhur në pjesën tjetër."*** Tha duke drejtuar gishtin tregues në drejtim të pjesës së Stevanit. Ristoja arriti në çast të ndryshojë qëndrim dhe të marrë pamjen e një personi profesionist. ***„E dimë ku është kryer krimi, detyra jote është të na e hapësh këtë portë."***

Ia tregoi dokumentin. Ajo, fare e qetë, e hapi portën në të 2-ja kanatet, duke shprehur njëkohësisht një lloj proteste: ***„Ju, në telefon, i keni fyer qiraxheshat e mia. Unë nuk Ju lejoj të silleni në atë mënyrë." „Nuk do t'u bëjmë asgjë. E rëndësishme është që të jenë të gjitha aty."*** 2 milicë qëndruan përjashta, te veranda, Ristoja me 2 vartësit e vet u ngjit në katin e dytë, duke ndjekur bujtinaren e magjishme. U gjendën në një sallon të bollshëm, të mobiluar me shije e në

mënyrë moderne. Ishin 3 tavolina prej xhami, rrethuar së paku me nga 3 kolltuqe. Një tavolinë më e madhe qe vendosur pranë dritares së gjërë dhe mjaft të lartë, zbukuruar me një perde të madhe, lëshuar deri në dysheme. Aty kish vende për më shumë se 10 persona.

Vidosava e njoftoi që qiraxheshat e saja gjendeshin të gjitha nëpër dhoma. Ristoja i kërkoi që t'i sillte aty një nga një, dhe pastaj secila prej tyre, pasi të jetë marrë në pyetje, të presë në katin e poshtëm. Erdhi "***vajza***" e parë. Me veshje qytetëse, pjesërisht në të zeza, pa as edhe një gjurmë apo shenjë prostitute. Vetëm një njeri i vëmendshëm do të mund të vërente aty ndonjë tipar të atij profesioni stërmundues, kryesisht në shikimin e saj, në konstruktin e faqevet dhe në disa shprehje të fytyrës. ***"A i ke njohur fqinjët, të cilëvet u ka ndodhur tragjedia?" "Natyrisht! Si të mos i kem njohur?! Svetllanën, Predragun, zonjën Jasminë! O, çfarë lemerie!" "Zoti Jovanoviq, a vinte shpesh këtu te ju?"*** Pyetja ishte dykuptimëshe, por nuk shkaktoi kurrfarë reagimi. ***"Vinte shpesh. Ulej me zonjën në verandë. Pinte nga një gotëz raki kumbulle dhe bisedonte krejt i qetë. Oh, si mund të ketë ndodhur krejt ajo batërdi!?***" Qiraxhesha i çoi sytë te e zonja e bujtinës sikur donte ta pyste diçka dhe shtoi: ***„Përshëndeteshim përherë te parmakët. Ka qenë njeri shumë i dashur. Në të vërtetë, edhe është, i dashur dhe i sjellshëm." "A vinte te ju i ndjeri Predrag?***"

Në atë çast u hap vrullshëm dera e njërës prej dhomavet më të afërta, dhe doli andej një vajzë jashtzakonisht simpatike, duke këngëtuar me zë gjysmërecitues 2 vargje shumë të njohur të Branko Radiçeviqit:

"Valle,valle,rretherrotull,
E harlisur, e furishme!"

("Kollo, kollo, naokollo,

Villovito, pllahovito!")

Ristoja pa dashur rënkoi dhe gati sa s'bërtiti: ***"O Zot! PrapëBrankoja!"*** Vajza rrotullohej mbi dysheme duke hapur duart dhe duke kërcyer me ritmin e një valleje. Duke ardhur rrethas, ajo gjithnjë i përsëritte po ata vargje:

"Valle, valle, rretherrotull,
E harlisur, e furishme!"

Ristoja u ngit vrullshëm dhe e urdhëroi vidosavën me zë të rreptë: ***"Do të vish me ne dhe do të sqarohemi atje!"*** Dyshoi se mos ajo femër e zezë ia ka inskenuar qëllimisht atë Valle të Brankos.

KËRDIA

Kur pat ardhur milicia, edhe dera e oborrit edhe ajo e shtëpisë qenë gjetur të hapura, prandaj edhe tash ishin poashtu të hapura. Pllakëzat plastike katërkëndëshe me numrat përkatës gjendeshin gjithandej, filluar nga shkallarja trishkallëshe në hyrje deri te dritarja në katin e dytë, nga ku, me sa duket, njëra nga viktimat kish tentuar të hidhej. Pellgje me gjak të mpiksur, tashmë të tharë ose të ngrirë, kish në shumë vende. Njëra ishte në dysheme pranë krevatit bashkëshortor. Edhe dysheku ishte krejt i përgjakur. Pellgu tjetër gjendej në hyrje, gjegjësisht në dalje nga dhoma në katin e dytë. Vidosava tha se ajo ishte dhoma e Predragut. Pak më tej gjendej dhoma e Svetllanës, por aty nuk kish gjurmë gjaku. Pellgu i tretë ishte përpara dritares në fund të sallonit. Muret e katit të sipërm, në dallim nga i poshtmi, ishin gjithandej të spërkatur me shkulme gjaku.

Ristoja e kuptoi që Stevani fatkeq kish vrarë së pari të shoqen. Pastaj është ngjitur lart, ka vrarë Predragun. Svetllana ka tgentuar të ikë, por i jati e ka kapur dhe, kushedi se si, edhe asaj ia ka fikur jetën. Nëpër krejt dyshemenë e katit të epërm dhe nëpër shkallë, deri në oborr, shiheshin gjurmët e të tërhequrit zvarrë të viktimavet.

Vidosava nuk po qante. Duke dalë në rrugë, ndonëse e dinte që do ta çonin në organet e hetimit, e gjeti me vend që të shprehej: ***"Zotëri, Stevani fatkeq është kunati im, vëllai i burrit tim të ndjerë, prandaj dhe më ka takuar t'i zgjedh avokatin. Avokati i tij është juristi i njohur, zoti Mirko Zvonar."***

VRRAGAT E SË PARËS DASHURI

Dyshonte edhe më tutje se ndoshta Vidosava e kish kurdisur me qëllim skenën e Valles së Brankos. Dyshonte, por s'ishte i vendosur. Më shumë po e tërhiqte prania e saj në atë makinë, tërë jetën të pakëndshme, madje të mërzitshme. ***"Të kesh punë me një të këtillë mrekulli,"*** përsëriste me vete, ***"njeriu do të ish kail që hetimi edhe i krimit më të përgjakur të mos mbaronte kurrë."*** Vidosava rrinte dhe heshtte, por ajo heshtje e saja ishte përjetimi më i këndshëm që kish provuar ndonjëherë Ristoja. Nuk po guxonte ta fillonte bisedën zyrtare, por as bisedavet të rendomta nuk po u krijohej kurrfarë hapësire.

Arritën te ***"Trarët".*** Zonjushë Borka po e shikonte si e ngrirë të posaardhurën, ndërsa Momoja po e shikonte kolegun me një lloj enigme. Vidosava e shpjegoi qetë dhe qartë rastin e vajzës, që kish vallëzuar në mënyrë aq dhimbjerëndë para tyre: ***"Ka ardhur nga Bosnja. Është myslimane. E quajnë Sanije. Nuk ka dokumente. Nuk di prej cilit qytet ka ardhur… E kanë përdhunuar ushtarët tanë. Një togë e tërë i është vardisur, më i pari komandiri i tyre. Në sekondat kur ai po***

e mbaronte atë punë, kjo, siç ma ka thënë vetë, i ka pështëritur te veshi: 'O, i dashuri im! Të kem ta di nga cili vend ke ardhur!' Ndërsa ai, gjithashtu me pështërimë, i është përgjigjur: 'E bukura ime! Unë vij nga Beogradi.'

Ushtarët kanë qenë të rreshtuar prapa tij, me kopsa të zbërthyera. Ai është çuar më këmbë dhe i ka komanduar, duke u kujdesur për rregull e disiplinë. Ushtarët e kanë zbrazur epshin e tyre, duke u lëshuar truprëndë sipër shtatit të saj tepër brishtë, ndërsa ajo ka ndenjur shtrirë mbi bar, me gjymtyrët të hapura, nën hijen e një rrapi degëgjërë…

Ka ardhur në Beograd, me shpresë për të gjetur djalin që e ka puthur për të parën herë. Djalin që ia ka marrë virgjërinë. Ka bredhur rrugëvet të Beogradit, në shoqërinë e të pashtëpivet dhe të lypësavet, duke kënduar Vallen e Brankos. Ka qenë e uritur, këmbëzbathur dhe gati krejt lakuriq. E kam marrë për dore, e kam ushqyer, dhe ja, tani po jeton në shtëpinë time. Kur i teket, i deklamon vargjet e pavdekshëm të Brankos. Pas shembullit të saj, tani këndojnë në kor të gjithë lypësat e Beogradit." „A është psiqikisht e çrregulluar?" „Po, dhe s'është për t'u çuditur. Mbase në më pak se 1 orë kohë ia ka hipur një togë e tërë meshkujsh të papërmbajtur. Ç'mund të pritet tjetër pas të tilla mynxyrash?!"

O TATË, TË LUTEM!

Ishte, në kuptimin më të mirëfilltë, i dërrmuar. E kaluara, e tashmja, e ardhshmja. Të thënat e të pathënat. Të bërat dhe të pabërat. Të kuptuarat e të pakuptuarat. Prej ngushtësisë së një zyre shtetërore, te shtërngesat frymëzënëse në familje, në familjen e tij, që e kish krijuar e ngritur me aq kujdes. Nga vetëdija e plasaritur e Sanijes fatkeqe, te bukuria e ftohtë, por hyjnore, e pronares së një kuplaraje. Pastaj, midis krejt këtyre, si një shkëmb i rëndë, lëshuar lartësish së qiellit, i kushedi se deri në çfarë shkalle i çakërdisur, një kasap i familjes së vet!

E rregulloi veturën në garazh. I shtypi thuajse pa vetëdije butonët përkatës te ashensori dhe, pak më vonë, i ra ziles në banesën e vet. Ia hapi Cvetkoja. Ambienti fizik ishte i ngrohtë dhe i këndshëm. Por ai shpirtërori, qindfish më i rëndësishëm, ia shtërngoi fytin. Cvetkoja luante në kompjuter, Darinka po fërgonte diçka. Tha "***Mirëmbrëma!***". Iu përgjigj vetëm Miquni. Në të vërtetë, vetë sytë e tij xixëllonin dritë. Ristoja e dinte që, në qenien e plakut 90-vjeçar, tashmë ishin fikur të gjithë llojet e energjivet, përveç optimizmit ngazllues fëminor të rizgjuar me gjithë cektësinë dhe me gjërësinë e tij.

U ndërrua. U ul në kolltukun e vet përballë televizorit dhe filloi të kërkojë një emision të përshtatshëm. Miquni e shihte me krenari djalin e vet, të famshmin e të rrëzikshmin hetues të Beogradit, dhe, si pa dashur, por, në të vërtetë, me qëllim, e

çoi shikimin te i nipi. Ia nguli shikimin, qëndroi disa sekonda, dhe ia filloi si në mëngjes:

"Malazi, o mbret i vogël…"

("Malazi, o mbret i vogël!")

"O tatë, mos, të lutem!" E ndërpreu Ristoja, nga frika se mos pëlciste sherri. Por ish tepër vonë. Darinka intervenoi menjëherë nga aneksi i kuzhinës: ***„Qe! Filloi prapë xhorrja i matufjepsur!" „Paj, për Zotin, nuk thashë asgjë të keqe. Më vjen mirë kur e shoh nipçen të rritur, të guximshëm, të zot, të mençur, të bukur, një Kilibardë i vërtetë. Malazi i pastër, nga thoi i këmbës deri te xhufka mbi ballë." „Kur unë, nëna e tij, nuk jam malazeze, as im bir nuk është e nuk mund të jetë malazi. Kjo punë ka marrë fund. Ka lindur në Beograd, rron, falë Zotit, në Beograd, shkollohet në Beograd. Ristoja e ka kaluar këtu më shumë se gjysmën e jetës..."***

Ristoja nuk bëzante. Cvetkoja nuk e ndërpreu lojën e vet. Darinka dhe Miquni i hidhnin fjalë të rënda njëri-tjetrit. Lajmet e mbrëmjes u përvodhën. Ristoja nuk pa as nuk dëgjoi asgjë. Kaloi edhe filmi serial. Brenda në kokën e Ristos një rrahje e papërballueshme sulmonte tëmthat. Më në fund brofi më këmbë dhe bërtiti: "***Epo, pushoni, ju lutem!"*** E përsëriti të njëjtën fjali disa herë. Darinka kish dalë ndoshta dhjetë herë nga kuzhina, por tani dhjetëfish më e ashpër. ***„Je ti fajtori! Ja çfarë! E gjithë kjo po ndodh prej butësisë tënde. Më fal, por do të thosha: butësi prej bajge!"*** Ristoja e përsëriti kërkesën: ***„Epo pushoni, ju lutem si zotavet! A e dini ç'ka ndodhur sot në Beograd?! . Një njeri ka vrarë e ka masakruar me sëpatë: gruan e vet, vajzën e vet dhe djalin e vet!" „Epo, vetëkuptohet!"*** Bërtiti Darinka. ***„Kur njerëzit nuk kanë mend në kokë, siç nuk i keni yt atë edhe ti dy pare mend, çdo gjë mund të ndodhë!"***

Ristoja u fundos në kolltuk dhe ia dha të qarit. Qau me dënesë, duke shtypur vazhdimisht tëmthat me gishta. Ishte pamja më e çuditshme e një gjyqtari hetues.

VIKTIMA PASIONESH TË SHFRENUAR

Në krejt hetuesinë publike të Beogradit nuk mund të gjendej një njeri, i cili do të ishte aq i informuar për çdo gjë, përveç Momo Gërnçareviqit. Ai ishte aty rekordmeni i të gjithditurvet. Prandaj dhe Ristoja nuk u habit fare, kur Momoja, të nesërmen, filloi të flasë për zonjën Vidosava Jovanoviq, lindur Kërstiq, si për një të njohur të hershme. Nuk u habit, por ia bëri një vërejtje ironike: ***"A nuk do të fölasim sot për erën dhe për të ftohtit?! Mbi mundësitë e frenimit të tekavet qiellore?!" "Erën dhe të ftohtit mund t'i lëmë për herë tjetër,"*** tha Momoja me

një nënqeshje në buzë dhe e vazhdoi tregimin që sapo e kish nisur: ***"Zonja Vidosava dhe bashkëshorti i saj , i ndjeri Lubisha Jovanoviq, konsideroheshin, nga fundi i vitevet 70, si çifti më i bukur në krejt Beogradin. Kur dilinin ata në shëtitjen e mbrëmjes, thonë, të gjithë shikimet e shëtitësvet ktheshin te ata… Edhe para kanë pasur, prandaj çdo vit i bënin pushimet ku t'u donte qejfi. Fundjavat, në pranverë, verë e vjeshtë, i kalonin, o në Liqenin e Ohrit, o në Plazhet e Ulqinit, o në Liqenet e Plitvicës, o në Dubrovnik, ndërsa dimrit në Brezovicën e Sharrit. Veçanërisht u pëlqente të hidheshin deri në Ohër. Shkonin atje të shtunën dhe ktheheshin të dielën mbasdite ose natën."***

"Por, njëherë, për fat të keq, Lubisha e humbi jetën në Mavrovë, midis Gostivarit dhe Dibrës. Duke u kthyer nga Ohri, Lubishës i shkoi mendja që ta përsëritë edhe njëherë aktin e dashurisë. E kanë parkuar veturën në anë të xhades. Janë shmangur sipër xhades në një pyll me pisha dhe janë pleksur në dashuri. Krejt papritur, në çastin e tyre më të ëmbël, ka fluturuar dhe ka eksploduar një predhë artilerie, si të thuash, fare pranë trupavet të tyre. Zonja Vidosava ka mbetur gjallë. Ajo ka marrë vetëm lëndime të lehtë, kurse burri i saj është copëtuar i tëri. Thonë që gjymtyrët e tija dhe pjesët e tjera të trupit, kjo, është detyruar t'i mbledhë natën nëpër pyllin e pishës dhe rreth gropës së hapur nga eksplodimi. Përfytyroni çfarë traume ka përjetuar. Fill e vetme, midis territ, në mes të një pylli pishash, rrethuar me vendbanime shqiptarësh. Në Beograd ka mbërritur të nesërmen para dritet, duke ikur. Po, po, duke ikur prej atij ambienti të frikshëm. Copat e njeriut të saj më të dashur i ka mbështjellë në një çarçaf dhe e ka ngarë makinën si e marrë, duke u betuar që kurrë më nuk do të udhëtonte drejt Jugut."

Ngjarja ishte e jashtzakonshme. Kishin shkruar të gjitha gazetat. Iu kujtuan edhe Ristos ata lajme, por as që kish shkuar mendja që pikërisht ajo grua, më se e bukur, të ketë përjetuar një tmerr të tillë. U tha atëherë (nëpër gazeta) që garnizoni i afërm kish bërë atë natë stërvitje me municion lufte. Por krahas kësaj, jo në gazeta, por në biseda, pat qarkulluar një tjetër opcion: i jati i Lubishës, edhe i Stevanit, kish qenë në Luftën e Dytë Botërore oficer i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave. Thuhej që, me atë rast, me urdhër të tij, ish asgjësuar një numër i madh shqiptarësh. Vendësit e kanë ditur që Lubisha ka qenë djali i atij oficeri, e kanë shfrytëzuar stërvitjen e ushtrisë dhe e kanë vrarë me topin e vet, fshehur diku në oborret e tyre. Por krejt ato patën mbetur në shkallën e hamendjevet. Asgjë s'kish qenë e mundur të dokumentohej.

Ristoja u ngrit dhe iu afrua dritares. Mbeti ashtu i palëvizshëm për disa minuta. Edhe i jati, Miquni, kish qenë oficer dhe pikërisht atje pat shërbyer në vitin 1944.

SHANSI I FUNDIT DHE I VETMI

Në orën 9 ia bënë një vizitë, për efekt këqyrjeje, Arkivit të Akademisë Sërbe të Shkencavet dhe Artevet. Në makinë, bashkë me riston, u ulën edhe zonjushë Borka e 2 bashkëpunëtorët e tij të përhershëm. Pas tyre vinte makina e milicisë me malice. Hyrja kryesore e Arkivit (Jo ajo nga kish tentuar Stevani t'i shtinte viktimat.) ishte në anën e kundërt të fasadës impozante ballore të Akademisë. Çelësat e zyrës së Stevanit i mbante në dorë një pastruese.

Korridori i parë, midis raftevet të mëdhenj, ngarkuar me dosje të rënda, ishte i gjatë mbi 20 metra. Pastaj u kthyen në të djathtë. Në faqen e majtë të atij korridori ishte një mur me dritareza të ngushta të vendosura hozontalisht, ndërsa në të djathtë, pamjet ballore të një vargu të tjerë raftesh në korridorin me të njëjtën gjatësi e thellësi, si dhe me të njëjtat ngarkesa të rënda dosjesh plot me dokumente. U kthyen edhe njëherë në të majtë. Tani, në vend të raftevet, renditeshin zyrat e nëpunësvet të arkivit. Pastruesja më në fund e shtiu çelësin në bravën e njërës prej atyre zyrave. Ajo, me shprehje të dhimbshme në fytyrë, deklaroi: ***"Ky është vendi i tij i punës."*** Ristoja e pyeti: ***"Që kur e ke njohur zotin Jovanoviq?" „Paj, për Zotin, nuk mund të Ju them me saktësi. Ka shumë vite. Gjysma e jetës." „A pate vënë re farë ndryshimi tek ai?" „Nuk kam parë asgjë të jashzakonshme tek ai. Vetëm se, muajt e fundit, filloi të fliste me zë më të lartë. Thjeshtë, sikur bërtiste." "Për çfarë bisedonte zakonisht? Cilat ishin fjalët e tija më të shpeshta?" "S'para e kuptoja tamam. Ai është shkencëtar, kurse unë një punëtore e thjeshtë. E përmendte njëfarë Përndjekje të Turkoshakëvet (Istraga Poturica), sokëllinte nëpër arkiv, sa ushtonin korridoret nga cepi në cep."***

Ristoja e falenderoi pastruesen, pastaj thirri nëpunësin e zyrës më të afërt, me qëllim që, në sy të tij të fillonte këqyrjen e vendit të punës të të pandehurit. Në të vërtetë, duhej të ishte i pranishëm drejtori i institucionit, por ai momentalisht ndodhej jashtë shtetit. E ka kërkuar nëndrejtorin, por edhe ai ka qenë në një udhëtim. Kështu që, sa për të zbatuar rregullat, është detyruar të marrë njërin prej arkivistëvet të thjeshtë. Arkivisti rrinte më këmbë pranë tavolinës. Kokëzbuluar dhe gati qeros, përveç sipër veshëvet dhe pas qafës, ngjashëm me Stevanin. Mbi tavolinë qëndronte një grumbull dosjesh të tejfryra. Dollapët ishin gjithashtu plot. Në shpinat dhe në anët e secilës dosje ishin ngjitur etiketat me titujt përkatës. Riston, si përherë kur gjendej para të atilla pamjeve, e zuri koka. I lexoi nja 15 prej atyre titujve, duke kapërcyer pa rregull nga njëri sergjen te tjetri: ***"Mali i Zi i Shkupit", "Kukësi", "Gostivari", "Gjakova", "Presheva",*** prapë ***"Gostivari", "Dibra", "Manastiri", "Gusia", "Senica", "Rahoveci"***, prapë ***"Gjakova", "Bihori". "Me ç'punë është marrë ky njeri?"*** Pyeti Ristoja. ***"Me gjeografi, me statistika të ekonomisë, me të drejtat nacionale të pakicavet?"*** Arkivisti e saktësoi: ***"Zoti Jovanoviq, në këtë arkiv, ndonëse edhe më parë ka ekzistuar një***

bërthamë, është krijuesi i Sektorit të Veprimtarisë Kundërshqiptare. Ka punuar këtu pa u lodhur mbi 30 vjet, ka doktoruar dhe ka fituar titullin e profesorit.“

Gjyqtari hetues Risto Kilibarda për një çast ngriu në vend. Në Jugosllavinë Socialiste, në vendin e vëllazërim-bashkimit?! Kjo kurrsesi nuk do të pritej. U ul në kolltukun e Stevan Jovanoviqit, duke e parë drejt e në sy nëpunësin kokërrumbullakët. ***“Kam punuar edhe unë në Beograd tash plot 30 vjet. Madje në mjedise të mirinformuar. Megjithatë, s'kam dëgjuar asnjëherë për diçka të këtillë. A mund të na e sqarosh pak më me imtësi?.. Uluni, ju lutem!”*** Iu drejtua jo vetëm arkivistit, por të gjithë atyre që gjendshin aty. Arkivisti u ul përballë Ristos. Sekretare Borka vendosi para tij aparatin e incizimit. Ai filloi: ***“Profesor Jovanoviqi e ka emëtuar figurativisht këtë sektor 'Shansi i vetëm dhe i fundit shqiptarëvet'.”***

Në fund, e porositi nëpunësin e arkivit: ***“Ky është vetëm fillimi i hetimevet. Herën tjetër do të detyrohemi ta shikojmë krejt këtë pjesë të arkivit tuaj. Por ajo do të ndodhë kur edhe drejtori të jetë këtu.***”

TURP I PADËGJUAR

U kthyen te ***“trarët”*** diku rreth orës 15. Ristoja u tha kolegëvet dhe sekretares se do të duhet ta dëgjojnë të pandehurin sonte në mbrëmje, për shkak të afatit të ndalimit. Që të mos shkelej afati i ndalimit, duhej ta merrnin në pyetje atë natë dhe të nesërmen para dite të nxirrej në gjyq. Dha udhëzim që në lidhje me procedurën e përcaktuar të njoftohej edhe avokati i Stevanit, Mirko Zvonar, pastaj secili u nis për të ngrënë drekë dhe për të pushuar. Riston s'po e tërhiqte shtëpia e vet. Kish turp prej vetes për ato qaravitjet e mbrëmshme. Frenoi papritur, parkoi dhe u fut në një restorant të klasit të tretë. Hëngri drekë duke murmuritur me vetëveten: ***„Kam qarë si një italian. Turp i padëgjuar! S'kam fytyrë t'i dal para tim biri.”*** U kthye në zyrë, u ul në kolltuk dhe e zuri gjumi.

Në 21 pa 10 erdhi Borka. Pak më vonë erdhi, në të njëjtin ashensor me kolegët e ekipit hetues, edhe avokati, profesor i shkencavet juridike, Mirosllav, gjegjësisht Mirko Zvonar. Të gjithë e njihnin qysh më heret, përveç Borkës. Ristoja i prezantoi.

Në orën 22 milicët e sollën Stevan Jovanoviqin, me duar të pranguara. Ristoja dha urdhër që t'ia hiqnin prangat. Milicët po ngurronin. ***“Nuk është e këshillueshme.”*** Tha njëri prej tyre. Ristoja përsëriti: ***“Hiqjani prangat!”*** Prangat u shkyçën. Stevanin e vendosën 2 metra larg tavolinës. Borka pyeti: „***Llagapi?.. Emri?.. Emri i atit?.. Data e lindjes?.. Vendbanimi?.. Shkollimi?.. Profesioni?..“*** Stevani iu përgjigj krejt i qetë. Pas kësaj u bë një pushim i shkurtër.

Sytë e Stevanit ishin të verdhë dhe të bufatur. Ndoshta nga mbingarkesa shpirtërore. Vetullat të verdha, flokët nuk i shiheshin. Ishte i qethur. Por krejt qenia e tij linte një pështypje oker. Ishte dukshëm muskuloz dhe me kockë të fortë. Mollëzat e faqevet i kish të fryra, që dëshmonin një lloj energjie të pashpjegueshme.

Ristoja i foli: ***"Ky është avokati yt, zoti Mirko Zvonar, doktoruar në shkencat juridike. E ka angazhuar kunata jote, zonja Vidosava Këstiq-Jovanoviq. Për çdo gjë që do të bëhet e padrejtë ose të duket e padrejtë, mund t'i drejtohesh këtij, për ndihmë dhe për mbrojtje ligjore. Unë jam gjykatësi hetues i emëruar për çështjen tënde nga udhëheqja e Prokurorisë Publike të qytetit të Beogradit. Më thonë Risto Kilibarda."***

Nuk qe e mundur të zbatohej asnjë procedurë e mëtejshme. Sapo Ristoja e shqiptoi llagapin e vet ***KILIBARDA***, çdo gjë u çrregullua. U përmbys krejt situata. Stevani brofi më këmbë papritur, mësyu drejt tavolinës, duke zgjatur të dyja duart drejt fytit të Ristos. Milicët e bënë zap me shumë vështirësi dhe mezi ia dolën t'ia vënë prangat. Ishte i fuqishëm si një ka, por edhe çirrej me zë prej kau: ***"Kilibarda është shqiptar! Kilibarda është shqiptar! Nuk lejoj të më gjykojnë shqiptarët!"*** Ristoja dha urdhër që ta çonin menjëherë në qeli dhe porositi që të thërrasin kryemjekun e burgut, Prof.Dr.Velko Velimiroviqin. Në kohën kur po e tërhiqnin drejt derës, ai u kthye edhe njëherë me fytyrë nga Ristoja dhe iu kërcënua rreptas: ***"Po guxove më këndej, të pret gjëmimi i rrufevet! („Dërznesh li dale, çuqesh gromove!") Varrezat e shqiptarëvet të presin!"*** Nëpët korridoret e burgut ushtuan për një copë herë të këlthiturat e tija: ***"Kilibarda shqiptar! Kilibarda shqiptar!"*** Dëgjohej ulurima e tij edhe përtej mbylljevet hermetike të ashensorit, deri sa ashensori humbi tatëpjetë ndërtesës në thellësitë e podrumevet. Kur u kthyen milicët dhe 2 kolegët hetues, Ristoja i pyeti me një zë të dridhur dhe nervoz: ***"A ulurinte edhe atje?" "Ka uluritur deri sa e kemi rrasur në qeli e po vazhdon edhe tani. Krejt burgu është alarmuar." „Le të shkojë në gop të sëmës!"*** Tha Ristoja dhe shtoi: ***„A e thirrët Velko Velimiroviqin?" „Po, e thirrëm." "Atëherë, në orën 2 prapë këtu!"*** U shtri sërish në kolltuk dhe u mundua më kot ta ndjellë gjumin.

HEROIZËM NË EMËR TË ATDHEUT

Prof.Dr.Velko Vvelimiroviqi nuk garantoi që ilaçet e injektuar do ta kryenin punën deri në orën 2. Ai ishte i mendimit që seanca e marrjes në pyetje të shtyhej për nesër në mëngjes. Ristoja u telefonoi: avokatit, sekretares dhe 2 kolegëvet, dhe pjesën e mbetur të natës e kaloi në shoqëri me Velko Velimiroviqin në lokalin më të afërt. Morën për të pirë verë të kuqe dhe për meze mëlçi dhe veshka të fërguara me qepë. Biseduan nga pak për çdo gjë, pa u thelluar në asnjërën prej temave

kardinale. Ristoja e njihte mjaftueshëm veprimtarinë e Prof.Dr.Velimiroviqit, prandaj dhe nuk shtyhej me të në biseda më të thelluara, por edhe Velkoja vetë ngurronte për t'iu hapur Ristos në biseda. Megjithatë, çdo gjë kaloi në atmosferë miqësore. Para se të zbardhte, shetitën pakëz në hollin e restorantit, e pinë kafen e mëngjesit dhe, fiks në orën 8, e kaluan me vrap, nëpër erë, largësinë midis restorantit dhe makinavet, për të shkuar te ***"trarët"***.

Doktor Velimiroviqi, në shoqërinë e 2 milicëve, zbriti në podrum, e vizitoi pacientin e vet në qeli dhe lajmëroi se mund të bisedohej me të.

Kur e sollën në zyrë, duke parë tëmthat, mollëzat dhe buzët e fryra të Stevanit, Ristoja dyshoi nëse deklarimet e tij do të mund të ishin ligjërisht të pranueshëm. Megjithatë, vendosi të provojë. Ia bëri disa pyetje, duke i përzgjedhur me kujdes. Përgjigjet ishin krejt të qarta, të qeta dhe gjakftohta. ***"Duke u marrë me kërkime shkencorë, kam konstatuar që gruaja ime, gruaja ime e dikurshme, kish prejardhje shqiptare. Pasojisht, edhe fëmijët e mi të dikurshëm, ishin shqiptarë. Llagapi i saj i vajzërisë ishte GOLAMADIQ. Kam udhëtuar deri në Kopenhagë në Institutin Balkanologjik 'Holger Pedersen'. Atje më është pohuar parrëzueshëm që fisi i GOLAMADIQVET janë vërtet shqiptarë. Kam udhëtuar edhe në Francë, në Institutin 'Desosyr'. Ata më kanë pohuar të njëjtën gjë, duke shtuar, sigurish për të qetësuar mua, se ata shqiptarë të dikurshëm janë sërbizuar prej kohësh. Por ajo për mua nuk ka qenë thelbësore, sepse gjaku edhe me shekuj nuk ndryshohet. Jam kthyer në shtëpi dhe kam kërkuar shpjegime. Në vend që të m'i pranojë të gjitha, gruaja ime, gruaja ime e dikurshme, e ka refuzuar me vendosmeri dhe me kokëfortësi çdo lidhje të saj me shqiptarët. Të njëjtin qëndrim kanë mbajtur edhe fëmijët e saj. Ajo për mua ka qenë dëshmi e mjaftueshme që aty kisha të bëja me kriptoshqiptarë, me shqiptarë të kamufluar, dhe rrjedhimisht me shqiptarë tepër të rrëzikshëm."***

Ristoja ka hapur bllokun e shënimevet, i cili gjendej mbi tavolinë, dhe ka lexuar 2 vargje: ***„Sërbi, o nëna ime, dhe verbër, dhe e shurdhër! O atdheu im, jonjerëzor, rrugëhumbur!"*** Pastaj e pyeti: „***A e kanë kënduar fëmijët e tu këtë këngë? "Refuzoj të përgjigjem!"*** Tha Stevani. ***„Kam të drejtë sipas ligjit që të mos i përgjigjem secilës pyetje."*** Ndërsa Borka po i shënonte hollësitë e dialogut, i pandehuri dhe hetuesi po e shikonin njëri-tjetrin mu në sy me ngulm. Stevani shtoi: ***„Sërbia nuk është nëna e tyre." „Po gjysmënëna!" „Gjysmënëna ndoshta, por jo nëna!"***

„Vazhdoje kallëzimin tënd!" Stevani vazhdoi: „***Që të bindem në vërtetësinë e gjetjevet të mia alarmante, vendosa të shtroj kushtin tim vendimtar e njëkohësisht të fundit. 'Në qoftë se do shpreheni hapur kundër së quajturës Parti***

e Rugovës, do të ju konsideroj shqiptarë të ndershëm dhe do t'i kursej jetët tuaja.' Të gjendur para një të atillë sprove vendimtare, ata, që të 3 njëzëri kanë deklaruar se nuk kanë asgjë kundër Rugovës dhe as kundër të quajturavet të drejta nacionale të shqiptarëvet. S'do mend që janë munduar të më bëjnë për vete edhe mua. Pas kësaj ka vazhduar grindja për 2 javë. Edhe ime shoqe, ime shoqe e dikurshme, edhe fëmijët e mi, fëmijët e mi të dikurshëm, e kanë ditur shumë mirë që unë kisha kaluar një jetë të tërë pikërisht në sistemimin sa më të sigurtë të varrezës definitive të shqiptarëvet. Jo varrezë e përkohshme, por varrezë përfundimtare, definitive! Më në fund, kam qenë i detyruar ta asgjësoj farën shqiptare edhe në familjen time." „Pra, ti ke vrarë 3 njerëz?!" „Natyrisht që i kam vrarë. Ç'mund të bëja tjetër?!" „Me ç'lloj arme?" „Me sëpatë edhe me thikë. S'kisha armë tjetër." "Mirë. Tani nënshkruaj!"

Stevani s'e kish kuptuar këtë qasje të kujdesshme dhe shumë dinake të gjyqtarit hetues. Nënshkroi. Fill pas tij vunë nëshkrimet edhe të pranishmit e tjerë. Ristoja ia dorëzoi dokumentet sekretare Borkës, dhe foli me ton ritual: ***„Pas 1 ose 2 orësh do të të nxjerrim para gjykatës së krimevet të rëndë. Atje do të vendoset nëse do të rrish në burg apo jo." "Nuk ka kurfarë arsyeje që të mbahem në burg."*** Tha Stevan Jovanoviqi. ***"Akti im është patriotik. Nuk po them heroik, sepse heronjtë e vërtetë të Sërbisë gjenden atje, në frontet e betejavet, në Srebrenicë, në Likë, në Banja Llukë, në Pale rreth Sarajevës, rreth Vukovarit, në Mostar. Por gjithsesi këtë vepër timen askush në Botë nuk do të mund ta vlerësonte ndrysdhe, veçse si një vepër atdhetarie. Rroftë Sërbia! Rroftë sërbizmi! Përndjekja e të Turqizuarvet (Istraga Poturica) po vazhdon sipas programit. Kurse ti je një shqiptar. Nuk të lejohet ta harrosh këtë! Je njëri prej mijëra shqiptarëve që jetojnë inkonjito në Beograd! Varet prej pretencës tënde a do të vlerësohesh si një shqiptar i ndershëm (poshteni Albanac) apo do të ndjekësh ish-Jasminën time, ish-Predragun tim dhe ish-Svetllanën time."***

KOKTEJ BRENDA NË VARR

Dfrejtori i Arkivit, më në fund, i priti para Akademisë, pikërisht para asaj dere anësore, ku Stevani pat tentuar të futë në arkiv viktimat e veta. E hapi derën dhe i udhëhoqi nëpër një korridor të thellë. I ndriçuar mirë, por me dyer të rralla, madje në formë të çuditshme, dukej si një katakombë antike, një imitim i tunelevet shpellorë. Arkivi ishte ende i mbyllur për shkak të ngjarjes që sapo kish ndodhur. Të gjithë frekuentuesit, gjegjësisht ardhësit e rregullt, akademikët, profesorët, shkrimtarët, politikanët, doktorantët, praktikantët e ndryshëm, gazetarët e autorizuar, ishin njoftuar që lënda e këtij Arkivi, deri në një njoftim tjetër, nuk do të shfrytëzohej. ***"Ky është mbajtur dhe mbahet në fshehtësi të rreptë." Sqaroi drejtori. "Këtu lejohet hyrja vetëm me leje të posaçme, kurse publikimi pa leje***

pëbën vepër penale.” Ristoja kish më shumë 2 dhjetëvjetësha që e shfletonte Kodin Penal, por një nen i këtillë nuk po i kujtohej.

Korridori ishte aq i gjatë, sa Ristos dhe Velkos iu duk sikur i kishin kaluar themelet e ASSHA-së dhe se tash ndoshta gjendeshin diku poshtë qendrës së qytetit. Trokëllitja e kundravet të Velkos (sepse të tjerët kishin shoje të gomtë), u hynte thellë në veshë dhe kishin përshtypjen sikur po u thelloheshin pafundësisht kanalet e veshëvet. Ish një torture e papërballueshme. Ristos i dukej sikur në çdo çast mund t’i pëlciste timpani i veshit. E tundte kokën, fuste në veshë herë njërin, herë tjetrin gisht të vogël. Drejtori e vuri re dhe e pyeti: ***“A keni ndonjë problem?“ „Jo.“*** Tha Ristoja. ***„Jam ftohur deri në atë shkallë, sa më duket sikur po fluturoj nëpër ajër.“*** Ndërsa me vete mendoi: ***„Punë djalli! Kur jam sëmurë, pse nuk rri shtrirë në shtëpi?!“***

„Kjo është dera hyrëse në ‘Varrezën e shqiptarëvet‘“. Po shprehem siç i pëlqente Stevanit fatkeq. “ Sqaroi drejtori i Arkivit. ***“Zyra pritëse, kartoteka kryesore, skedarët e hershëm… kohët e fundit kemi krijuar edhe skedarë të rinj, të kompjuteruar.”*** Para tyre u shfaq një tjetër korridor, më misterioz se ai i pari. Në anën e majtë shtrihej një galeri e madhe me qemer gjysmëharku, kurse në të djathtën ishin një varg dyersh më të vogla të siguruara me drynj të verdhë. Në hapësirë poshtë qemerit gjysmëharkor gjendej, siç tha drejtori, zyra pritëse. Ajo hapësirë duket se shërbente si një sallon, ku mund të merrej leja për të eksploruar lëndën, vendi ku duhej pritur gjersa të gjendeshin dokumentet, ndoshta edhe për të pushuar nga pak arkivistët, pas sorollatjevet disaorëshe midis dosjevet të zverdhura, here-herë edhe me pluhur. Salloni ishte i ndriçuar me llamba neoni. Duke ecur korridorevet, krijohej përshtypja se po shkohej drejt ditës. Në të vërtetë, rrugët çonin gjithnjë e më thellë drejt nëntokës, përherë e më larg dritës së diellit. Gjendeshin aty disa kolltuqe, vendosur rreth një tavoline prej xhami të trashë. Kish edhe 2 tavolina zyre dhe nja 10 karrike me shpinore të gdhendura artistikisht. Në mur, vendosur gjithashtu në 2 korniza të gdhendura me art, vareshin, si 2 kryevepra piktorësh, faqet-tituj të ***“Naçertanies”*** së I.Garashaninit dhe të ***“Elaboratit”*** të V.Çubrilloviqit. ***“Këta janë 2 Shkrimet tanë të Shenjtë.”*** Tha drejtori. ***“Janë 2 definicionet, 2 përkufizimet tanë themelorë të strategjisë dhe taktikës sonë drejt synimit për t’u zgjeruar në drejtim të detit, duke pastruar, pse jo edhe duke asgjësuar çdo gjë që s’është sllave në Ballkanin Jugperendimor. Në këtë Arkiv është dokumentuar me konsekuencë ç’është bërë konkretisht, pikërisht në zbatim të këtyre porosive që na i kanë lënë të parët tanë amanet.”*** Ai i tregoi me dorë 2 dokumentet e kornizuar. ***“Në krejt këtë punë nuk ka asgjë të panatyrshme dhe të paarsyetuar. Kemi qëmtuar lëndë arkivore prej arkivavet të vjetër mbretërorë, prej arkivavet të UPJ-së (Ushtrisë Popullore Jugosllave), prej arkivit të MPB-së (Ministrisë së Punëvet të Brendshme), prej arkivavet të***

republikavet, prej komunavet, prej shtypit, prej libravet me kujtime, të dhënat e dejtpërdrejta nga terreni, dëshmitë e procesevet gjyqësorë, me një fjalë, çdo gjë që lidhet me pakësimin e shqiptarëvet në Ballkan. (Jashtë Ballkanit le të shkojnë nga të duan.)" E shtoi, në kllapa, drejtori i Arkivit të Akademisë. Pastaj vazhdoi më tej: ***"Në të ndarat e posaçme gjenden të dhënat mbi popullimin e atyre vendeve me banorë sërbë. Arkivi ka disa nënndarje… Por, hajdeni të pimë diçka në zyrën time. Ditësh tjera këtu punon një pijetore mjaft e këndshme, por e kemi mbyllur përkohësisht."*** Duke hapur derën e rezidencës së vet, ai zgjati dorën e majtë: ***"Ky këtu është ashensori kryesor, nga zbresin e ngjiten shkencëtarët tanë. Ata nganjëherë vijnë këtu thjeshtë për një kafe, duke e ndier veten mirë në këtë, siç ata e quajnë, atmosferë antiarnaute."*** Risto Kilibarda vuri re në mur disa harta. Njëra prej tyre ishte harta gjeografike e Ballkanit, 2 të tjerat ishin topografike. ***„Durrësi, Selaniku..."*** Lexoi Ristoja dhe u ul në njërin prej kolltuqeve. Thjeshtë, u rrokullis, u rrëzua. Ndjehej tërësisht i dërrmuar.

Pa e ndërprerë përgatitjen e koktejit, drejtori tentoi të bënte pak humor: ***„Ndonëse jetojmë në këtë nëntokë, në shoqëri me shqiptarët e balsamosur, kemi nga pak edhe gjëra të shijshme. Prandaj, urdhëroni ju lutem, zgjidhini vetë pijet dhe mezet."*** E hapi derën e „***Obodinit"***. Ristoja u çua, mori atje një shishe dhe e mbylli menjëherë. ***„Zoti Risto është, siç duket, alergjik ndaj frigoriferëvet. Apo, ndoshta shoku?" "Më thërrisni si të doni, por mua me gjithë mend më ka hyrë të ftohtit në palcë."***

Sa po vazhdonte qerasja, drejtori u përpoq që t'u ofronte sa më shumë të dhëna organevet të prokurorisë publike. ***"Fatziu Stevan… (Ne tashmë vetëm kështu e thërrasim.) Ja pra, ai Stevani i sotëm fatzi, ka qenë një djalë shumë i mirë. Ka punuar me një të atillë vrull, sa të gjithë ne ia kishim zili vullnetit të tij të jashtzakonshëm… Gëzuar!"*** Të qerasurit u përgjigjën me të njëjtën fjalë. ***"Por më duhet të pranoj (Për këtë kam menduar dje edhe sot.), më duhet të pranoj që, megjithatë, gjendja e tij shpirtërore ka kaluar nëpër disa faza. Në fillim, në atë kohë kur ne po merreshim me zhvendosjen, sistemimin dhe plotësimin e dosarëvet, ai, duke lëvizur tutje-tëhu nëpër galeritë e Arkivit, këndonte me zë të lartë. Sokëllinte aq fort, sa jehonin krejt këto hapësira: 'Mbaroni punë, vëllezër, t'i shfarosim sa më parë!' Dhe vërtet, kishim krijuar përshtypjen sikur s'kish mbetur gjëkundi shqiptar i gjallë, aq të mëdha ishin shifrat. Me 2 e me 3 zero!.. Kjo ka qenë gjendja e tij e parë. Mirëpo, më vonë, s'më kujtohet viti, ndodhi në shtypin tonë një gjallëri lajmesh, mbi gjoja jetesën e mirë, mbi gjoja të drejtat dhe mbi gjoja përparimin, pikërisht të atyre që ne synonim për t'i shfarosur. Stevoja i lexonte ata artikuj gazetash dhe habitej. Bisedonim njëri me tjetrin. Kërkonim, të gjithë ne, jo vetëm ai, që të njiheshim me gjendjen dhe që atë gjendje ta krahasonim me rezultatet e punës sonë. Në proces ishte vënia në jetë e***

‚Naçertanies', Shkrimit të Shenjtë të kombit tonë, pra, pritej që një ditë ta përzinim, ta dëbonim përtej detit edhe josërbin e fundit dhe të përqafoheshim me dallgët në Durrës dhe në Vlorë. Në ndërkohë, ç'po na dilte?! Ata po krijonin shkolla të larta, universitete, po ndërtonin një bibliotekë impozante, promovonin akademi, shtypnin libra me shumicë. I shtypnin madje në gjuhën e tyre!.. E dimë tashmë: Fajtor për të gjitha këto na ishin Titoja me gjithë latinët e tij..."

„Stevoja ka qenë më këmbëngulësi midis nesh. Ai kërkonte veprime. Nuk pajtohej vetëm me konstatime, që nuk do të shoqëroheshin me punë. Më kujtohet që, në ata vite, pat kërkuar ndonjë mënyrë për ta hequr qafet Titon. Thjeshtë, ta vriste, sepse u kish dhënë shqiptarëvet të drejta të tepërta. Pastaj i pat hyrë një tjetër mënyre të vepruari: Kërkonte lidhje vetëm me ata njerëz që konsideroheshin sërbë të pastër. Krijonte njohje me ta, u shkruante letra. Në ato ditë më ka propozuar personalisht mua që këtu të krijoheshin edhe 3 arkiva të ngjashëm me këtë: 1 për latinët, 1 për turkoshakët dhe 1 për hungarezët e shvabët. Doktrina e tij ishte: Kush nuk është një sërb i pastër, nuk ka vend në Jugosllavi."

"Më vonë, papritur, ndodhi tek ai një lloj tendosjeje dhe një ngurrim. U tendos dhe sikur u paralizua. U bë si gur. Pushoi së foluri. I humbi entuziazmi, i cili tek ai ishte i dukshëm. Iu ndyshuan edhe zëri, edhe shprehja e fytyrës. Shprehja e fytyrës iu bë sikur nuk ishte ai Stevo Jovanoviqi që ne e njihnim prej vitesh."

Ristoja pa dashur e pa fytyrën e Velkos. Por, në të njëjtën kohë edhe Velkoja e hodhi shikimin kah Ristoja.

„Më ka kërkuar leje, me qëllim që të shkonte deri në Kopenhagë." „Në Kopenhagë?" Pyeti Ristoja***. „Po. ia kam dhënë lejen... Disa ditë më vonë na kanë njoftuar që ka bërë skandal në një librari këtu në Beograd. I ka thyer xhamllëqet e asaj librarie, i ka hallakatur librat, hedhur në trotuar dhe krejt ato marrëzi i ka kryer duke sokëllitur: 'Poshtë filologjia!' ... Ne nuk kemi guxuar t'i kërkojmë shpjegime. E konsideruam më me vend që të mos ia kujtonim atë ngatërresë... Tani, nëse dëshironi, mund të ju shetis nëpër ambientet e Arkivit. A keni pyetje, zoti Kilibarda?"***

Arkivi ishte i vendosur nëpër galeri, të cilat degëzoheshin djathtas e majtas, mbase midis plintavet gjigante të Akademisë. Ngjanin me kapilare të përbindshëm, nëntokësorë, që furnizonin me lëngjet e duhur trupin e vet përmbi tokë. ***„Nëpër galeri,"*** tha drtejtori***, "dosjet janë të klasifikuara në korpuset përkatës, secilit korpus i takon një numër dhomash, që janë të pajisura me rafte të shumtë, siç e shikoni. Çdo gjë është sistemuar sipas rregullavet më bashkëkohore të shkencavet të arkivimit. Kemi nëpër kryqëzime dhomash edhe anekse të***

përshtatshëm në formë minisallash për lexim, në të cilat shfrytëzuesvet mund t'u shërbehet me minikartoteka dhe me minivideoteka." "Duket hapësirë goxha e madhe." Vëretji Ristoja. ***"Aq shumë jemi zgjeruar ,*** sqaroi drejtori me një dozë vetëlavdërimi, ***"sa nuk na kanë mjaftuar themelet e Akademisë. Jemi detyruar të përvetësojmë katet e nëndheshëm të të gjitha ndërtesavet rretherrotull."*** Heshti pak sekonda, pastaj shtoi me një pakënaqësi të dukshme: ***„Dhe u paguajmë qiranë ndërtesavet, sikur krejt këto punë i bëjmë për interesin tonë personal."***

Risto Kilibarda e pyeti papritur drejtorin e Arkivit të Akademisë: ***„Përse krejt kjo lëndë nuk është depozituar në arkivat e Shërbimit Shtetëror të Brendshëm?"*** Drejtori u mendua mençurisht. Sytë i shkëndijuan. Fytyra i shkëlqeu. Më në fund u përgjigj vetëm me një shprehje: ***„Akademia është truri."***

Që të 3 nxitonin midis galerivet të ndriçuara mirë. Hynin aty-këtu në dhomat, lexonin shpinat e dosjevet. Drejtori komentonte pa pushim, por Ristos i përshtatej më shumë t'i shikonte vetë etazherët e sirtarët dhe t'i lexinte vetë titujt. Kjo ishte arsyeja, siç duket, që, pas disa minutash, në krejt atë kompleks nëntokësor, mbizotëroi një qetësi supersticioze. E kishin kaluar sektorin e përvojavet botërore në punët e etnondryshimevet. E kaluan edhe një kënd të vogël të shërbimevet profesionalë.

E panë kalimthi, por jo pa kurreshtje, sektorin e etnitetevet në kohën e skllavopronarisë, helenizimin e substratit parahelen në shtetet e vegjël arkeogrekë pas rënies së Trojës, pasuksesi i faraonëvet të gjithfuqishëm të Egjiptit në përballjen me, të thash, një grusht hebrenjsh. Në vazhdim e panë edhe Kohën e Romës. Procesin e latinizimit, gjegjësisht të romanizimit, filluar nga etruskët, te ardhësit trojanë të të njëjtit gjak e deri te tjetërsimi i dakëvet e i galëvet. Roma përballë ilirëvet. A ekzistonte mundësia e ilirizimit të Romës? Mungesa e shkrimit te ilirët, shpëtimi i Romës. Nëse Iliriku i madh do të kish praktikuar shkrimin në gjuhën e vet, siç ka vepruar psh një Greqi e vogël, në vend të Perandorisë Romake, historia do të kish njohur Perandorinë Ilire dhe ilirizimin në shkallë Evrope.

„Kjo është për ne njëra prej pjesëvet më të rëndësishme." Tha drejtori, i cili qysh prej fillimit bënte rolin e ciceronit. ***"Përvoja e paraardhësvet u siguron rrugë të suksesshme atyre që vijnë pas tyre. Pamundësimi i shkollimit të shqiptarëvet në gjuhën e tyre ose, së paku, pengimi në çfarëdolloj mënyre, ndikon shumëfish më tepër se sa një arsenal i tërë me armë kimike."*** Kjo ishte shenja që drejtori i nderuar e njihte shumë mirë punën e zotit Velko. Ristoja e kuptoi dhe ndërhyri sakaq: ***"Po kur kimia lëshohet si një skifter përsipër shkollarëvet?!" "Atëherë gjithë nderimet atij që e shndërron kiminë në një skifter."*** E lëvdoi tërthorazi drejtori i Arkivit kolegun e Ristos.

Shkuan më tej. ***"Ciceroni"*** po tregohej shumë i gatshëm për t'ua shuar kurreshtjen vizitorëvet. ***"Roma dhe Grqia. Ndikimi i Greqisë në kulturën e Romës"… "Lashtosllavët, njëri ndër kapitujt më të rëndësishëm në historinë e njerëzimit. Shtrirja jonë drejt Perendimit dhe drejt Jugut. (Që të mos e përdorim shprehjen 'ekspansioni'.) Përvetësimi dhe të përhapurit e shkrimit cirilik, përdorimi i gjuhëvet tona sllave në shkresat tona dhe në librat, një akt vendimtar në përjetësimin e ekzistencës sonë. Ne në Ballkan. Metodat e monarkëvet tanë. Përse nuk ia dolëm ta sllavizojmë Greqinë? Ardhja e turqvet e ka shpëtuar Greqinë prej asimilimit nga ana jonë. Përse nuk u sllavizuan rumunët dhe hungarezët? Përse nuk mundëm t'i sllavizojmë të gjithë shqiptarët?"***

"Këtu, një projekt strategjik shumë interesant." Ishte një e ndarë e veçantë, e ndërfutur në brendësi të një kolonade të stërmadhe. Sergjenët ishin gjithashtu të trashë, të stërmdhenj, bërë prej dërrase lisi lyer me llak të vërdhemë. ***"Është vazhdimi i strategjivet tona tashmë ekzistuese: Në ç'mënyrë t'i kthejmë në sllavë rumunët, hungarezët dhe grekët dhe si t'i japim fund sllavizimit të pjesës së mbetur të ilirëvet, atyre që sot e quajnë veten shqiptarë. Sa kohë do të na duhet që ta përfundojmë krejt këtë punë, ndërsa qëllimi është, më një anë, të mos ketë kombe të tjerë midis nesh dhe rusëvet, më anë tjetër, të mos ketë pengesa për sllavët nga Ngushtica e Beringut deri në Ngushticën e Gjibraltarit. Në krejt këtë strategji tonën shtrohet pyetja: Cila është metoda më frytdhënëse, asimilimi apo thjeshtë spastrimi?"***

"Zotërinj të nderuar, ju edhe vetë po e shihni se sa të komplikuara janë këto gjëra, edhe në teori, edhe në praktikë. Shihni këtu: Evropa në zbulimet gjeografikë. Evropianët zhvendosen drejt Perendimit dhe ngulen në Amerikë. A do të tjetërsoheshin popujt e moçëm të atjeshëm, në qoftë se evropianët nuk do të kishin marrë me vete edhe shkrimin së bashku me pushkën?"

"Ktu kemi të ndarën, Afrika dhe Franca. Ndoshta do të qe më dejt: E bardha mbi të zezën, siç na propozonte nganjëherë fatziu Stevo. Turqit dhe armenët. Masakrimi i armenëvet. Kuriozitete të etnocidit nga vende të ndryshëm të botës. Udhëpërshkrimet, kujtimet, përjetimet." Velkoja u ndal sipër një albumi. ***„Aty janë sportet e baskëvet, traditat e tyre sportive."*** Sqaroi drejtori. ***„Dhe shtrohet pyetja: Mos janë sportet njëri prej shkaqevet që kombi bask nuk është zhdukur? Çdo gjë që lidhet me shfarosjet, gjendet në këtë Arkiv. Megjithatë, unë nuk jam i bindur që ky Arkiv është i vetmi i këtij lloji në botë."***

Nuk po e përcaktonin dot sa kohë kish kaluar dhe sa do t'u duhej ende deri në fund. Ristoja ndjehej si brenda një varri të stërmadh. ***„Mundet që Stevani është ndier pikërisht kështu, veçse rezultati ka qenë i kundërt."*** Mendoi dhe vazhdoi të

ecë. ***„Po bredhim si ca krimba të uritur nëpër një katakombë të kruajtur dhe të brejtur gjer në palcë.“*** Për një moment i shkoi mendja që aty as orës nuk mund t'i besohet. Ish vërtet i sëmurë.

“Kjo ishte, zotërinj, vetëm hyrja në Arkivin e Stevan Jovanoviqit.” U tha atyre papritur drejtori. “***Pikërisht prej kësaj pike të nëntokës sonë fillon edhe puna jonë burimore. Prej këndej shpërndahen degëzimet nëpër të gjithë indet e etnitetit tonë, ngjashëm me instalimet e ujësjellësvet.”***

PËR HATËR TË DARINKËS

Plak Miquni ishte vetëm në banesë. Rrinte në ballkon dhe këngëtonte. Xhami i dyfishtë e mbronte nga era, ndërsa shikimi mbi Beograd ishte mahnitës. Ristoja iu afrua me hap të ngadaltë. ***„Mali i Zi, o krenaria jonë!” (Diko nasha, Cërrna Goro!”)*** Ky ishte vargu që, për të kushedisatën herë, përsëritej në buzët e tija. Sa e pa Riston, Miquni u kthye dhe faqet e tija ndriçuan si xhami përballë diellit. ***“I falem Zotit, që më je shëndosh e mirë!” “Hajt të këndojmë bashkë!”*** Tha Ristoja dhe menjëherë filloi me ritmin e valles: ***“Mali i Zi, o krenaria jonë! Mali i Zi, o krenaria jonë!”*** Plaku e shoqëronte. Darinka nuk ishte kthyer ende nga puna, kurse Cvetkoja, siç dukej, ish vonuar në fakultet. ***„A ke ngrënë mëngjes?“ Pyeti Ristoja, ndonëse ishte mesi i ditës. „Jo ende.“ „A do të ta fërgoj një vezë me proshutë?”*** Në vend të kundërshtimit, Miquni iu përgjigj me hoke: ***“Nëse doni që plaku juaj të vdesë sa më parë, ushqejeni me vezë pule dhe me proshutë derri!”***

Ristoja e përgatiti omletën me nga 2 vezë, fërguar “***malazezçe”***, me nga një copë të bollshme proshute dhe me disa copëza mishi të bardhë derri. I vendosi përmbi stol edhe 2 gota me verë të kuqe Cërrnice. Në atë ballkon të vogël beogradas lulëzoi për një çast një pjesë e vogël e Malit të Zi, por mbyllur ndër xhama, si një peshk gjucë në akvarium. Godinat shumëkatëshe të Beogradit, shikuar prej asaj lartësie ku ata gjendeshin, ngjante çuditshëm me copat e një buke misri. ***“Parmbrëmë më je shqetësuar shumë,”*** tha Miquni, ***“por faji ishte krejt i imi.” “Ti je fajtor më pak se të gjithë ne.”***

Biseda ishte qetësuese, mëngjesi, gjagjësisht dreka, ishte e shijshme, por vetë ata nuk ishin të qetë. ***“Kemi luftuar, jemi plagosur, jemi bjerrë në luftë, kemi punuar me përkushtim dhe pa u lëkundur, kushtuar një Jugosllavie të Re, siç e kishim bërë traditë ta quajmë. E tash, ja se ç'po punohet në këtë Jugosllavi! Luftojmë kundër njëri-tjetrit. Grindemi edhe këtu, në këto më pak se 100 metra katrorë. Vritemi!”*** Ristoja nuk po mund të bënte dallimin, ishin mendimet e tij ata mendime, apo të të atit. Miquni e vendosi dorën mbi gjurin e të birit: ***„E di, Risto? Unë mendoj që, për hatër të Darinkës, të mos e përmendim më Malin e Zi në këtë shtëpi.“*** Ristos i mbeti kafshata e bukës në fyt.

KË KA VRARË STEVAN JOVANOVIQI ?

Në gjyq nuk po mund të merrej vesh, as se kush e bënte padinë, as kush po e mbronte të padituri, as kush po gjykonte dhe as kujt po i bëhej gjyqi. Dukej sikur ish gjykimi më kundërthënës në botë. Ristoja e lexoi pretencën e vet, në të cilën thajse asgjë s'u muar vesh. Doktor Velko Velimiroviqi nuk paraqiti raport me shkrim, ashtu siç e kërkonte rregullorja. Ai njoftoi vetëm gojarisht që pacienti i tij konsiderohej aq i sëmurë, sa që gjykata do të duhej ta lironte dhe rekomandoi për të mjekim intensiv. Avokati i paguar, Mirko Zvonari, nuk tha as edhe 1 fjalë dhe kjo u konsiderua si dukuria më enigmatike në historinë e drejtësisë. I padituri Stevan Jovanoviqi ngulmonte pa u lëkundur, që gjyqi ta lironte sa më parë dhe ta shpallte të paktën atdhetar të merituar. ***"Ke vrarë bashkëshorten tënde, nënën e fëmijëvet të tu." "Kam vrarë një shqiptare. Në Arkivin tim ka me mijëra sërbë, të cilët kanë shuar e shfaruar me dhjetëra mijë shqiptarë dhe, kundër tyre, krejt arsyeshëm, nuk është ngritur kurrfarë padie. Nga na del tani një akuzë penale kundër meje?!" "Ke vrarë djalin tend!" "Kam vrarë një shqiptar." "Por në damarët e tij rridhte edhe gjaku i të parëvet të tu." "Në damarët e tij rridhte edhe gjak shqiptarësh. Shkenca nuk ka arritur që ta kursejë njërën pjesë të përbërjes gjenetike duke asgjësuar pjesën tjetër të po asaj përbërjeje. Këtë ju duhet të ma njihni si një sakrificë. Pothuaj një vepër heroike."*** Në fund, nuk qe e mundur të nxirrej kurrfarë konkluzioni i saktë. Nuk qe e mundur madje as të konkludohej kush kënd e kishte vrarë, gjegjësisht asgjësuar. A ishte ai, Stevani, ai, papërcaktueshëm i padituri Stevan Jovanoviq, që e kish asgjësuar familjen e vet, asgjësuar veten, asgjësuar apo bërë nul institucionin e vet , Akademinë Sërbe të Shkencavet dhe Artevet, vrarë 3 shqiptarë të parëndësishëm, apo praktikisht vrarë krejt Sërbinë. Kryesuesi i gjykatës së krimevet të rëndë nuk pati guximin ta lironte fajtorin, ndonëse dukshëm po lëkundej.

Në ndërkohë, zonja Vidosava Kërstiq-Jovanoviq e kish lajmëruar funeralin e kunatës së vet, mbesës së vet dhe nipit të vet.

TURPI I RADHËS

I pari që foli, sapo Ristoja hyri në banesë, ishte Cvetkoja. Në të vërtetë, ai ishte i pari dhe i fundit, gjegjësisht i vetmi anëtar i familjes Kilibarda i gatshëm për të folur atë mbrëmje.

Në internet qe shfaqur lajmi mbi zhurmën që kish bërë Stevan Jovanoviqi natën e shkuar në ambientet e prokurorisë publike dhe në burgun e Beogradit. Në pjesën hyrëse të njoftimit qëndronte sqarimi që administrata e një dege të punëvet të brendshme dhe zyra prokurorisë publike gjenden në të njëjtin kompleks ndërtesash,

gjë që nuk i përgjigjej plotësisht së vërtetës. Në podrumet e ndërtesavet, thuhej në vazhdim, gjendet një numër i madh qelishë për të ndaluarit dhe të burgosurit, të cilët presin, ndonjëherë edhe me muaj, për t'u nxjerrë para gjyqit.

Mbrëmë, në ato ndërtesa dhe në atë burg të Beogradit, është shfaqur një nga pjesët teatrale nga më tërheqëset. Njëri nga të ndaluarit, vrasës i 3 pjesëtarëvet të familjes së vet, në kohën kur milicët po e tërhiqnin nëpër korridoret, duke bërrtitur me zë shumë të lartë, ka deklamuar një parullë të çuditshme: ***"Kilibarda, shqiptar! Kilibarda shqiptar!"***

Pas kësaj, vinte sqarimi tjetër: Kush është Kilibarda? Kilibarda është njëri ndër gjyqtarët hetues më autoritativë në qytetin e Beogradit. Me kombësi është malazias. Është i biri i Miqun Kilibardës, komandirit partizan në formacionet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave (në Luftën e Dytë Botërore), më vonë oficer shumëvjeçar i Ushtrisë Popullore Jugosllave, vendosur në Beograd qysh në vitet 1960.

Problemi i prejardhjes së llagapit KILIBARDA, qysh mbrëmë është bërë objekt i etimologëvet të botës. Cila është prejardhja e këtij patronimi? Rrjedhimisht, cila është prejardhja e vetë bartësvet të këtij patronimi? Po përflitet, gjegjësisht, po spekullohet, sikur ai vrasësi i përmendur, uluritësi i mbrëmshëm, me anë të kërkimevet në fushë të etimologjisë, paska ardhur në përfundimin që gruaja e tij qenkësh me prejardhje shqiptare dhe, pikërisht për këtë, e ka masakruar me një thikë kuzhine. I njëjti puritan (i një lloji të veçantë) e ka shpallur mbrëmë shqiptar edhe hetuesin e vet, zotin Risto Kilibarda, duke e refuzuar kategorikisht dëshmimin para tij.

Me britma të forta në dritaren e qelisë ***„Kilibarda shqiptar! Kilibarda shqiptar!"***, ai ka shkaktuar mbrëmë alarm të vërtetë midis të burgosurvet. Alarmi është përhapur edhe jashtë murevet të burgut, ka mbërritur te veshët e gazetarëvet kurreshtarë dhe gazetarët u janë drejtuar dijetarëvet të specializuar. Ka dalë më në fund në shesh edhe një gojëdhënë folklorike, trashëguar kushedi prej cilës kohë, mbi një farë paraardhësi të fisit KILIBARDA, i cili, siç thuhet, paska pasur një kalë të bardhë. Në gjuhën shqipe, siç pretendojnë spekullantët, shprehja ***KALI I BARDHË*** ka kuptim shumë të qartë. Mbetet enigmë, por edhe një motiv kurioziteti, nëse do ta pranojë zoti Kilibarda prejardhjen e tij shqiptare dhe si do të reflektohet kjo në të ardhshmen midis ekstremistëvet nacionalistë sërbë e malazias?!

Cvetkoja i lexoi krejt këto me një zë që i dridhej. E mbaroi të lexuarit. Iu kthye gjyshit të vet dhe e pyeti: ***"Gjysh Miquni, a mund të sqarosh ti ndonjë gjë?"*** Miquni u përgjegj krejt indifferent: ***"Ekziston një gojëdhënë rreth një kali të***

bardhë, por, a lidhet a s'lidhet kjo me gjuhën shqipe, s'ia kam haberin." Darinka, gjatë gjithë asaj kohe, pa e hequr grykësen e kuzhinës, ish ulur pranë Cvetkos dhe kish ndjekur me sy krejt ato çfarë kish lexuar Cvetkoja. ***"Turpi i radhës!"*** Murmuriti plot nerva dhe, me hapa të shpejtë, kaloi në dhomën e gjumit, u plandos në krevat, gjithnjë pa e hequr grykësen e kuzhinës. ***"Turpi i radhës!..Hapu, tokë, të na mbulojë balta!"***

NË KULMIN E PËRNDJEKJES SË DYTË

Sapo u vendos në gjyq që Stevani të mb etej në burg dhe të vazhdonin hetimet mbi veprën e tij kriminale, e çuan në qeli dhe e zuri gjumi menjëherë. Ishte nën ndikimin e forte të ilaçevet. U zgjua nga ora 3 e meëngjesit. Duheshin edhe nja 5 orë që të zbardhte drita.

U çua, u kap fuqishëm pas hekuravet dhe filloi të bërtasë: ***"Vëllezër të burgosur dhe vëllezër malicë!"*** E përsëriti të njëjtën fjali më shumë se 10 herë. Gardianët u përpoqën ta heshtin, por nuk ia dolën. Pasi u bind që shumica e të burgosurvet ish zgjuar, ai vazhdoi: ***"Vëllezër të burgosur dhe vëllezër malice! Përndjekja e Dytë e Turkoshakëvet është në pikun e plotë. Më shumë 8 mijë turkoshakë të Srebrenicës tashmë janë rrasur nëpër gropa, të hapura me ngut. Kufomat e tyre i kanë mbuluar me buldozerë. Ato kufoma të atyre turkoshakëve tradhtarë tashmë po kalben nën dhe. Tejpërtej pjesës perendimore të atdheut tonë, në Bosnjë e Hercegovinë, janë shfarosur me dhjetëra mijë të tillë turkoshakë, tradhtarë të besimit tonë të krishterë, dhe do të vazhdojë përndjekja e tyre deri sa të mos mbetet qoftë edhe njëri prej tyre i gjallë. Luftimet po vazhdojnë rreth Sarajevës, rreth Zenicës, rreth Dobojit, rreth Banja Llukës, rreth Mostarit."***

Ish i bindur që e gjithë masa e të burgosurvet tashmë ishte zgjuar dhe se të paktën më të afërmit po e dëgjonin dhe po e kuptonin. ***"Të dashirit vëllezërit e mij fatkeqë! Më dëgjoni me vëmendje dhe kur unë ta kem mbaruar fjalimin tim, kalojeni këtë fjalim atje ku tash nuk po dëgjohet! Ideja e Përndjekjes së Turkoshakëvet po zgjërohet edhe mbi llacmanët (kroatët), sepse edhe ata janë tradhtarë të krishtërimit të sërbëvet. I njëjti fat i pret edhe ata. Ne do t'i marrim Vukovarin dhe krejt Sllavoninë, edhe Dubrovnikun, edhe Shibenikun, edhe Zarën. Do t'i ngjeshim kroatët llacmanë sa më tutje drejt Perndimit. Thjeshtë do t'i dëbojmë, siç kemi dëbuar hungarezët prej Vojvodinet dhe siç e kemi spastruar Baranjën prej gjermanësh. Kuptohet vetëvetiu që e pret i njëjti fat, madje edhe më i keq, famëkeqen klikë të shqiptarëvet. Shqiptarët janë njerëzngrënës! Vdekje të gjithë shqiptarëve në botë e kudo që janë!"***

Korridoret e burgut në çast kanë bubulluar dhe kanë gjëmuar me të bërtitura të njëpasnjëshme: ***"Vdekje shqiptarëvet!.. Vdekje shqiptarëvet!"*** U dëgjuan të

përplsura diku në thellësi. Gardianët vrapuan në atë drejtim. Duket se midis të burgosurvet kish edhe shqiptarë, prandaj atje kish plasur e rrahura. Nuk po kuptohej kush kënd po e sulmonte, por të përplasurat nuk pushuan një copë herë të mirë, deri sa urdhërat e milicëvet arritën të mbizotërojnë. Atëherë Stevani vazhdoi: ***"Më dëgjoni, vëllezër të burgosur dhe vëllezër malicë! As ne këtu në Beograd nuk na lejohet të rrimë duarkryq. Unë tashmë e kam dhënë shembullin tim. Në Beogradin tonë ka edhe shumë shqiptarë të kamufluar e ne kemi detyrë që t'i zbulojmë sa më parë. T'i zbulojmë dhe t'i neutralizojmë! Kjo, për ne beogradasit, është detyra më e ngutshme në këtë kohë të shenjtë për Sërbinë. Rrofshi!"***

Hapësirat e burgut kanë bubulluar përsëri dhe kanë gjëmuar, ngjashëm me eksplodime të nëndheshëm.

SHESHELI SHQIPTAR

Në orën 5 u dëgjuan sërish të sokëlliturat e Stevanit, por tash me një zë dukshëm të ngjirur. Numëronte llagapet e shqiptarëvet të kamufluar, të cilët, sipas tij, nganjëherë mund të ishin më të rrëzikshëm se vetë Ibrahim Rugova. Në qendër të demaskimit të tij të bujshëm dhe të zhurmshëm ishin emrat e Millan Sheshelit dhe Momir Bullatoviqit, që ai i thoshte ***Bullati***. Për disa minuta nuk pushuan brohoritë: ***"Sheshel-shqiptar! Sheshel-shqiptar!"*** dhe "***Bullat-shqiptar! Bullat-shqiptar***!" Pastaj***: "Llaliq-shqiptar! Llaliq-shqiptar!"***, duke aluduar te Mihaillo Llaliqi, shkrimtarin e njohur antishqiptar dhe ***"Qosiq-shqiptar! Qosiq-shqiptar!"*** duke aluduar te Dobrica Qosiqi. Llagapet e këtyre personaliteteve të njohur, Stevani i shpjegonte me fjalë të gjuhës shqipe: ***shesh, baltë, lalë dhe qëros (qos)***. Të burgosurvet e gjithë kjo u dukej interesante. E krahasonte arkimandritin Amfillohije me vlladikë Danillon. Veten e krahasonte me Vuk Miqunoviqin. Në atë dalldisje të entuziazmit të përgjithshëm dikush propozoi që Prof.Dr.Stevan Jovanoviqi të emërohej në krye të Akademisë Sërbe të Shkencavet dhe Artevet. Disa të tjerë ishin të mendimit që në krye të ASSHA-së të vendosej arhimandriti Amfillohije. Atëherë Stevani, i joshur këndshëm prej së atillë propozimesh të mençur, u kërkoi patetikisht bashkëvuajtësvet: ***"Ju ftoj t'i japim një nderim vlladikës së sërbëvet të Cetinjës, Danillo Petroviqit, ideatorit dhe realizuesit të Përndjekjes së Parë të Turkoshakëvet!"*** Pasoi heshtja për nder të vlladikës. Mbas heshtjes, Stevani e shqiptoi solemnisht fjalën ***"Lavdi!"… "Lavdi!"*** Ushtoi në kor i gjithë burgu.

Nuk qe e qartë nga filloi dhe pse u pësërit brohoritja e pakmëparshme: ***"Sheshel-shqiptar! Sheshel-shqiprat! Sheshel-shqiptar! Sheshel-shqiptar!"*** Atëherë Stevani e pa të arsyeshme të bëjë një sqarim shtesë: ***"Nuk na lejohet të harrojmë***

që, tash për tash, Millan Shesheli konsiderohet një shqiptar i ndershëm (poshteni Albanac)!"

VARGU I KRIPTOSHQIPTARËVET

Sekretarja Borka Smilaniq e lajmëroi Riston mbi ngjarjet para festës, sapo ai, pas festës, erdhi në punë. Ristoja i kërkoi raportin me shkrim. E lexoi, pastaj e lëshoi qejfprishur mbi tavolinë. ***"Ka gjëra të reja edhe në rrjetet e internetit."*** Tha Momoja, pa e hequr shikimin nga kompjuteri. Ristoja e hapi kompjuterin e vet. Ishte lista e të quajturvet shqiptarë latentë, shqiptarë të fshehur, të cilët, kinse padrejtësisht i burgosuri Prof.Dr.Stevan Jovanoviqi i kish nxjerrë në dritë në mitingun e të burgosurvet, mbajtur në ambientet e burgut të Beogradit në mëngjesin e Ditës së Krishtlindjevet. Lista e llagapevet ish publikuar sipas radhës alfabetike, me vërejtjen që ajo renditje ishte e redaksisë së një portali. Fjalët shqip, me të cilat gjoja janë shpjeguar ata llagape, ishin të vendosura në kllapa. ***„BALASHEVIQ (shqip: balash), BALEVIQ (shqip: balë), BALOSHEVIQ (balosh), BULLATOVIQ (baltë), BËRGJANIN (breg, brigje), BURIQ (burrë), BURMAZOVIQ (burrë i madh), CUCKIQ (cucë), ÇALLOVIQ (i çalë), DEDIQ (Dedë), DREKALLOVIQ (Ndrekë, Ndrekël), GJOKIQ (Gjokë), GJOLLOVIQ (gjolle), GJONOVIQ (Gjon), GJEKANOVIQ (Gjekan), GASHIQ (Gash), EGRIQ (i egër), KALEVIQ (kalë), KALEZIQ (kale-zë), KILIBARDA (kalë i bardhë)."*** Ristoja ndaloi. ***"Pash Zotin, si lexohet kjo?!"*** U ndal, e shihte me ngulm dhe i habitur atë llagap të vetin, me të cilin ishte shërbyer më shumë se gjysmë shekulli, tentoi që fjalët në kllapa t'i shqiptonte tingull pas tingulli ***"k-a-l-e-…i…b-a-r-d-e"*** dhe në fund shfryu vrazhdë: ***"Gënjejnë, ngordhësirat!"*** Megjithatë nuk e ndërpreu të lexuarit. ***"KLAJEVIQ (me kla, me qa), KLAJIQ (me kla, me qa), KËRCUNOVIQ (kërcu- n), KRIJEVIQ (krye), LLALEVIQ (lalë, prej vëlla), LLALIQ (lalë, prej vëlla), LEKIQ (Lekë), LEKOVIQ (Lekë), LESHEVIQ (lesh ose Llesh), LESHKOVIQ (leshko), LESHOVIQ (lesh), LOPIÇIQ (lopë, lopçë), LUMEZIQ (lumë-z), MALESHOVIQ (malësh), NIKEZIQ (Nikë-z), NILLOVIQ (Nilë), NUSHIQ (Nush)."*** Ristoja u ndal sërish: ***"N-u-s-h, sajime injorantësh"***. ***"PLAKIQ, (plak), PRENTIQ (Prend), PRFENTOVIQ (Prend, Prento), SHALIQ (shalë), SHESHEL (shesh)." "Ta lexojmë: s-h-a-l-e, s-h-e-s-h, broçkulla budallenjsh."*** Ta shpallësh shqiptar politikanin më të dalluar për antishqiptarizëm, më të flaktin nacionalist të Sërbisë, kjo e shpjegon më së miri rrënimin psikik të atij njeriu. Ristoja gati i dha të drejtë Velko Velimiroviqit për t'ia ndërruar pretencën Stevan Jovanoviqit dhe për të kërkuar që, ose të lirohej, ose të kalohej në spital. Ç'mendoi me vete, filloi edhe me zë ta thotë, por Momo Gënçareviqi ndëhyri: ***"Me sa di unë,"*** tha ai, ***"ka shqiptarë të panumërt, me mijëra, nga ata që i kanë shërbyer në mënyrën më***

besnike Turqisë, madje edhe janë vrarë për Turqinë. Përse të mos besojmë që, po aq shqiptarë i kanë shërbyer dhe po i shërbejnë edhe Sërbisë?!" "Ti mendon që Shesheli e di prejardhjen e vet?" Pyeti Ristoja. ***„Unë nuk e di. Por nuk do të betohesha që Shesheli nuk e di."*** Ristoja vazhdoi leximin në intgernet: ***„SHESHLIJA (shesh, nga folja me pa)." "Gënjejnë!" "Çka the?" "Thashë që gënjejnë!"*** U përgjegj Ristoja. ***"SHKULETIQ (me shkulë)." "Qe prapë: m-e-s-h-k-u-l-e. Unë i njoh Shkuletiqtë. Ata nuk ngjajnë fare me shqiptarët." "SHKUNDIQ (me shkundë), SHOQ (shok), SHOSHKIQ (shoshkë), SHTEKOVIQ (shteg), SHTILANOVIQ (me shti), VESHOVIQ (vesh), VUKSHALIQ (Vukë-shalë), ZEMIROVIQ (zë i mirë), ZOGOVIQ (zog), ZOTOVIQ (zot,)."*** Në fund qëndronte shënimi: ***"Secila nga këto familje apo vëllazëri i ka me dhjetëra e diku edhe me qindra anëtarë. Le t'i shtojmë kësaj edhe lidhjet e tyre të gjakut me sërbët joshqiptarë, dhe vetëm atëherë mund ta marrim me mend se sa të atillë antisërbë të fshehur jetojnë midis nesh."***

Në vazhdim, ish dhënë lajmi që, në një lagje të jashtme, pranë bregut të Danubit, ishte shpallur një shoqatë e re qytetare me emrin ***"Djelmoshat e Stevanit" ("Stevanovi Momci")***.

ZONJA E ZEZË E DYZUAR

"Ka kaluar më shumë se 1 javë dhe trupat e të masakruarvet gjenden ende në morg. Organet e shtetit nuk kanë rregulla të shkruara se si duhet vepruar në raste të tillë. Por, po ai shtet, i ka me bollëk rregullat më të hollësishme për mënyrën se si të veprojë me njerëzit që i vret nëpër vendet jashtë territorit të Sëbisë. Ka edhe rrgulla se si t'u vihet flaka shtëpivet, bashkë me banorët dhe si të shndërrohen në karbon banorët brenda atyre shtëpive. Ka rregullore, në formën e urdhëravet ushtarakë, si të zihen rob banorët e fshataravet e të qytetevet, si të lidhen grupe-grupe nga 50 së bashku, dhe ashtu të lidhur të pushkatohen ose të theren me thika, me bajoneta apo të copëtohen me sëpata. Shteti sërb, përkatësisht ushtria e saj, i ka rregullat se si të hapen gropat dhe hendeqet, si të hidhen në ato gropa e në ata hendeqe të pushkatuarit e të therurit, dhe si të mbulohen kufomat e atyre qenieve njerëzore me grumbuj dheu, me baltë e me gurë. Bota, pikërisht këto ditë, e pa me sy, madje edhe i incizoi dhe i dokumentoi të atillë varrime anembanë Bosnjës. Ndërkaq, zonja Vidosava Kërstiq-Jovanoviq, tash më shumë se 1 javë, po vjen vërdallë nëpër zyrat e Beogradit, duke kërkuar një leje për të varrosur: kunatën e vet, nipin e vet dhe mbesën e vet." Këtë pjesë të komentit, me një përmbysje të çuditshme të gjëravet, nuk e kishin bërë as mysalimanët, drejtpërsëdrejti të rrëzikuar, as edhe për shembull kroatët, por, përkundrazi, një klub liberalësh në Hollandë.

Organet e milicisë, drejtoria e spitalit, që të gjithë i përgjigjeshin***: „Nuk guxojmë. Ju jeni të afërmit e tyre, por nuk jeni anëtar i pandërmjetëm i asaj familjeje. Ne jemi të detyruar të Ju konsiderojmë si fqinjin e tyre. Një fqinj i çfarëdoshëm. A guxojmë ne që t'ia dorëzojmë cilitdo fqinj 3 trupa të vdekurish?!"*** Zonja Vidosavë i kërcënonte me gjyq, por, as spitali, as milicia, nuk guxonin ta lejonin varrimin kokë më vete, pa marrë shkresë prej ndonjë eprori. Ka shkuar edhe te kryetari i bashkisë. Penguan në ndërkohë, edhe festat e Krishtlindjevet, sepse shumica e nëpunësvet përkatës nuk gjendeshin në vendet e tyre të punës. Kaloi ashtu një javë e tërë. Erdhën nga Zrenjanini 2 vëllezërit e të ndjerës Jasminë. As atyre nuk iu dha leja e varrimit. Qenë detyruar të kthehen përsëri në Zrenjanin, për të kërkuar atje dokumentet që ata mendonin se mund t'u hynin në punë. Atje kishin mundur të merrnin çertifikatën e lindjes vetëm për motrën. Për Predragun e për Svetllanën, kuptohet që jo. Gjithsesi, edhe sikur ata ta kishin nxjerrë lejen, Vidosava nuk do të pranonte, sepse mendonte që askujt tjetër më shumë se asaj nuk i takonte të kujdesj për trupat e fatzinjvet.

Më në fund i telefonoi Ristos. Ai e ftoi në zyrën e vet. Në ndërkohë foli me më shumë se 10 nga shokët e të njohurit e vet, gjersa ia doli të marrë premtimin që zonjës në fjalë do t'i jepej leja për ta kryer varrimin e të afëmvet të saj.

Në të kundërt të asaj që priste, të paktën formalisht një falenderim prej saj, Vidosava iu drejtua Ristos me një ton shumë të ashpër: ***„Paske mundur të m'i nxjerrësh të vdekurit prej morgut, por të gjallin ma ke rrasur në birucë. Ma jep tani lejen që edhe Stevani i mjerë të marrë pjesë në ceremoninë e varrimit!"*** Ristoja u shtang. ***„Zonjë! A e di ti që Stevani është vrasësi i tyre?! Si mund ta përfytyrosh një skenë të tillë?!" "Por ai është edhe bashkëshort e prind i tyre! Ju nuk keni të drejtë t'ia privoni atij aktin e lamtumirës!"*** Ristoja, thjeshtë nuk po mund ta kuptonte dyzimin enigmatik të asaj gruaje: njëkohësisht të ashpër edhe të bukur, jashtë çdo përfytyrimi.

PËRGATITJET

Komandiri i milicisë dhe një tjetër nëpunës i veshur civil, e udhëzuan zonjën Vidosavë që ai varrim të mos shpallej, siç bëhet zakonisht në raste të tillë. Nuk ish e këshillueshme që aty të mblidheshin, farefisi, të njohurit e sidomos qytetarë të tjerë, të njohur e të panjohur. Bile as shpalljet tradicionale, me fotografi e me të dhëna të tjera, në këtë rast, iu tha se nuk duheshin praktikuar. Kur i veshuri civil e shqiptoi fjalën ***varr*** në numrin njëjës, zonjaVidosava e pyeti: ***"A varri, apo varret!?" "Si ta përcaktoni Ju vetë."*** I thanë ata. Vidosava murmuriti sikur po fliste me vete: ***"Mbase nuk keni menduar që t'i rrasni të 3 në një gropë të përbashkët!"***

Shkoi te varrezat, e përcaktoi vendin, porositi 3 varre njërin pranë tjetrit, në fqinjësi me varrin e burrit të saj të ndjerë. Ishte vendosmerisht kundër të quajturvet varre masivë apo të përbashkët. Paratë u detyrua t'ua kërkojë ***"vajzavet"*** të veta. Ato e sajuan shumën e nevojshme dhe ia dhanë padrones me një përkushim të posaçëm. Kish mbetur vetëm prifti, i cili duhej thirrur dhe njoftuar për kohën kur do të bëhej varrimi. Shkoi me makinë deri te kisha. Por atje u përball me një rezistencë të papritur. Viktimat në opinionin publik tashmë njiheshin si shqiptarë, kurse shqiptarët dihet që nuk varrosen me ritin e pravosllavëvet. Ajo u përpoq t'i sqarojë, që këto 3 viktima ishin të besimit pravosllav, por priftërinjtë nuk deshën as t'i dëgjojnë arsyetimet e saj. Është detyruar t'i drejtohet igumenit, pastaj, edhe vetë mitropolitit. Mitropoliti e ka këshilluar që, lidhur me këtë çështje, ajo do të mund t'i adresohej Kryepeshkopit të Kishës Ortodokse Autoqefale në Tiranë. Vidosava është zemëruar dhe e ka quajtur qëndrimin e atyre, gjoja ***"mbrojtësvet"*** të drejtësisë hyjnore, një tallje brutale me drejtësinë hyjnore.

VARRIMI

Me makinën e spitalit, shoqëruar nga milicia, u sollën 3 arkivolë dhe u vendosën, jo në oborrin e shtëpisë së Stevanit, po në pjesën e të ndjerit Lubishë. Aty i priste një grup i vogël vajtuesish: 2 vëllezërit e së ndjerës Jasmina Golamadiq-Jovanoviq, zonja Vidosava Krstiq-Jovanoviq dhe nja 8 vajza, midis të cilavet edhe boshnjakja Sanije, e cila dridhej e strukur pranë njërës prej shoqevet. Para se të fillone ceremonia, zonja Vidosavë i ishte lutur Sanijes: ***"Sanije, të lutem, mos më kendo Vallen e Brankos në kohën e ceremonisë!"*** Sanija i kish premtuar.

Kortezhi i vogël u nis. Së pari tatëpjetë rugës së ngushtë të pjesës private të Beogradit, pastaj pak e nga pak nëpër rrugët gjithnjë e më të gjëra. Pikërisht në ata minuta të rrëshqitjes së ngadaltë të makinës së funeralit drejt varrezavet të qytetit, ndodhi një e papritur. Qetësisht dhe pa u vënë re, iu bashkuan përcjelljes grupe të vegjël burrash dhe grashë, veshur në të zeza. Kur kortezhi arriti te varrezat, ai tashmë përbëhej prej qindra pjesëmarrësish. Vidosava u prek thellë në shpirt. Nuk qante, por shihej se ish tepër e mallëngjyer.

Varrmihësit e kryen punën e vet. Ajo hipi mbi një vend pak më të lartë. ***„Të nderuar pjesëmarrës! I falenderoj inxhinierët dhe punëtorë tekstilist, shokët dhe shoqet e së dashurës dhe të paharrueshmes kunatës sime Jasminë! Falenderoj studentët dhe studentet, shokët dhe shoqet e më se të bukurës mbesës sime Svetllanë! Falenderoj shoqet dhe shokët e më se të mençurit nipit tim Predragut!"***

Vejushës Vidosavë për një çast iu zu fryma. U zhvendos pranë varrit të të shoqit dhe vazhdoi: ***„Është vrarë burri im larg në Jug. Në mes të një nate të zezë. Nuk e***

kam njoftuar askënd. Nuk i jam ankuar askujt. E kam mbledhur trupin e tij të bërë copa, dhe e kam ngarë makinën gjithë natën. Të nesërmen ia kemi bërë nderimet mortorë, unë, kunati im Stevani dhe kunata ime Jasmina.“

U zhvendos prapë, shumë ngadalë, pranë varrevet të rinj. Dukej madhështore, me fustanin e gjatë e të zi, e mbështjellur krejt me një shall të madh, thurur me grep. ***„Ja pra, tash, pranë tij, edhe e kunata, edhe i nipi, edhe e mbesa! Të 3 përnjëheres! Trupash të copëtuar, si dhe ai, para 20 vitesh!”***... Krejt funerali u mbyt në vaj.

“Ju jam mirënjohëse të gjithëvet dhe ju lutem të më kuptoni mire për këtë që do të ju them tash: I pafati Stevan Jovanoviqi, kunati im, vëllai i burrit tim të pafat, në thelbin e vet nuk është kriminel! Ai është prodhim i një fabrike kriminale, të cilën ne sërbët duhet ta rrënojmë gjer në themele!” Midis masës së njerëzve të veshur në të zeza, u perhaps njëfarë murmurime e paartikulueshme, ngjashëm me një bubullimë të nëndheshme: ***“Ta rrënojmë gjer në themele!” “Dhe të ndërtojmë një të re! Një, që nuk do të prodhojë vrasje!”*** E përfundoi fjalën e Vidosavës vëllai më i madh i Jasminës, duke fshirë lotët me një shimi të lagur.

SHEMBULL I NJË HUMANIZMI TË PËRKORË

Doktor Velko Velimiroviqi nuk gjendej në Beograd, por ia kish lënë recetat ndihmësit të vet. Pas njoftimevet që i dispononte Momo Gërnçareviqi, ai kish udhëtuar për në Bileqe. Flitej që punonte atje tash disa vjet, por me zë të ulët: ***“Ai atje merr trefishin e rrogës,”*** tha Momoja,.” ***“sepse punon në një uzinë kimike sekrete, për nevojat e ushtrisë.”*** Edhe Ristoja kish dëgjuar diçka për këtë lloj veprimtarie të Velimiroviqit, por nuk ishte interesuar shumë. Ristos nuk i pëlqenin punët e fshehta. Por kolegu i tij Momoja, me sa dukej, i njihte punët e Velkos deri në hollësi. ***“Prof.Dr.Velko Velimiroviqi është një njeri jashzakonisht i talentuar.”*** Tha ai. ***“Kimist i klasit të parë dhe njohës i shkëlqyer i sëmundjevet psikike. Ka shërbyer gjatë nëpër burgjet tanë të famshëm dhe jo të famshëm. Në Nish, në Mitrovicë të Sremit. Thonë se atje ka eksperimentuar, me rezultate shumë të suksesshëm, duke përdorur, për atë qëllim, të burgosurit shqiptarë. Një varg torturash të reja, moderne, veprimet e helmevet të rinj luftarakë dhe kushedi çfarë tjetër. Me qindra mijë shqiptarë janë burgosur rregullisht, dënuar dhe vuajtur dënimet anembanë Jugosllavisë Socialiste, prandaj dhe ka pasur aty terren të mjaftueshëm për t’i kryer pa shqetësime eksperimentet. Ka qenë vërtet një terren ideal për t’i përparuar shkencat tona. Uzina e Bileqes tani prodhon helme lufte, që, në industrinë botërore të luftës, ende nuk njihen. Do të jepnin miliona për të, për Velkon tonë, amerikanët, rusët, anglezët. Prandaj dhe nuk publikohen punimet e tij dhe prandaj shteti ynë e ruan atë me kujdesin më të***

madh. A e keni vënë re,“ i pyeti Momoja Riston dhe Borkën, ***„që doktor Velimiroviqin e shoqërojnë së largu 2 milicë të veshur civilë? E ruajnë prej ndonjë rrëmbyesi eventual.“***

Edhe Ristoja, edhe Momoja, kishin shumë punë, por, ashtu siç ndodh shumë shpesh, pikërisht kur zyrtarët kanë punë, gjejnë më shumë kohë për të biseduar. Kurse bisedat e Momos ishin veçanërisht tërheqëse. ***“Njëra ndër provat më të suksesshme të Velkos ka qenë prova me nxënësit shqiptarë. Vendoseshin doza të atij pluhuri të Bileqes në ambientet e shkollavet, nëpër klasa, në korridoret, në vende të ndryshëm, brenda bankës në ndonjë kënd, midis fletëvet të libravet dhe fletorevet. Në vende të ndryshëm, por edhe në sasi të ndryshme. Diku vetëm 3 gramë, diku 12 gramë, diku gjysmë grami. Nxënësit, duke hyrë nëpër klasa, fillonin të qeshnin jo natyrshëm, të kërcenin si të marrë, të rënkonin. Shtriheshin në dysheme, villnin. Pjesa e nxënësvet te të cilët nuk vepronin dozat e helmit, si edhe personeli shkollor, të alarmuar dhe tepër të pazotë për të bërë diçka, i bartnin të intoksikuarit në krahë, deri te qendrat më të afërta shëndetësore. Atje u jepej ndihma e shpejtë, por, në të shumtën e rastevet pa sukses. Është shkruar atëherë që janë përfshirë në ata eksperimente më shumë se 7000 nxënës të shqiptarëvet të Kosovës. Një numër i madh prej tyre, as sot e kësaj dite nuk janë normalizuar. Krejt ajo punë është kryer e përcjellë me procedurë të fshehtë. Nxirreshin rezultatet, arrihej në përfundime, dhe thonë se me atë eksperiment, doktor Velko Velimiroviqi ka marrë shumë lavdërime, shpërblime dhe dekorime. Vetëkuptohet, jo publikisht.”***

NJË E VËRTETË E TRISHTUESHME

Shoqata apo shoqëria ***“Djelmoshat e Stevanit”*** e ka shpallur, në ndërkohë, qëndrimin e vet në lidhje me viktimat e Stevanit. ***“Djelmoshat e Stevanit”*** ishin qind për qind të bindur se Jasmina Golamadiq-Jovanoviq, djali i saj Predragu dhe vajza e saj Svetllana, kishin marrë dënimin e merituar. Ata i mbështesnin pohimet e vet, midis tjerash, edhe në faktin se në bllokun e shënimevet të Predragut qenë gjetur të quajturit ***“vargje kundër Sërbisë”*** tepër provokues dhe ofendues. Citoheshin ata vargje ***“Sërbi, o nëna ime, edhe e verbët, edhe e shurdhët! O atdheu im, jonjerëzor dhe i mashtruar!”*** dhe quheshin të mjaftueshëm, që dikush, vetëm për ata vargje, të dënohej me vdekje.

Në vazhdim, ***“Djelmoshat e Stevanit”*** kanë proklamuar edhe programin e angazhimit dhe veprimtarisë së vet. Thelbi i organizimit dhe i ekzistencës së tyre ishte krijimi i ***“kombit të pastër sërb”***.

“Kanë kaluar plot 1350 vjet që kur jemi vendosur në këto hapësira dhe megjithatë nuk ndjehemi të sigurtë. Ngjajmë me një fuçi plastike të zbrazët, e cila

rrokulliset tutje-tëhu nën shtytjen e një ere fare të dobët. Shkaqet që ne jemi në këtë gjendjeje, mund të jenë të shumtë. Por njëri prej më rrënuesish, është, që kombi sërb, në pjesën më të madhe të tijën, nuk është i pastër."

"Le të marrim vetëm një shembull. Ideja e vëllazërimit dhe e bashkimit socialist ka krijuar, midis tjerash, kushtet që të vijnë në Beograd qinra dhe mijëra shqiptarë. Ata këtu janë ndjerë tepër të lire. Kanë flirtuar fare lirshëm me gra e me vajza sërbe. Më aktivë në ato punë kanë qenë studentët, kamerierët dhe politikanët shqiptarë. Studentët shqiptarë në masë kanë bërë dashuri me studentet tona, me një shtresë liberale të grave, me të zonjat e bujtinavet, dhe ia kanë dalë të bëjnë për vete deri edhe profesoreshat. Si rezultat i një të këtillë pakujdesie të pafalshme nga ana jonë, kanë lindur në masë anembanë Beogradit fëmijë me gjak të papastër."

("A ju kujtohet romani 'Gjaku i papastër" i Bora Stamkoviqit?" Vërejti kalimthi Momoja.***)***

"Numri i të atillë fëmijëvet është vërtet alarmant. Pikërisht ata fëmijë të papastër, sot punojnë si nëpunës nëpër zyrat tona. Ka të atillë gjysmëshqiptarë në të gjithë sektorët e jetës sonë publike dhe është pikërisht ky shkaku që punët tona nuk ecin ashtu si duhet. Një pjesë e atyre fëmijëve me gjak të papastër sot frekuentojnë universitetet tanë në një numër më të madh se ç'mund t'i marrim me mend. Ky është me të vërtetë një realitet i trishtueshëm, por ne jemi të detyruar ta shikojmë këtë realitet ashtu siç është: Kombi sërb, i përzier dhe i nakatosur kaq dëshpërueshëm, as mund të përparojë, as mund të renditet ndonjëherë midis të përparuarvet."

"Nisur nga ky konstatim, shoqëria jonë 'Djelmoshat e Stevanit' ka vendosur që, para së gjithash, të hulumtojë, të regjistrojë dhe të hartojë një listë të të gjithë të atillë gjysmëshqiptarëve që janë infiltruar në kombin tonë. Në të gjithë spitalet tanë, në të gjitha shkollat dhe në të gjithë universitetet, në të gjithë burgjet, në të gjitha njësitë ushtarake, në të gjithë entet tanë shtetërorë, do të realizojmë analizën speciale të AND-së (të Deoxyribonucleic acidit), me qëllim që të mund të përcaktojmë me saktësi prejardhjen e të gjithë banorëvet, së pari këtu në Beograd e më vonë në krejt Sërbinë. Kushdo që nuk do të na rezultojë një sërb i pastër, vetëkuptohet që do të ketë më levërdi të largohet prej kësaj toke."

PROFESIONI YNË: TË BËHEMI TË BEZDISSHËM

Ristoja e kish shumë bezdi përballjen me gazetarët. Beogradi ishte i mbuluar me borë, Ristoja ish i mbuluar, me një qyrk akulli kur kujtonte që, në çdo hyrje e dalje ish i detyruar të ndeshej me grumbuj dërdëllitësish të pafrenueshëm. Të priturit në

ambientet e ***"trarëvet"***, dmth. në ambientet e burgut të qarkut, gazetarët e kishin të ndaluar. Në institucionin e gjykatës së krimevet, përkatësisht në prokurori, nuk ishte krijuar ende tradita e konferencavet të shtypit dhe nuk dihej madje, do të vihej apo jo ky rregull. Ristoja megjithate ishte i detyruar të ballafaqohej me gazetarët, me atë racë njerëzore me të vërtetë të çuditshme e mbase edhe çudibërëse. Në bore ata mund të qëndronin 5 minuta. Por jo 5 orë, prandaj, vendi më i përshtatshëm për ta ishte pijetorja më e afërt, në të cilën grumbulloheshin edhe vizituesit e burgaxhinjvet. Për fat, fasada e xhamtë e asaj pijetoreje, përndyshe kurrsesi moderne, lejonte që të shikohej drejt e te shkallët e ambientevet të prokurorëvet. Sapo të hapej dera e asaj ndërtese, gazetarët dhe kameramanët do ta kapërcenin me vrap rrugën dhe do të grumbulloheshin në sheshin para shkallëvet. Nëse nuk ishte Ristoja ai që po dilte, gazetarët ulnin kokat zhgënjyeshëm, mblidhnin supet dhe ktheheshin te tavolinat e veta, pranë çajevet dhe kafevet prej kohësh të ftohura.

Ristos nuk i kish ndodhur kurrë më parë që ta sulmonin gazetarët aq padurueshëm. Kish përpunuar, kish kaluar nëpër duar, me dhjetëra raste krimesh. Kish pasur edhe më të rëndë, vrasje fëmijësh, atëvrasës apo nënëvrasës, masakrim dashnoresh. Por gazetarët nuk qenë grumbulluar në këto përmasa dhe me kaq shumë kërkesa këmbëngulëse. Edhe vetë pyetjet, ngjanjëherë, i dukeshin krejt pa mend, thjeshtë budallallëqe: ***"A ka dyshime që ta ketë paguar dikush fajtorin?" "Ju lutem, kini kujdes: Mos rrëshqisni në gropën e së palogjikshmes! A ka farë kuptimi që një prind të vrasë birin e vet dhe bijën e vet për para?" "A ia keni mbushur mendjen Ju zonjës Kërstiq-Jovanoviq për të organizuar funeralin e shqiptarëvet të vrarë?""Nga e dini ju që ata ishin shqiptarë?!" "Nuk ka sërb të çmendur që të vrasë një sërb." "Zoti Kilibarda, a ndjeheni malazi apo sërb?" "Ç'ka këtu që njeriu të ndjehet ose të mos ndjehet? Dua apo s'dua, unë jam një malazi i lindur. Mirë apo keq, unë nuk mund ta ndryshoj qenien time. "Por po flitet që djali Juaj, Cvetko Kilibarda, nuk e ndien veten malazi." „Epo, ndoshta e ka tërhequr nëna e tij.""I padituri ka deklaruar se edhe ju jeni një shqiptar. Por edhe shkencërisht tashmë është vërtetuar saktësia e asaj që ka thënë i pandehuri. A mos do të duhej të jepni dorëheqjen?" „Nuk do të kisha arsye t'u nënshtrohem të atilla thashethemeve."***

Në shtypin ditor jashtëbeogradas dhe jashtësërb, sado edhe atje në mënyrë mjaft të përmbajtur, mund të dalloheshin kryesisht 3 qëndrime. Qëndrimi i parë: ***„Kanë marrë ç'u ka takuar. Çdo tradhti dënohet me vdekje."*** Qëndrimi i dytë: ***„U lumtë inxhiniere Jovanoviqit, djalit të saj të ri dhe vajzës së saj të re! Kanë pasur guximin ta shohin të vërtetën në sy! U kanë dalë zot parimevet gjithnjerëzorë e vetëvetiu edhe parimevet të atdhedashirisë."*** Qëndrimi i tretë i deheroizonte deri diku të ndjerët, duke e arsyetuar krjet ngjarjen në një mënyrë më të thjeshtë: ***„Zonja Golamadiq-Jovanoviq dhe fëmijët e saj fatkeqë, as që e kanë marrë me***

mend që, njeriu i tyre më i afërm e më i dashur do të sillej në mënyrë aq çnjerëzore. Një të tillë veprim askush nuk do të mund ta parashikonte. Prandaj, nuk ka aty kurrfarë vepre heroike. Nuk ka aty kurrfarë trimërie. Më një krah kemi një sjellje krejt normale njerëzish të kthjellët dhe të arsimuar, në krah tjetër, një filozofi vandalizmi, e cila nuk ka kufinj.“

Ristoja rrinte trupdrejtë dhe pak i fryrë përpara gazetarëvet. Por ndodhte edhe që, në sprova të tilla, ta lëshonin nervat për një cast dhe të shprehej me arrogancë: ***“Ju lutem, a nuk keni pyetje më serioze?”*** Në vend që të tërhiqeshin, ata do t'i drejtonin atëherë me dhjetëra pyetje, duke çuar duart e gishtat përpjetë, duke u shtyrë me bërryla, dhe duke mos harruar t'i mbajnë fort mikrofonët: ***“Deri në ç'masë është përzier Akademia Sërbe e Shkencavet dhe e Artevet në këtë ngjarje?” “A ka pjesë këtu edhe Kisha Pravosllave Sërbe?” “Pse ka thënë zonja Kërstiq-Jovanoviq që vrasësi nuk është autori i mirëfilltë i veprës kriminale? Ajo aty ka përmendur njëfarë fabrike të krimevet. Ç'mendoni Ju për këtë thënie të sajën?”***

Mbasi përfundonte krejt kjo punë, në brendësinë e Risto Kilibardës do të zhvillohej një luftë e vërtetë shpirtërore e mendore. Lodhja i shoqërohej me një shurdhim total të veshvet. Të rikujtuarit e disa pyetjeve dhe përgjigjeve, nganjëherë mjaft të pavend. ***“Pse thashë kështu e jo ashtu?” ”Kush po i nënshtrohet realisht përndjekjes, unë, apo një vrasës me emrin Stevan Jovanoviq?!”*** Më në find, ngadalë dhe pakuptueshëm, u qetësua, rënë mendime gjysmë i përgjumur: ***“Çdo gjë varet sa e njeh gazetari të vërtetën, përfshirë aty edhe të vërtetën historike. Varet edhe prej orientimit politik. Prej të frymëzuarit patriotik. Edhe gazetarët janë njerëz, kjo duhet pasur parasysh.”*** Por njëherë pat reaguar, të thuash, në mënyrë demonstrative: ***“Pash Zotin! Si mund të jeni aq të bezdisshëm?!”*** Dikush prej tyre i qe përgjigjur: ***“Ky është profesioni ynë: të bëhemi të bezdisshëm.”***

THIRRJA E SHTATËMILIONTË

Mbrëmjen e kaluar, si çdo mbrëje në vitet e fundit, në të gjithë lajmet radiotelevizivë, u fol **rreth kthimit të sërbëvet dhe malazezëvet në Kosovë e Metohi.** Një gazetar, nisur ndoshta nga një parim i përjetshëm që një lajm të thatë ta përforcojë me ndonjë element të freskët, kish konstatuar që kjo thirrje **rreth kthimit të sërbëvet e malazezëvet në Kosovë e Metohi,** ish përsëritur tashmë 7 milionë herë. E ka titulluar shkrimin e vet ***“Thirrja e shtatëmiliontë”*** dhe nuk e ka ditur, mbase edhe s'i është bërë vonë, ç'pasoja do t'i sillte një titull i tillë.

Në zyrën e Risto Kilibardës, në mënyrë krejt të natyrshme, u bë pyetja: A ishte qëllimi i atij gazetari të tregojë vëllimin, madhësinë e preokupimit të qeverisë jugosllave, përkatësisht sërbo-malaziase, rreth atij problemi ***“epokal”*** të kombit

sërb, apo ish qëllimi i tij të tërheqë vëmendjen mbi kotësinë, thënë troç, mbi absurditetin e një të tillë përpjekjeje?! Të pësëritësh 7 milionë herë të njëjtën përmbajtje e në fund e gjithë ajo të të rezultojë një zero me xhufkë, gjithkush do ta kish kuptuar që ajo punë s'mund të emërtohet ndryshe, përveçse dështim. Dështim i pastër, dështim i kulluar, edhe i aparatit shtetëror, edhe i politikës kombëtare, dhe i çdo gjëje që do të mund të lidhej me një të atillë zhvendosje të popullsisë. Sepse popullimi i një territori me një tjetër popullsi s'është, veçse zhvendosje popullsie. Në anë tjetër, a mund të hidhej poshtë mundësia që një ditë krejt ai shpenzim energjie të mos kurorëzohej me sukses? Vetë titujt që rregullisht fillonin me fjalët ***"masa të reja"*** paralajmëronin jo vetëm diçka të re, por ndoshta edhe diçka vendimtare. ***"E kemi përsëritur këtë thirrje patriotike 7 milionë herë. Tani mjaft! Jemi të detyruar të ndëmarrim diçka të re dhe gjithsesi vendimtare."*** Ky ishte paralajmërimi, por edhe thirrja e atij gazetari.

"Më duket që edhe ti i ke disa lidhje me Kosmetin." I tha Momoja sekretare Borkës. Ajo u skuq pakëz, duke qeshur me mjaft simpati. Nuk kish vend për kurrfarë senzacioni, por as arsye për ta kaluar në heshtje, nuk kishte. ***"Po."*** Tha Borka. ***"Nëna ime ka mbaruar shkollën në Gjakovë dhe ka një novelë goxha interesante në lidhje me atë aventurë kosmetase."***

ËSHTË DASHUR TË MARTOHESHE ATJE

"Nëna ime e pat mbaruar shkollën 8-vjeçare në vitin 1956. Nuk ka qenë nxënëse e shkëlqyer, por edhe nxënë e dobët nuk ishte. Qysh para se ta përfundonte klasën e tetë, siç ishin atëherë rregullat, ka kërkuar bursë për shkollë të mesme. Në gusht e kanë lajmëruar që nuk e ka fituar bursën. Gjyshi im, i jati i nënës time, nuk ka qenë mirë ekonomikisht, prandaj nëna ime e ardhshme ka mbetur pa e vazhduar shkollën. Gjithë dimrin, gjyshi dhe ajo e kanë kaluar në qytet nëpër zyrat e komunës, që të siguronin për vitin tjetër një çfarëdo burse. E kanë shkruar lutjen që duhej, ia kanë bashkëngjitur dokumentet e tjerë. Zyrtarët kanë premtuar, por në fund s'ka dalë asgjë. Duke parë që im gjysh ishte tepër i shqetësuar, ose ndoshta duke ndjekur brengën dhe përpjekjet e tija që t'i sigurojë bijës një të ardhshme më të mirë, njëri prej atyre zyrtarëve i është afruar dhe ia ka premtuar një bursë, jo në qytetin e Çaçkut, por në Kosmet. 'Është atje një shkollë për mësuese amvisnie. Unë mund të ta rregulloj një bursë, nëse ju pëlqen, ty edhe vajzës tënde.' Kujt nuk do t'i pëlqente një bursë shkollimi, e humbur për të dytën herë?! Në atë mënyrë ka shkuar nëna ime në Gjakovë. Atje ka pasur shumë vajza nga Sërbia dhe nga Mali i Zi. Ajo shkollë ishte vetëm për vajza. Kanë pasur një konvikt. Kushtet i kishin të shkëlqyeshëm. Në të njëjtën godinë me atë shkollë për mësuese amvisnie, ka qenë edhe gjimnazi, plot me çuna shqiptarë. Nëna ime vintenë Çaçak në pushimet e dimrit dhe në verë.

Shkonte në komunë për të rregulluar letrat që i duheshin dhe, për çudi, çdo herë i dilte përpara ai mirëbërësi. 'Si po të shkon shkollimi? A ke njohur ndonjë çun atje në Kosmet?' ,'Jo, ende jo.' I përgjigjej nëna ime e ardhshme. 'Si jo?! Nuk duhet të presësh më! Atje ka plot djelmosha shqiptarë.' Mirëpo nëna ime e ardhshme nuk është dashuruar me asnjërin prej atyre shqiptarëve. Ka simpatizuar herë njërin, herë tjetrin, por në dashuri nuk ka mbërritur. Ç'është e vërteta, thotë nëna ime, as shqiptarët, ata më të mirët, nuk lakmonin për t'u martuar me sërbe. Ata që kërkonin vetëm flirte, nënës nuk i pëlqenin."

„Më 1961-shin, nëna ime ka dhënë provimet e fundit, ka marrë diplomën dhe ka ardhur përfundimisht në Çaçak. Ka kërkuar punë, por punë nuk i kanë dhënë. Një ditë i është afruar ish-bamirësi. Nuk ishte i përzemërt si herët e tjera. 'Ç'po kërkon?!' I është drejtuar me të ashpër. 'Kërkoj punë. E kam mbaruar shkollën.' 'Këtu nuk ka punë për ty'. I është përgjigjur zyrtari. 'Duhej të kishe gjetur punë ATJE. Duhej të ishe MARTUAR ATJE dhe atëherë do të kishe gjetur edhe punë, edhe privilegje të tjerë'."

„Me Kosmetin," tha Ristoja***, „ka vetëm 2 rrugë: O të dëbohen shqiptarët prej andej, ose t'u njihet pavarësia."*** Momoja nuk tha asgjë. Borka iu përvesh punëvet, ndonëse u ndie e lodhur nga të rrëfyerit e asaj historie.

NJË AVOKAT INEKZISTENT

Avokati i Stevan Ivanoviqit, Mirko Zvonar, në seancën e parë të dëgjimit, ishte mirëfilli i padukshëm. Gjykatësit hetues, Risto Kilibardës, kjo nuk i interesonte shumë. Le të vinte kur të donte, le ta bënte mbrojtjen siç i dukej atij më mirë. Në fund të fundit, ka avokat-mbrojtës të atillë, të cilët, në pjesën më të madhe të procesit të hetimevet heshtin dhe mbledhin të dhënat që u duhen kundër akuzës. Të atillët mbrojtës, në çastin vendimtar të gjykimit, bëhen të gjallë papritur, shfaqen të papërmbajtshëm, me një ndërhyrje vendimtare dhe arrijnë rezultatin më të lartë të mundshëm në të mirë të të akuzuarit. Ristoja nuk e dinte nëse avokati Mirko Zvonar do të ndiqte një të atillë taktikë. Atij ia tërhoqi vëmendjen vetëm mungesa e tij gjatë gjithë procesit të hetimevet. Nuk e kishin njoftuar që avokati, në ndërkohë, ia kish bërë ndonjë vizitë të pandehurit. Kjo, në një farë mënyre, paralajmëronte një lloj mbrojtjeje të pa nerv, gjë që do të thoshte se fajtorin do të detyroheshin ta mbronin më shumë prokurori dhe gjykatësi, se sa avokati i tij, i cili paguhej për atë punë. Ka edhe të atillë raste në historinë e drejtësisë.

Duke përmbledhur krejt këto, Ristoja tentoi t'i telefononte avokatit Mirko Zvonar dhe ta njoftonte që në ditët e ardhshme do të kishte seanca të vazhdueshme me të pandehurin dhe se gjithashtu do të thërriste një numër dëshmitarësh. Ka telefonuar, por numri nuk i hapej. Në vend të zotit avokat Mirko Zvonar, jepte përgjigje

sekretaria automatike e telekompanisë: ***„Numri që kërkuat nuk përgjigjet momentalisht. Ju lutemi, merrni më vonë!“*** Ristoja priti deri në mbrëmje dhe e përsëriti thirrjen, por avokati Mirko Zvonar prapë nuk iu përgjigj. Atëherë s'i mbetej tjetër, veçse ta njoftonte zonjën Vidosava Kërstiq-Jovanoviq. Doli që as ajo nuk po mund ta gjente. Ish interesuar, tha, disa herë. Tani do t'i duhej të shkonte te zyra e tij.

Ka shkuar të nesërmen. Nuk e ka gjetur as atje. Fqinji i tij më i afërt, avokat edhe ai, i ka thënë që zoti avokat Mirko Zvonar ka disa ditë që s'është dukur aty. Aq më tepër, në kundërshtim me sjelljen e tij zakonisht të qetë, ditësh të fundit ka qenë shumë i shqetësuar. Herën e fundit madje ka ardhur i dehur në punë, gjë që kurrë më parë nuk i kishte ndodhur. Në v end që të punonte, ai gjithë kohën proklamonte diçka me zë të lartë, gjë që i detyronte kalimtarët të kthenin kokat.

NËPËR FONDET E NJË ARKIVI

Ekzakt në 4 pa 10 të mëngjesit, Cvetko Kilibarda kapi në internet shkrimin me titull: ***„Fondet e Arkivit të Stevanit“***. Megjithse pikërisht atëherë po bëhej gati të flinte, ai, si pa dashje, filloi të lexonte dhe nuk u ndal dot deri në fund. Në atë shkrim thuhej kështu: ***„Po sjellim këtu regjistrin e përmbajtjes së vetëm një pjese të Arkivit të Stevan Jovanoviqit. Ky është, në të vërtetë, regjistri i raportevet që ushtarakët u kanë dërguar nga terreni komandavet të veta siprore ose shërbimevet sekretë, mbi sukseset e ndërhyrjevet tona në tokat e banuara me shqiptarë. Metodat që janë përdorur në procesin e spastrimit të atyre vendbanimeve prej popullatavet josërbe, numri i të vrarëvet dhe të asgjësuarvet me çfarëdo mënyre tjetër. Të gjitha këto, zoti Stevan Jovanoviq i ka sistemuar dhe rregulluar me kujdesin më të madh. Brezat e ardhshëm, në bazë kësaj lënde do të mund të studiojnë të kaluarën tonë dhe të ndërtojnë strategjitë më të përshtatshme për të ardhshmen e tyre.“***

„Viti 1912.

Kosovë. 'Lojërat' me të posalindurit. Të posalindurit hidhen përpjetë, thjeshtë vërviten në ajër, dhe priten prej një grupi ushtarësh me bajoneta zbërthyer. Përpëlitjet e të posalindurvet shqiptarë në majat e bajonetavet quhen ndyshe 'buzëqeshe shqiptarësh'. Buzëqeshje të atilla të shqiptarëvet të posalindur përjetohen si argëtimet më të këndshëm të ushtarëvet tanë.

Në krahinën e Shkupit, pas një aksioni që kemi kryer, kemi numëruar 38 cisterna apo saranxha të mbushura plot me kufoma shqiptarësh.

Gjeneral Zhivkoviqi ka urdhëruar në Senicë një varg pushkatimesh, janë pushkatuar 950, shqiptarë edhe turq, dua të them, të turqizuar.

Pasi ushtria sërbe e ka pushtuar Manastirin, ushtarët tanë kanë bërë gara për të hedhur në zjarr secili nga 10 shqiptarë të gjallë, pa bërë dallime, meshkuj të rritur, gra apo fëmijë.

Në Shkup u dënuan me vdekje 36 shqiptarë dhe u vranë menjëherë.

Karadaku i Shkupit. U dogjën 280 shtëpi. (Në Tërstenik u vranë 60 shqiptarë, në Smirë u vranë 32 shqiptarë, në Vërban u vranë 20 shqiptarë, në Lubishtë u vranë 19 shqiptarë).

Në Komogllavë (fshat me 50 shtëpi), vrarë radhazi thuajse të gjithë meshkujt.

Në Sefer e kanë hedhur të gjallë në zjarr një grua, e cila u dogj bashkë me një ndihmësin e vet, që ishte katolik.

Në Gjilekatë, një gruaje me barrë ia kanë care barkun me bajonetë, ia kanë nxjerrë foshnjën dhe hedhur në shkurre.

Preshevë. Atje pakkush ka mbetur gjallë.

Në Ferizaj u vranë 1200 shqiptarë.

Krahina e Lumës. 400 meshkuj u dorëzuan vetë. I çuam në Prizren dhe i vramë me grupe, nga 40 deri 60 në ditë.

Afër stacionit në Kumanovë, i kapëm nja 700 a 800 të ikur, lidhëm dhe bëmë copa-copa me thika e me bajoneta.

Në afërsi të Shkupit, prapë vrarë edhe copëtuar, me thika e me bajoneta, 2000 shqiptarë.

Midis Kumanovës dhe Shkupit vrarë 3000 shqiptarë. I kemi nxjerrë jashtë shtëpivet dhe i kemi vrarë si minjtë. Asnjë ditë nuk e kemi mbyllur pa bërë plojë. Lumi qe mbushur plot me kufoma.

Jo larg Prizrenit 5000 shqiptarë janë shfarosur. Gjeneral Jankoviqi i ka urdhëruar prijësit e Prizrenit, me revole në dorë, të nënshkruajnë një deklaratë për mbretin Aleksandar, në të cilën shprehnin falenderimin që ushtria sërbe i ka çliruar. Pastaj, meqë nuk kishim kuaj, i kemi ngarkuar rreth 200 shqiptarë me nga 50-60 kile dhe i kemi detyruar të ecin 7 orë me ato ngarkesa në krahë, nga Prizreni deri në Lumë.

Në rrethinat e Prishtinës i kemi asgjësuar në masë rreth 5000 shqiptarë.

Vetëm në 2 muajt e parë të vitit 1912, anembanë Kosovës e Metohisë i kemi vrarë përmbi 25000 shqiptarë.

Një shënim i gazetarit Tomiq: Në të 2 krahët e rrugës në regjionin e Gjakovës, nuk kam parë asgjë tjetër, përveç fshatravet të djegur, rrënuar krejt gjer në themele . Rrugët ishin plot me trekëmbësha, në të cilët lëkundeshin shqiptarë të varur.

Në rrethin e Pukës i kemi therur 72 njerëz (gra, pleq dhe fëmijë).

Vendbanimin Mjedë afër Shkodrës e shndërruam në prush dhe në hi.

Në të njëjtën kohë, malazezët i kanë djegur të gjithë fshatrat në Kranjë të Shkodrës. Të gjithë kranjanët kanë ikur dhe janë strukur në Shkodër.

Viti 1913.

Një sërb i Çagllavicës, afër Prishtinës, i ka vrarë 100 shqiptarë. Këtë ua ka thënë vetë ai gazetarëvet të huaj.

Një sërb i vetëm, me litarë lopësh dhe me copëra telash, i ka lidhur të gjithë myslimanët e papushkatuar të fshatit Sop pranë Kërçovës, gjithsej rreth 200 vetë, i ka shpurë në një xhami, i ka mbuluar me sanë, i ka vënë flakën sanës dhe i ka djegur aty të 200 shqiptarët.

Në fshatin Ujzë, midis Gjakovës edhe Prizrenit, e dogjëm mu brenda në shtëpi një familje me 20 anëtarë. Ca fëmijë tentuan të iknin, por u dolëm përpara dhe i copëtuam me bajoneta.

Në Pejë zumë rob 1300 shqiptarë, kërkuam që të kalojnë në fenë pravosllave, ata nuk deshën dhe ne i pushkatuam që të gjithë.

Të zënët rob në një fshat të Ohrit, me urdhër të komandës po i çonim për në Kërçovë. Midis tyre gjendeshin edhe 10 gra e 9 vjaza shqiptare. Gjatë rrugës, i kemi përdhunuar dhe, pas përdhunimevet, i kemi vrarë të 19-at.

Në fshatin Nishor të Prizrenit u pushkatuan 42 shqiptarë.

Në trevën e Krrabës, rrethina e Elbasanit, i kemi vrarë diku rreth 20 a 30 shqiptarë.

Prej burgut të Prizrenit disa shqiptarë tentuan të na ikin. Ne i kemi vrarë të paktën 19 prej tyre.

Në një përleshje me kryengritësit, afër Prizrenit, i vramë 200 shqiptarë.

Mund të themi që krahina e Lumës tashmë nuk ekziston. Gjithkund hi edhe pluhur. Ka fshatra me nga 100 e 150 shtëpi, ku as edhe 1 banor nuk ka mbetur gjallë.

Në fshatin Topojan afër Kukësit i kemi korrur me mitraloza 400 fshatarë të bërë grumbull.

Në vende të tjerë, i kemi djegur të gjallë në shtëpitë e tyre.

Njoftim i një oficeri malazias: 'Shqiptarët, në fillim, i vrisnim me pushkë dhe me revole. Por së shpejti morëm urdhër se s'kish levërdi të shpenzohej municioni, prandaj duhej t'i thernim me thika. Pas këtij urdhëri, i gruponim nga 40 ose 50 sish, i vinim në 2 rreshta, të kthyer me fytyrë nga njëri-tjetri dhe atëherë, oficerët tanë dhe nënoficerët, i shponin njërin pas tjetrit pas qafet.'

Një oficer i yni u dha urdhër kryepleqvet të 2 katundeve në jugperendim të Prizrenit që t'i thërrisnin në kuvend të gjithë meshkujt. Erdhën 83 vetë dhe ne i pushkatuam që të gjithë.

Po ashtu është vepruar edhe në fshatrat Lojmë e Nimçë, rrethina e Prizrenit. U është dhënë urdhër kryepleqvet që t'i mblidhnin fshatarët për regjistrim. Janë vrarë 36 nga fshati Lojmë dhe 54 të Nimçës.

Gjithsej në trevat e Lumës dhe Opojës i kemi shfarosur mbi 672 prej tyre, shumica gra e fëmijë, që të mos mund të shtoheshin, dhe i kemi shndërruar në hi 573 shtëpi.

Në rrethinë të Gjilanit, vetëm në fshatin Kabash kemi vrarë 47 shqiptarë.

Anglezja Edith Durham, ndonëse nuk e miratonte qëndrimin tonë ndaj shqiptarëvet, na i ka lënë megjithatë disa të dhëna të dobishme. Ajo shkruan: 'Ka fshatra me nga 100, 150 ose 200 shtëpi, ku tash nuk ka asnjë frymë njeriu. I mbledhin njerëzit në grumbuj nga 40 e 50 sish dhe i shpojnë me bajoneta që të gjithë.'

Në Reçan të Gostivarit, sërbët, pasi i kanë pushkatuar 30 meshkuj të rritur, kanë mbyllur në 2 shtëpi 200 gra, fëmijë e pleq dhe i kanë djegur të gjallë.

Në fshatin Zdunjë pranë Gostivarit i dogjëm 37 gra, fëmijë dhe meshkuj të rritur.Të nesërmen kemi çuar edhe 9 sish në të quajturin Vakufi i Benicës dhe i kemi masakruar.

Në Simnicë pranë Gostivarit kemi djegur 113 shtëpi dhe kemi vrarë 18 shqiptarë.

Pas 8 ditësh, sekretari i qarkut i ka thirrur me emra 22 fshatarë, ata kanë ardhur, i kemi lidhur dhe jemi nisur gjoja për në prefekturë dhe i kemi masakruar edhe ata në Vakufin e Benicës.

Në fshatin Gjinovc pranë Gostivarit i dogjëm 7 shtëpi, bashkë me njerëzit që i kishin brenda. Vetëm 2 prej tyre kishin nga 17 frymë.

Në fshatin Vërtok kemi pushkatuar 18 vetë dhe i kemi groposur në Bigor. Edhe 40 të tjerë i kemi çuar në Vakuf të Benicës dhe i kemi pushkatuar. Vakufi i Benicës është vend shumë i përshtashëm për vrasjen e shqiptarëvet. Atje gjenden nja 10 gropa goxha të mëdha, plot me kokadha shqiptarësh të vrarë.

Në Kalisht të Gostivarit, rrugës për në Pozheran, kemi vrarë dhe therur 43 vetë.

Në Çergan kemi vrarë 32 vetë, duke i çuar për në Gostivar.

Në vendin e quajtur Qafa e Gostivarit kemi masakruar 65 gra, pleq e fëmijë.

Qyteti i Dibrës, prej 20000 banorëvet, sot ka vetëm 2000. Një pjesë e popullatës është arratisur kurse pjesën tjetër e kemi asgjëuar ne. Fshatrat që i kemi djegur nuk kanë të numëruar.

Në fshatin Gjoricë kemi masakruar 14 vetë, bashkë me kryeplakun e tyre. I kemi mbytur me të rrahura2 gra dhe 6 fëmijë.

Në fshatin Zogaj kemi djegur 124 shtëpi dhe kemi masakruar 12 vetë. 4 prej tyre i kemi hedhur në zjarr, 4 i kemi therur, pastaj jemi kthyer dhe i kemi vrarë edhe 4 të tjerë.

Në Maqellarë i kemi bërë copa-copa me bajoneta16 vetë.

Fshatin Bllacë, së pari e kemi plaçkitur, pastaj i kemi vënë flakët nga të gjitha anët. Të gjithë banorët i kemi masakruar.

Në Allajbeg u dogjën 65 shtëpi, u masakruan me mënyrat më të përshtatshme 23 vetë, midis të cilëvet 7 gra dhe 1 fëmijë 5-vjeçar.

Në Vajniki kemi djegur të 15 shtëpitë, therur 4 vetë, duke vrapuar pas tyre, pastaj kemi mbytur një vajzë të vogël.

Në Luzni i masakruam 45 vetë.

Në fshatin Deshat u shndërruan në shkrumb15 shtëpi dhe kemi hedhur të gjallë në zjarr 3 fëmijë dhe 2 gra.

Në vendin e quajtur Pilat-Mahallakemi shpuar me bajoneta dhe hedhur në zjarr 2 meshkuj të rritur dhe 2 fëmijë.

Në vendbanimin Peshkopi kemi djegur 57 shtëpi dhe kemi masakruar 6 vetë.

Në vendin e quajtur Qafë-Bulqiza i pushkatuam 13 vetë.

Numri i myslimanëvet të masakruar prej forcavet tona është… Në Kërçovë 184, në Çallopek 47. Katundet Lopi, Zajazi dhe Lesani i kemi djegur, ndërsa banorët i kemi vrarë. Në Tetovë kemi burgosur 400 shqiptarë myslimanë dhe i kemi ekzekutuar rrugës për në Shkup. Në afërsi të Shkupit kemi therur 2000 shqiptarë.

Në Ujëz, në breg të Drinit, 32 vetë i kemi mbyllur në një shtëpi dhe i kemi djegur, edhe shtëpinë, edhe ata, të mbyllur brenda saj.

Forcat e bashkuara të sërbëvet dhe të malazezëvet në Plavë e në Gusi kanë pushkatuar 720 shqiptarë meshkuj.

Prej këtye 559 në vendin e quajtur Qafa e Previsë, 150 në Brezovicë dhe 11 brenda në qytetin e Plavës.

Njëfarë Koline prej Gusiet ia nxorëm sytë me bajonetë përpara fëmijëvet dhe gruas së tij.

Në Budovicë të Plavës njëfarë Rexhep Ferataj e kemi lidhur te trungu i një dardhe, ia kemi nxjerrë sytë me thikë dhe në fund e kemi djegur të gjallë.

Le të përmendim tash disa nga prijësit e shqiptarëvet që i kemi vrarë: Halil Haxhia nga Drenica, Fejzullah Lipovci nga Klina, Hetem Korineni nga Hoti i Plavës, Hetem Dobrosheva dhe 18 të tjerë. Që të gjithë i kemi pushkatuar dhe me kaq e kemi kryer me nder detyrën për vitin 1913.

Viti 1914.

Në viset rreth Drinit të Bardhë, 18 vendbanime, Ostrozub etj, kemi vrarë 227 shqiptarë dhe kemi djegur 1032 shtëpi.

Nga Manastiri kemi dëbuar 20000 frymë. Përmbi 7000 të ikur nga fshatrat përreth gjenden ende në Manastir, por ne nuk po i lejojmë që të rrinë këtu. Po i përzëmë edhe këta.

Nga Dibra me rrethinën kanë ikur edhe 3000 frymë, duke lënë shtëpitë të plaçkitura dhe, në fund, të djegura.

Në krahinat e Matit, Çermenikës, Tiranës dhe Elbasanit gjenden 80000 ikanakë.

Nga Jugu i Shqipërisë grekët kanë dëbuar 100000 shqiptarë, prej të cilëvet kanë vdekur rrugës nga uria mbi 30000. Në këtë mënyrë po ngushtohet toka e Shqiptarëvet dhe ne do ta sërbizojmë së shpejti edhe Durrësin.

Viti 1918.

Në Podgoricë dhe në Malësi malazezët kanë vrarë 20 shqiptarë.

Nga viti 1912 deri në vitin 1918, nëse i përmbledhim rezultatet tanë, shifrat e rrumbullakosura janë këto: 200000 shqiptarë të asgjësuar dhe 200000 të dëbuar.

Viti 1919.

Në fshatin Cërna Lluka, në krah të Rozhajës dhe Senicës, i vramë 9 vetë.

Në Tërgovishtë, në anët e Gjakovës, i vramë 100 shqiptarë, jo për ndonjë arsye, por thjeshtë nga dëshira për t'i pakësuar.

Në Akovë të Peshterit i zhdukëm 800 njerëz. Zumë rob 46 vajza, 6 prej tyre i përdhunuam, 40 të tjerat e nisëm për Mal të Zi, që edhe ata të bëjnë si ne.

Në Koshutan, Koshuticë, Bukël, Bisirnicë, kemi vrarë 28 vetë dhe kemi rrëmbyer 1390 krerë bagëti.

Në Rozhajë numri i shqiptarëvet të asgjësuar deri në vitin 1919 arrin në 700 frymë. Do të mundohemi që këtë numër ta pesëfishojmë.

Në 10 vendbanimet rreth Mitrovicës i kemi masakruar 180 shpirt. Kapiten Millan Kllapiqi po thotë: 'Ndjehem i kënaqur kur derdh gjak shqiptarësh.'

Në 105 katundet rreth Vushtrrisë i asgjësuam 1007 vetë. (Në Qefali 12, në Kullë 43, në Obiliq 7, në Tristeniq 13, në Popovë 23 e kështu me radhë.)

Në Kerninë pranë Istogut i kemi vrarë 17 vetë, kemi djegur 30 shtëpi dhe kemi rrëmbyer 20000 krerë bagëti.

Në Çellopek pranë Pejës i vramë 16 shpirt, në Beranë 11.

Afër Prishtinës ushtria sërbe i ka therur 4800 gra, foshnja dhe pleq. Vetëm në 3 katunde pranë Prishtinës u vranë 1400 shqiptarë.

Naçallniku i Gjakovës e dogji katundin Batushë, i lidhi 11 meshkuj pas shelgjevet dhe i korri, në kohën kur shtëpitë e tyre po digjeshin.

Në Radavc pranë Istogut ushtria jonë vrau 15 vetë vetëm në 1 familje.

Në Jabllanicë pranë Pejës i vramë 73, meshkuj, gra e fëmijë. Prapë në Jabllanicë, njerëzit tanë kanë hyrë në xhami, i kanë lidhur të gjithë të pranishmit me gjithë hoxhën e tyre, kanë djegur xhaminë dhe ata, brenda në xhami, i kanë djegur të gjallë.

Në vilajetin e Kosovës, vetëm në 2 muaj, janar - shkurt 1919, janë vrare 12370 shqiptarë dhe janë djegur 6100 shtëpi.

Në Plavë, Gusi dhe Rugovë, nga 8 deri 25 shkurt numërohen 844 të masakruar. Ndërkaq, më 20 mars, gjithashtu në viset e Plavës dhe Gusisë, janë masakruar 942 meshkuj të rritur, 399 gra dhe 360 fëmijë. Kemi djegur 945 shtëpi të shqiptarëvet. I kemi hedhur të gjallë në zjarr dhe kemi hedhur valle rreth zjarrevet, tek sa ata përpëliteshin mes flakëvet.

Në 17 fshatra të Prizrenit i vramë 376 vetë dhe dogjëm 85 shtëpi.

Në Tetovë i vramë 30 vetë dhe dogjëm 636 shtëpi.

Në Istog, në 1 ditë ushtarët tanë i vranë 160 vetë dhe nuk i kanë groposur deri sa është qelbur krejt fusha.

Në krejt Kosovën, pa Metohinë, në vitet 1918 – 1919, ushtria jonë ka vrarë, me armë zjarri dhe me të rrahura me hunj, 30000 frymë, ka djegur 168 katunde, me gjithsej 4869 shtëpi të bëra shkrumb.

Vitet 1919 – 1940.

Janë shpërngulur për në Turqi shqiptarë gjithsej gjysmë milioni (500000). Në këtë mënyrë, Turqia bëhet aleati dhe miku më i mirë i yni, pikërisht në kohën kur ne me zell të madh po i asgjësojmë bashkëbesimtarët e turqvet. Rroftë Turqia, që po na ndihmon ta çlirojmë Ballkanin prej myslimanëvet!

Viti 1920.

Në Kolisht pran Gostivarit i vramë 43 vetë.

Në fshatin Banja afër Prizrenit i mbytëm me shkopinj 15 meshkuj.

Në fshatin Cërna Lluka, rrethina e Prizrenit, 5 vetë, në Ozhevc pranë Vushtrrisë 10 vetë, në fshatin Pallankia pranë Vushtrrisë 10 vetë, në Bratje 10 vetë. Të gjithë këta i kemi rrahur me shkopinj dhe i kemi mbytur, në mundime të papërfytyrueshëm.

Në relacionin Gjakovë – Prizren kemi djegur këtë herë 300 kulla trekatëshe dhe kemi vrarë 350 vetë.

Në bjeshkën e Isniqit i vramë 27 barinj, rrëmbyem 7000 krerë dhen dhe 300 qe dhe lopë.

Në bjeshkën e Junikut, Carabreg etj, për t'u rrëmbyer bagëtitë, i vramë 131 vetë.

Në fshatin Jabllanicë vramë 39 vetë.

Në regjionin e Pejës kemi masakruar 200 fëmijë meshkuj të moshës deri në 10 vjeç, 300 gra të reja dhe 270 meshuj të moshuar.

Në Plavë e Gusi i kemi mbytur në barkun e nënavet 26 foshnja.

Në Shabran afër Prishtinës i masakruam 10 fëmijë edhe gra.

Në rrethinë të Prishtinës, edhe 16 të tjerë i vrammë.

Në Fushëbardhë të Prishtinës i kemi masakruar në sulmin e pare 19, pastaj edhe 25, kryesisht gra, fëmijë edhe pleq. Në të 2 rastet kemi përdorur metoda novatore të asgjësimit.

Në viset e Llapit e të Gollakut u bë kështu: në Podujevë vramë 28 vetë, në Keqekoll 490 vetë, në Prapashticë 1020 vetë, në Shubran 31 vetë, në Fushëbardhë të Llapit 30 vetë, në Nishevc 14 vetë, në Gërdovc 25 vetë, në Llupc të Epërm 12 vetë. Edhe këtu, si kudo, kemi aplikuar mënyra vrasjesh nga më të larmishmet.

Viti 1921.

Në 3 muajt e parë të vitit 1921, në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, kemi masakruar gjithsej 2000 shqiptarë. Në një tjetër përmbledhje thuhet: Shqiptarë të vrarë me armë zjarri 12371 dhe të mbytur me forma të ndryshme mundimesh 625. Për vitin 1921 ka edhe një tjetër përmbledhje: Në regjionin e Prizrenit e të Lumës 956 të vrarë ose të mbytur me forma të ndryshme torturash, në Vushtrri 2394, në Prishtinë 4950, në Ferizaj 1885, në Gjilan 900, në Preshevë 345, në Plavë e Gusi 1810, në Pejë 1840. Gjithsej të vrarë ose të mbytur me të rrahura 15676 shqiptarë.

Vitet 1922 – 1924.

Në fshatin Ramushiq i vramë 16 meshkuj, mblodhëm plaçkë në 20 familje, me vlerë 20000 napolona dhe rrëmbyem 15000 krerë bagëti, të imëta dhe të trasha.

Prill, 1922.

Në Obërdan i vramë 8 shqiptarë, mblodhëm plaçkë në 200 familje, me vlerë 50000 napolona, rrëmbyem 15000 krerë bagëti, të imëta dhe të trasha.

Në Ruhot vramë 6 vetë, mblodhëm plaçkë në 20 familje, rrëmbyem 3000 bagëti, të imëta dhe të trasha.

Në Lutogllavë vramë prapë 6 vetë, rrëmbyem 1000 krerë bagëti dhe 40000 kuintalë groshë, grurë dhe misër.

Në Prapaçan vramë 7 vetë, trupat e tyre i kemi rrasur në një pus, që shqiptarët të mos i gjenin për t'i varrosur pas zakonit të tyre.

Prill – maj 1922.

Në bjeshkën e Isniqit vramë 8 barinj dhe rrëmbyem 9000 krerë dhen.

Në Tërstenik vramë një plak 80 vjeç, rrëmbyem 1500 krerë bagëti dhe 15000 kuintalë drithëra.

Në Shtup vramë 6 vetë dhe rrëmbyerm 1100 krerë bagëti.

Në fshatin Bruçaj të Pejës dogjëm 15 shtëpi. Rrëmbyem 1000 krerë bagëti.

Viti 1923.

Në shkurt 1923 në regjionin e Junikut vramë 60 shqiptarë, në Gjakovë i burgosëm 150 shqiptarë.

Në tetor 1923 prapë në Junik vramë 10 vetë, në Rrasinë 3, midis tyre edhe një fëmijë 6 vjeç.

Në Dumnicë xhandarmëria jonë masakroi 23 meshkuj, duke përdorur me atë rast metodat më atraktive të djegies dhe të bërit shkrumb, brenda në shtëpitë e tyre.

Vitet 1941 – 1947.

Në Hot, midis Shkodrës dhe Podgoricës, malazeztë vranë 15 shqiptarë malësorë.

Në Pdgoricë, në breg të Ribnicës, malazeztë gjithashtu vrasin 9 shqiptarë.

Njëfarë malësori katolik, me memrin Kolë Uci nga Trieshi, ia kemi nxjerrë sytë dhe ia kemi prerë veshët.

Në Pejë i vramë 15 shqiptarë, në Gjakovë 12, në fshatin Bici apo Buci kemi vrarë 3 gra të reja megjithë foshnjat e tyre.

Në Rogovë vramë 13 shqiptarë.

Gjithsej në rrethinë të Gjakovës, të pushkatuar 260 shqiptarë.

Në senicë të Sanxhakut, në fshatin Visoçkë, i kemi djegur në një shtëpi 12 vetë.

Në fshatrat rreth Medvegjës i kemi masakruar pa dallim të gjithë banorët. Po përmendim 4000 frymë, por nuk po dimë, sa i kemi vrarë dhe sa ia kanë dalë të na ikin.

Janar 1943.

Viti i Ri. Ploja në Bihor. Rezultati: Fëmijë të therur kryesisht me thika 701. Fëmijë të pjekur në zjarr 705. Fëmijë të ngrirë në borë, në përpjekje për t'u arratisur, 447. Gra të vrara 340. Gra të masakruara 185. Gra të ngrira në bore 266. Meshkuj të rritur, të vrarë me armë zjarri, 590. Meshkuj të masakruar 185. Meshkuj të ngrirë 119. Vdekur nga uria 103 shqiptarë. Zënë rob 251. Të plagosur, meshkuj të rritur 359, gra të plagosura 275. Gjithsej: 4526. Shtëpi të djegura 1763. Zoti Drazha Mihajlloviq u uron të gjithhë sërbëvet Vitin e Ri dhe Natën e Vishkujvet, duke u falenderuar komunistëvet që nuk na kanë penguar në këtë punë të shkëlqyer.

Viti 1944.

Në fshatrat Banjë e Podvoricë çetnikët tanë kanë vrarë ose plagosur 70 vetë.

Në Prizren, në 1 ditë të vetme, ne komunistët i pushkatuam edhe 70 vetë. Përsëri në Prizren, në pjesën e qytetit që quhet Tophanë, u pushkatuan 350 shqiptarë.

Te burimi i lumit, afër Istogut të gjithë shqiptarët e pushkatuar i kemi hedhur në ujë. Ishin aq shumë, sa që uji, ndonëse i rrjedhshëm, është qelbur aq keq, sa as bagëtitë nuk e pinin.

Në Istog, fshati Muzhevinë, asgjësuam një familje me 13 pjesëtarë.

Në Kizhnjë kemi bërë copa – copa me bajoneta 8 vetë, kurse njërin e kemi hedhur të gjallë në zjarr.

Në Planë, afër Ferizajit, i pushkatuam 28 vetë.

Në Prishtinë kemi vrarë më shumë se 200 vetë.

Në fshatrat e Mitrovicës janë vrarë më shumë se 2000 shqiptarë.

Në Vushtrri kemi vrarë 400 shqiptarë dhe i kemi mbuluar me pleh.

Në kampin e Gostivarit i pushkatuam 300 vetë.

Në Tetovë, në ambientet e monopolit të duhanit, ku i patëm rrasur 10000 shqiptarë, i kemi masakruar mbi 1200 prej tyre. Gjithashtu, po në atë monopol duhani, i kemi përzgjdhur 500 djem të rinj dhe i kemi nisur për Shkup, gjoja për t'iu bashkuar ushtrisë partizane. Por gjatë rrugës i kemi vrarë që të gjithë.

Në Gradec afër Tetovës i pushkatuam 35 vetë.

Në Nikodinë pranë Tetovës, 18 vetë.

Në Reçicë të Madhe e të Vogël, 40 vetë. Vetëm një oficer i OZN-s, me dorën e vet ka vrarë në këto anë 50 shqiptarë.

Në krejt këto veprimtari tonat, tepër të rëndësishme, meritë të veçantë ka shoku Svetozar Vukmanoviq–Tempoja, i dërguari special personal i shokut Tito në frontet e luftës këtu në Republikën Populllore të Maqedonisë."

(Shënim i relatorit: "Emrin e Titos, Stevan Jovanoviqi e ka prishur me një iks të madh.")

"Në Zajaz, jo larg prej Kërçovës, i kemi pushkatuar 320 shqiptarë të moshavet të ndryshme, filluar prej 13 vjeç deri në 70.

Në Bojan të Shkupit i kemi pushkatuar 76 meshkuj të rritur, gra edhe fëmijë.

Në Bllacë të Shkupit kemi vrarë me forma të ndryshme 160 meshkuj të rritur dhe 50 fëmijë.

Në Sarajet e Shkupit vramë 25 vetë.

Në fshatin Bllacë, Karadaku i Shkupit, kemi pushkatuar 100 vetë. 27 të tjerë, gjithashtu të fshatit Bllacë, i kemi çuar te Uji i Thartë përtej Hanit të Elezit, dhe atje i kemi pushkatuar.

Në fshatrat e Karadakut të Shkupit i kemi "larë" me ujë të valë 83 vetë.

Në Sopot pranë Kumanovës, grate i kemi përdhunuar, kurse 20 meshkuj i kemi pushkatuar.

Në vendin e quajtur Bukurocë afër Preshevës, 36 vetë i kemi rrasur në një dhomë, pastaj i kemi "larë" me ujë të valë.

Fshatin Bukurocë e Keqe pranë Preshevës e kemi rrethuar para dritet, i kemi zgjuar banorët me alarm dhe i kemi detyruar të hapin një gropë të madhe 2 metra të thellë.Në ndërkohë kemi përgatitur mbi zjarr një fuçi 200-litërshe me ujë të valuar. Kemi veçuar 27, meshkuj, gra e fëmijë, ua kemi lidhur duart, ua kemi mbyllur gojët me copa leckash që të mos bërtisnin dhe i kemi zbritur në gropë. Ua kemi përmbysur fuçinë me ujë të valë përsipër. Trupat e tyre janë shkrirë si dylli i qirinjvet.

Në Qarr të Gjilanit i kemi copëtuar me thika, natën, 21 vetë të moshavet të ndryshme.

Në Sedllar pranë Kamenicës kemi masakruar 3 vetë.

Në Desivojë, 15 vetë.

Në Krajndellë, gjithashtu pranë Kamenicës, 12 vetë.

Në Koretinë ia kemi shuar jetën një familjeje me 11 vetë.

Në Hogosht i vramë 16 vetë.

Në Lisovicë i kemi masakruar në një mënyrë krejt të veçantë 7 vëllezër. Ishin muratorë. I kemi mbyllur në shtëpinë e tyre, i kemi torturuar në mënyrën më të paparashikueshme: ua kemi mbërthyer duart me gozhdë mbi dysheme dhe kemi ndezur e djegur në sytë e tyre një fëmijë 6-vjeçar, me merin Mursel Selimi.

Në Ponesh pranë Gjilanit kemi masakruar 12 vetë. Duhet të vëmë në dukje që, të gjithë ne, si çetnikët, ashtu edhe komunistët, jemi udhëhequr nga i njëjti parim racional dhe tepër i arsyeshëm: Të mos kursehen thikat, të kursehen fishekët.

Në fshatin Shahicë pranë Gjilanit, më 28 Nëntor 1944, në të ashtuquajturën Dita e Pavarësisë e shtetit shqiptar, e kemi shfarosur një familje me 12 anëtarë. S'e patëm qëllimin për të simbolizuar vitin 1912, por ashtu rastisi. Kur i zoti i shtëpisë ka ardhur në shtëpi, i ka gjetur që të gjithë të therur.

Fshati Tabelie afër Vitkovcit tentoi t'u kundërvihet çetnikëvet tanë, por këta vranë 54 vetë dhe e qetësuan fshatin.

Viti 1945.

Në fillim të vitit 1945 kemi rekrutuar për ushtrinë tonë nacionalçlirimtare në krejt Kosmetin me mijëra shqiptarë, duke propaganduar domosdonë që edhe ata të marrin pjesë në luftë kundër nacizmit gjerman. E kemi rregulluar një marrëveshje me komandën e së quajturës Ushtri Nacionalçlirimtare Shqiptare, që të lejojë kalimin nëpër gjoja territorin e tyre, dhe, ne antinacistët sërbo-malazezë, i kemi masakruar, mu në mes të Tivarit, diku rreth 3000 apo 4000 të atillë antinacistë shqiptarë. Pjesën tjetër i kemi degdisur për në Kroaci.

Në Kaçanik, Gjilan, Viti e Preshevë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, Ushtria jonë Nacionalçlirimtare ka asgjësuar në mënyra të ndryshme 12000 shqiptarë.

Në vitet 1940-1945, llogaria e shqiptarëvet të asgjësuar prej forcavet tona sërbe, përfshirë këtu edhe ato malaziase e maqedone, është kjo: Çetnikët kanë vrarë, djegur apo therur 5200 shqiptarë, partizanët kanë vrarë, therur apo djegur të gjallë, në territorin e Kosovës 36000, në Metohi 23000 dhe rreth Vardarit 27000. Gjithsej shqiptarë të shfarosur prej forcavet tona në krejt territoret tanë të banuar me shqiptarë, filluar prej Manastirit deri në Tivar, janë 91200.

Viti 1947.

Më 1947-n, për nder të përfundimit me sukses të Konferencës së Paqes në Paris, ne, afër qytetit Goricia, mu në kufi me Italinë, i kemi mbytur me gaz të helmet 2000 shqiptarë. Kanë qenë pjesë e kontigjentit që ishin kursyer në Masakrën e Tivarit në prill të vitit 1945. Patën luftuar bashkë me ne, si partizanë, në përleshjet me gjermanët, por kuptohet, ne nuk mund të lejonim që ata të ktheheshin në Kosovë si çlirimtarë të Jugosllavisë. Kjo ishte dhe arsyeja pse i mbytëm me gaz 2000 shqiptarët, duke u larë në banjat me dush."

Cvetko Kilibarda ndjehej si i mpirë. Ai i shtriu këmbët poshtë tavolinës dhe tentoi të flinte, duke pritur zbardhjen e dritës.

(Sqarim i autorit të romanit: Të dhënat e këtij kapitulli janë historikisht të dokumentuara. Krahaso: Gjokë Dabaj, ***"Strategjia e shqiptarëvet"***, faqe 98-113.)

MEGJITHATË, JEMI NJERËZ

Borka atë mëngjes nuk mund të ndjehej e qetë. I zhvendoste sendet nga njëri vend te tjetri. Karrikja nuk i rrinte mirë. Mbi kompjuter kish mbetur edhe pak pluhur. E mori leckën, e pastroi pluhurin. Prapë, diçka s'ish në rregull. E mori sërish leckën. Momoja e shihte dhe buzëqeshte. Borka u ngrit dhe ngutshëm doli në korridor.

Ndenji atje nja 10 minuta. Kur u kthye, Ristoja i tha: ***„Duhet të fillojmë.“*** Edhe ajo e dinte se dita e punës tashmë kish filluar dhe se duhej të rregullohej pranë tavolinës së vet, por ish aq e shqetësuar, sa asgjë rretherrotull nuk i dukej normale. Edhe shëbyesja ishte e tronditur. Borkës iu duk se edhe orenditë atë mëngjes kishin marrë vesh diçka të pazakontë. Shërbyesja, me zë të ulët, gati me pëshpëritje, ia pat rrëfyer atë që ish lexuar atë mëngjes në të gjithë ekranet e internetit. I pat rrëfyer atë që vetë Borka nuk po mund ta largonte prej mendjes. Dëgjonte ato që po i thoshte shërbyesja dhe vetë ajo ia ritregonte shërbyeses të njëjtat gjëra. Ristoja e kish vënë re që diçka nuk ishte në rregull te sekretarja. Në të vërtetë, as ai nuk po ndjehej mirë dhe shkaqet tashmë ishin të disafishtë. ***“A ka diç që nuk po shkon si duhet?”*** E pyeti ai Borkën. Ajo e ngriti kryet. E shikonte Riston drejt e në sy. Edhe ai po e shikonte atë. Fytyra e saj ishte jashtë mase e shkëlqyeshme. ***„Megjithatë, jemi njerëz.“*** Tha ajo. ***„Duhet që edhe ne, po mendoj: ne sërbët, të kemi ndjenja njerëzore dhe moral njerëzor.“*** Ristoja, vetëm atëherë e kuptoi shkakun e pamjes së saj jonormale.

EDHE KARAXHIQI ËSHTË I DYSHIMTË

Ilaçet e doktor V.Velimiroviqit, ndonëse ai nuk gjendej në Beograd, dukej se e kishin bërë efektin qetësues. Stevani nuk ishte i tronditur, nuk po bënte zhurmë dhe nuk po protestonte. E sollën nga ***„nëntoka“***, e ulën në karriken e zakonshme, ia hoqën prangat dhe, duhej thënë, apo duhej menduar se e filluan normalisht bisedën. ***„E ke ngritur krejt burgun në alarm.“*** I tha Ristoja. ***„Më shtiresh si i çmendur e shihet fare mirë që nuk je i çmendur.” “Kush Ju tha se jam i çmendur?!”*** Reagoi Stevani. ***“Ju lutem, mos më fyeni! I kam mbrojtur me sukses nga më ambiciozët 2 doktoratura para një komisioni prej profesorësh dhe akademikësh tanë më të nderuar.” “Nuk do të ma mbante t’i lexoja disertacionet e tu.”*** I tha Ristoja dhe vazhdoi me pyetjet e parapërgatitura: ***“I ke quajtur shqiptare një numër jo të vogël të familjevet tona më të mira. Na e sqaro: Përse janë paraqitur në atë mënyrë?!” “Është rezultati i studimevet të mi. Ashtu siç kam zbuluar prejardhjen dhe lidhjet e vërteta gjenetike të ish-gruas sime, ashtu kam zbuluar edhe prejardhjen gjenetike të familjevet të përmendura, përfshirë aty edhe Tuajën. Jeni të shumtë ju shqiptarët, të infiltruar në kombin tonë. Pikërisht për këtë unë po ua tërheq vëmendjen në mënyrën më serioze atdheut tonë dhe patriotizmit tonë.”***

Megjithëse nuk merrte vesh asgjë nga shkencat filologjike, Ristoja ishte i detyruar t’i orientonte pyetjet pikërisht në atë drejtim. Si do të shpjegohej gjuhësisht psh prejardhja e familjevet: Llaliq, Lekiq, Nikeziq? Stevani i shpjegonte me passion që të gjitha. Në vend të një seance dëgjimore, ku çdo gjë duhet të jetë zyrtare, u krijua aty një farë atmosfere argëtuese, si të thuash, atmosferë bisedash tejet tërheqëse.

Stevani nuk e njihte gjuhën shqipe, nuk kish shkelur kurrë në shtetin shqiptar, në Kosmet kishte shkuar, por kurrë nuk e kish shkëmbyer as edhe 1 fjalë me shqiptarët. Megjithatë krijohej përshtypja që secila etimologji e tija, e krahasuar me gjuhën shqipe, mbështetj në arsyetime thellësisht shkencorë. Kish udhëtuar nëpër Evropë, kish kontaktuar me ballkanologët më të njohur të botës, midis të cilëvet edhe me albanologë, dhe dukej sikur nuk kish asnjë pyetje nga fusha e filologjisë, së cilës ai të mos mund t'i përgjigjej.

"Ke shkaktuar një zhurmë të pakundshoqe në krejt burgun." Ia përsëriti Ristoja. ***"Po. U mbajta një fjalim të pranishmëvet. Ata janë kolegët e mi burgaxhinj dhe duhen informuar imtësisht." „E ke shndërruar në shqiptar deri edhe Sheshelin." „Vetëkuptohet! Rrëziku nuk na vjen ne prej shqiptarësh të deklaruar. Rrëziku na vjen prej shqiptarësh të fshehur dhe në përgjithësi prej personavet të fshehur, të cilët shtiren sikur e duan Sërbinë mbi gjithçka."*** Ai heshti për një çast, sikur po i rrotullohej diçka nëpër krye, pastaj tha: ***„Le të marrim si shembull zotin Radovan Karaxhiq. Ai është i dyshimtë në thelbin e vet."*** Risto Kilibardës iu duk sikur efekti i ilaçevet ishte duke mbaruar. Filloi të mendojë si do ta mbyllte seancën. Nuk dëshironte incidente. Megjithatë, e pyeti të padituri: ***"Në ç'kuptim mendon se është i dyshimtë presidenti i Republikës sonë Sërbe?" "Në kuptimin e llagapit të tij. Fjala KARA e dimë të gjithë që është fjalë turke dhe do të thotë I ZI. Tingulli XH është mbetje e emrit HAXHI, që në gjuhën arabe tregon njeriun, i cili udhëton për t'u falur në Vendet e Shenjtë të Mekës. Kështu vijmë te konstatimi i papritur që paraardhësi i zotit Karaxhiq paska qenë një HAXHI me lëkurë TË ZEZË. Në të vërtetë, ne nuk e dimë nëse ai HAXHI ka qenë i fesë pravosllave dhe ka shkuar me atë emër në Jerusalem, apo ka qenë farë kripto të krishteri, i cili ka udhëtuar për në Mekë, me qëllim që t'u serviloset agallarëvet të turqizuar të Bosnjës." "Në këtë mënyrë,"*** e vuri re Ristoja, ***"ti po hedh dyshime edhe te i madhi Vuk Karaxhiqi ynë." "Vuku i këngëvet?! S'do mend!"*** Bërtiti Stevani, edhe ironik, edhe me entuziazëm. ***"Në gjykimin tonë më të butë, ai Vuku i këngëvet gjithë jetën e vet ka hequr pisërinë për të ndrequr emrin e një paraardhësi të tij të murrmë apo të zi. Në të gjitha këto që t'i thashë, nuk ka pikë dyshimi."***

Deri në atë çast dukej sikur po bisedonte me dike në rrugë, por papritur mori pamjen e një vlerësuesi të rëndësishëm: ***"I vetmi njeri, të cilit unë i besoj, është general Ratko Mlladiqi. Zonjushë, Ju lutem, shkruajeni çdo fjalë!"*** Iu drejtua sekretares. ***"Gjeneral Mlladiqi është shembulli i qëllimit tim në jetë. Ai është frymëzimi i qëllimit tim në jetë, por, në mënyrë krejt paradoksale, në kohën kur ai po komandon me lavdi ushtrinë tonë në Përndjekjen e Dytë të Turkoshakëvet, unë po dergjem në një qeli burgu, mu në kryeqytetin e atdheut tim! A e kuptoni, zonjushë, sa e vajtueshme është kjo situatë?!"***

SHEMBULL FRYMËZIMI

Asnjë nga të pranishmit kurrë më parë nuk kish dëgjuar diçka të tillë për Ratko Mlladiqin. Stevan Jovanoviqi, me diturinë e tij, midis të gjithë atyre; ishte absolutisht superiori. I jati i Ratko Mlladiqit, sipas pohimevet të Stevan Jovanoviqit, kish qenë i atillë trim, që edhe kryet e gjermanit e kish rrjepur. Kanë hyrë partizanët në fshatin Llazarevo, të banuar me gjemanë të hershëm. Të gjithë banorët gjermanë e kishin braktisur tashmë fshatin e vet dhe kishin ikur bashkë me ushtrinë gjermane drejt Gjermanisë. Vetëm 1 i vetëm gjerman kish guxuar të qëndronte në shtëpi të vet. I jati i Ratkos ka qenë, si duket, një komandir i partizanëvet. E ka pyetur gjermanin kokëfortë, përse nuk po e braktiste katundin. Ai i është përgjigjur se nuk është nacist, se nuk kishte bashkëpunuar me nacistët, përkundrazi, kish bashkëpunuar me komunistët dhe se për këtë dispononte edhe dokumentet. Por i jati i Ratkos as që ka dashur të dëgjojë. Ai i ka thënë fshatarit gjerman: ***"Të jap 1 orë kohë të qërohesh prej këndej, bashkë me krejt familjen tënde. S'e zbatove urdhërin tim, do të ta rrjep kryet në sy të fëmijëvet, të gruas dhe të 2 pleqvet."*** Kanë kaluar 60 minuta. Gjermani nuk i është nënshtruar urdhërit dhe i jati i Ratkos ia ka lidhur duart dhe këmbët dhe ia ka rrjepur kokën. E kanë varrosur krejt atë familje gjermane në cep të arës, ndërsa vrasësi, i jati i Ratkos, është vendosur në atë shtëpi bashkë me familjen e vet. Aty edhe është rritur Ratko Mlladiqi.

"Përndryshe," shtoi Stevan Jovanoviqi, ***"ai, në çdo pikëpamje, meriton të merret si shembull frymëzimi prej të gjithë sërbëvet të vërtetë. Le të përmendim vetëm njërin prej shembujvet më rrugëndriçues: Zoti Mlladiq ka më se 1 vit që po lufton kundër kushërinjvet të vet, vetëm e vetëm sepse ata kushërinj të tij nuk e kanë ruajtur thelbin e të qenit sërbë. Nuk është lehtë me qenë sërb. Të gjithë e dime, e natyrisht edhe ju e dini shumë mirë, që midis myslimanëvet të Bosnjës ka shumë kushërinj të Mlladiqit. Dhe ja si ka ndodhur e gjithë ajo punë! Një paraardhës i hershëm i Mlladiqit kish pasë pasur 2 vëllezër më të mëdhenj. Ai kish pasë qenë më i riu. 2 vëllezërit e tij kishin pasë shkuar me turqit. Kur ishin kthyer, qenë bërë turq. Si turkoshakë, kishin fituar edhe çifliqe dhe tituj agallarësh. Vëllai më i vogël, ky paraardhës i Mlladiqit, ka mbetur raja, por i krishterë. Në ato kohë nuk ka qenë e lehtë të ishe i krishterë. Janë shumuar edhe njërët edhe tjerët. Kanë ardhur kohë të tjera. Mlladiqët e krishterë nuk janë çliruar kurrë prej mllefit ndaj bashkëkrahinasvet të të njëjtit gjak. Dhe tash, siç po shohim të gjithë, njëri prej pasardhësvet më të lavdishëm të atij vëllait më të ri të krishterë, pas jo më pak se 530 vjetësh, ia ka arritur të marrë kallash e mitraloz dhe t'i korrë me plumba ata kushërinj të padenjë. Atëherë s'ish lehtë të ishe i krishterë, tash s'është lejhtë të jesh mysliman."***

Papritur fytyra e Stevanit sikur u fry. U skuq dhe u mavijos. U duk sikur do të brofte në këmbë dhe të nisej për diku. Por i ndjeu duart e 2 milicëvet mbi supet e vet dhe u qetësua. ***„Të vrasësh dikënd!“*** Tha me zë fare të ulët. ***„Njeriu është i detyruar të vrasë. Nëse Arkani nuk do të kish të tjerë për të vrarë, ai do të vriste Cecën e tij!“*** Ristoja ia vuri me shpejtësi letrat përpara, që t'i nënshkruante, dhe dha urdhër ta largonin. Milicët e tërhoqën gati zvarrë deri te ashensori.

DEBATE RASTI

Gjatë ditës, në faqet e fejzbukut, u shfaq një pyetje provokative: A ka vrarë Stevan Jovanoviqi njerëz apo shqiptarë?! Ish marrë vesh që zonja Vidosava Kërrstiq-Jovanoviq e ka kryer tashmë funeralin e 3 kufomave. Kortezhi madje kish qenë goxha i gjatë. Zonja Vidosava Kërrstiq-Jovanoviq kish mbajtur, biles, një fjalim sipër gropavet të atyre kufomave. Si kish mundur të ndodhë diçkla e tillë?!

E gjithë kjo duhet të ketë ndodhur si rezultat i ndonjë ngatërrese tragji-komike. Njerëzit s'e kanë të qartë a ka vrarë Prof.Dr.Stevan Jovanoviqi 3 shqiptarë, apo ka vrarë 3 njerëz. Gjithsesi, jemi të detyruar ta nxjerrim një përfundim, të pranueshëm prej të gjithëvet: Asnjë banori të Beogradit nuk i kish hije të merrte pjesë në një të atillë funeral të dyshimtë. Zonja Vidosava Jovanoviq, e lindur Kërrstiq, ka bërë gabim dhe nuk dihet përse dhe si e bëri atë gabim të rëndë. Pjesëmarrësit në atë funeral kanë gabuar edhe më rëndë.

Në të kundërt të këtij deklarimi, krejt ndryshe, në fejzbuk ishte bërë, aq më tepër në gjuhën sërbe, ashpër dhe krejt papritur, kjo pyetje: ***„Pjesëtarët e kombit sërb, ata që gjatë gjithë shekullit XX kanë asgjësuar shqiptarë anembanë Shqipërisë, filluar nga Nishi në Manastir, a kanë qenë njerëz apo bisha?! A mund të konsiderohen njerëz të atillë vrasës?! Është koha dhe detyra e secilit sërb të kthjellët të shprehet qartë: A ka marrë pjesë apo jo gjyshi i tij apo i jati në plojat kundër shqiptarëvet?!“***

„Gjithsesi, të gjithë sërbët e brezit të ri dhe sërbët mendërisht të shëndoshë, janë thirrur ta përcaktojnë njëherë e mirë pozicionin e tyre humanist të palëkundshëm!“ (Shkruhej kështu në gjuhën e pastër sërbe.) ***„Duke marrë parasysh që shumica e sërbëvet, kush më pak e kush më shumë, qoftë me vetëdije, qoftë pa vetëdije, ka marrë pjesë në vrasjen, plaçkitjen dhe masakrimin e banorëvet në territoret fqinjë me ne, do të dilte që krejt kombi ynë është një komb jonjerëzor. Ne duhet pa tjetër ta rishikojmë të kaluarën tonë.“***

DHE GRINDJE

Risto Kilibardës nuk i kishte ndodhur kurrë më parë të ndjehej inferior para të akuzuarit. Dihet përgjithësisht që kjo gjë, në profesionin e një hetuesi, as metodikisht nuk lejohet. Njeriu në përgjithësi, por veçanërisht një hetues, nëse dëshiron të ketë sukses, duhet të jetë superior në punën që kryen. Ristoja, edhe nga natyra, ishte një njeri krenar para të tjerëvet (përveç ndoshta para Darinkës, para gruas, të cilën edhe tani e donte pa mëdyshje).

Por këtë herë, në çështjen e Stavan Jovanoviqit, nuk po ndjehej i tillë. Diçka ishte thyer. Diçka nuk po shkonte natyrshëm. Vazhdimisht ndjehej i nervozuar. Në ditët e para kish menduar se këtë gjendje shpirtërore e kish nga të ftohurit. Ishte i ftohur, ndjehej i rraskapitur. Por, me kalimin e kohës, gjithnjë e më qartë po e kuptonte që s'ish vetëm ftohja.

Çdo gjë po e bezdiste. Deri edhe pamja e milicëvet e shqetësonte. Mënyra e tyre e të qëndruarit më këmbë gjatë hetimevet. Mënyra se si Borka Smilaniq e kryente punën e vet, bisedat e kolegut të tij Momo Gërnçareviqit, çdo gjë i dukej e jashtënatyrshme.

Kish disa ditë që po priste raportin zyrtar mbi gjendjen e përgjithshme shëndetësore të të paditurit, por Prof.Dr.Velko Velimiroviqi po e vononte. Velkoja rregullisht e përcaktonte ilaçin, sasinë, kohën dhe mënyrën e të përdorurit, por me shkrim nuk kish lënë asgjë. I pat telefonuar para 3 ditëve. Ishte i zënë me punë tjetër. I kish telefonuar të nesërmen. Prapë një pengesë tjetër. Më në fund erdhi, por disi me ngut, si kalimthi. ***"Jam nisur për një punë më të rëndësishme dhe u ktheva vetëm për pak. " "Ke detyrë zyrtare që jesh i pranishëm!"*** Tha Ristoja. ***"Shih, pash Zotin!"*** Iu kthye doktor Velkoja. ***"Mos je ti njeriu që m'i përcakton mua detyrat zyrtare?!"***

Ai dialog qe i mjaftueshëm, që midis tyre përgjithmonë të ndërpritej çdo marrëdhënie e përzemërt. Ristoja bëri një shëtitje nëpër zyrë. I kaloi në heshtje ndoshta 1 apo 2 minuta, që, në një zyrë të mbyllur, kthehen në 1 shekull pritje, pastaj ndërhyri energjikisht: ***"Mua më duhet, pa kurrfarë vonimi, raporti yt mbi gjendjen shëndetësore të të padidurit. Diagnoza, epikriza dhe të tjera." "Nuk do ta kesh!"*** Iu përgjegj Velkoja. ***"Pse?!" "Sepse unë i di detyrat e mia dhe nuk lejoj të m'i diktojë dikush."*** Ristoja befas iu drejtua sekretares: ***"Borka, të lutem, shkruaji të gjitha këto që u thanë dhe bashkëgjiti në dosje!"***

Në fytyrën e Velkos u duk një shprehje alarmi. Njëkohshëm, edhe një lloj mllefi. Thjeshtë u nxi në fytyrë. U përpoq të thotë diçka, por i mungonin fjalët.

"Jo unë…" Tha Ristoja me një ton mjaft të zjarrtë. ***"Jo unë, si një hetues shumëvjeçar mjaft profesional, por cilido njeri me arsye të shëndoshë, e ka të***

qartë që ai vrasës, me emrin Stevan Jovanoviq, është mendrisht i çrregulluar. Por duhet një vërtetim i shkruar, prej mjekut. Përse do ta vononte një dokument të tillë një i ngarkuar ligjërisht me këtë punë?!" "Sepse ti i shtrembëron me qëllim vlerësimet, zoti Kilibarda!" I gjeti më në fund Velko Velimiroviqi shprehjet e duhura. ***"I padituri Stevan Jovanoviq, në të vërtetë, nuk është mendrisht i çrreguluar. Ai është i revoltuar, ai është i mbushur me mllef, madje është i tërbuar, por kurrsesi nuk mund të diagnostikohet si një pacient mentalisht i çekuilibruar."***

Ristoja nuk e kundërshtoi qëllimisht. Heshti, që t'i jepte mundësi kundërshtarit për t'u shprehur deri në fund. Ish vërtet e pakuptueshme që, një psikiatër specialist, i pranuar si i tillë në shkallë shtetërore, të shprehej në mënyrë aq joprofesionale. Aq më tepër që pikërisht ky mjek po përdorte te ky pacient ilaçe që përdoren për të çmendur. Ilaçe që përdoren vetëm në spitalet e të çmendurvet. ***„Nuk është për t'u çuditur,"*** vazhdoi Velkoja dukshëm me cinizëm, ***"që jo psikika e Stevanit, por e jotja, është e paaftë t'i kuptojë disa zhvillime në tokën e Sërbisë. Në tokën që e ka emrin Sërbi!"***

Durimi i Ristos në atë çast ishte sosur i tëri. U detyrua ta detyrojë veten që mos përdorte ndonjë ndërhyrje fizike. Pas fjalësh të atilla, nuk do t'i mbetej tjetër, përveç qërimit të hesapevet me grushta e me shqelma. Velkoja, siç duket, e pikasi tensionin e lartë, prandaj me të shpejtë e uli tonin e të folurit: ***"I dashuri im, na duhet të sillemi me kujdes ndaj njerëzvet me pranga. Stevan Jovanoviqin e ka shtyrë një brengë e madhe në atë akt, të themi, të dëshpëruar. Ne po përpiqemi të rikthejmë në Kosmet suzerenitetin e Sërbisë, kurse shqiptarët atje po shumohen dita-ditës. Ne i asgjësojmë, ata sikur mbijnë prej toket, në numër edhe më të madh. Stevani e ka përjetuar shumë rëndë këtë relitet tonin dhe, me vetëdije të plotë, i është vënë kërkimit të një rrugëdaljeje. Në fillim të shekullit XVIII në Mal të Zi rrugëdalja e vetme ishte: asgjësimi, vrasja, ose dëbimi edhe i të turqizuarvet të vet. Vetë prijësi fetar malazias , Shën Vladikë Danilloja, siç e di edhe ti, i ka dhënë bekimin një ndërmarrjeje vërtet të përgjakshme, por shpëtimprurëse. Stevan Jovanoviqi pikërisht asaj rruge ka shkuar. Përse do ta cilësonim si të çmendur?!. E tash, mirupafshim! Mos kërko privilegje të pajustifikueshëm!"***

Velkoja, me një buzëqeshje të butë në fytyrë, e hapi derën dhe e mbylli menjëherë pas vetes. Ristoja iu drejtua Borkës: ***"Të shoh çfarë ke shkruar!"***

SËRBËVET, Ç'U MBETET TJETËR?!

"Njeriu, thjeshtë nuk di se ç'ndodh përrreth tij." Vërejti Momo Gërnçareviqi në mes të një atmosfere të qetë pune.

Ristoja e ndërpreu të lexuarit. Borka pushoi së rregulluari letrat e veta. Biseda u zhvillua rreth mënyravet se si njerëzit e shpjegonin gjestin e Stevaj Jovanoviqit. Në shtypin beogradas nuk shkruhej pothuaj asgjë për atë ngjarje. Kjo kish ndihmuar që as jashtë Sërbisë të mos përhapej senzacioni. Por, nëndheshëm, siç thuhet zakonisht, pra, poshtë dheut, në subkoshiencën e opinionit, tensioni ish i ndijshëm. Në të vërtetë, mbitokësorja, siç do të shprehej Momoja, ajo qiellorja, satelitorja që ish e ngjashme me nëntokësoren, e kish shkaktuar tensionin.

Ç'kish ndodhur, në të vërtetë?! A ka aty ndonjë thyerje, ndonjë kthesë epokale në kuptimin së pari social, pastaj dhe nacional, apo akti i Stevan Jovanoviqit ishte një akt i një krimineli të rendomtë?!

Pas kallëzimit të kolegut të Ristos, Momo Gërnçareviqit, një pronocim i mbrëmshëm në rrjetin social titullohej: ***„Sërbëvet, ç'u ka mbetur tjetër?!"*** Sipas autorit të këtij pronocimi, çdo gjë që Sërbia ka bërë deri tash kundër popujvet që e rrethojnë, kundër kroatëvet, kundër hungarezëvet të Vojvodinës, kundër shqiptarëvet, kundër boshnjakëvet, por edhe kundër vllehëvet (sado që këta të fundit i janë nënshtruar asimilimit thuajse pa rezistencë), çon te përfundimi logjik që Sërbisë, në këta vite kalimi në shekullin e ri, nuk i ka mbetur asgjë tjetër, përveç **TË FILLOJË ASGJËSIMIN E VETËVETES**. Në qoftë se Sërbisë nuk i pëlqejnë kroatët, hungarezët, shqiptarët, myslimanët e Bosnjë-Sanxhakut dhe vllehtë, atëherë si mund t'i pëlqejnë asaj vllehtë e sërbizuar, shqiptarët e sërbizuar, hebrenjtë e sërbizuar apo myslimanët e kthyer në fenë pravosllave?! Kur Sërbisë nuk i pëlqejnë malazezët e mirëfilltë, si do t'i pëlqejnë asaj shqiptarët e shndërruar në malazezë?! E vetmja rrugëdalje do të ishte: Ose t'ia ndalosh gjithkujt njohjen e prejardhjes së vet, ose të fillosh fushatë persekutimesh edhe ndaj të huajvet të sërbizuar. Të fillosh fushatë kundër të gjithë të huajvet të sërbizuar, do të thotë, as më pak e as më shumë, por të fillosh asgjësimin e vetë Sërbisë.

Stavan Jovanoviqi, tashmë, e ka nisur praktikisht këtë epokë të re të një Sërbie ultramoderne.

„Vërtet," tha Borka, ***„ç'na ka mbetur tjetër?!"*** Edhe Momoja, edhe Ristoja i kthyen sytë dhe e panë me habi bashkëbiseduesen.

DETYRIMISHT

Cvetko Kilibardës ia prenë rrugën papritur 2 djem të rinj. Nuk i njihte. Ishin dukshëm muskulozë, me supe të gjërë. Me shikim te mprehtë dhe kërcënues. ***"Ej, shqiptar!"*** E thirri njëri. ***"Unë shqiptar?!"*** Pyeti i habitur Cvetkoja. Tjetri ia vuri 2 gishta nën mjekërr. Cvetkoja ia largoi dorën me rrëmbim. Djaloshi provokues nuk e përsëriti gjestin e poshtërimit, por e kërcënoi me një zë gati pëshpëritës: ***"Nuk ka***

rëndësi se çfarë mendon ti për vete. Ka rëndësi çfarë mendojnë të tjerët për ty." "E tash dëgjo!" Iu avit tjetri. ***"Do t'i thuash tëteti që detyrimisht, pa vonesë, ta lirojë Stevan Jovanoviqin!" "Unë nuk përzihem në punët e tija."*** Tha Cvetkoja. Po rata ia kishin kthyer shpinën. U zhdukën midis kalimtarëvet. Cvetko Kilibarda ndjeu një valë të nxehti nëpër trup. Ishin që të 2 të fuqishëm si qetë. Do të kishin mundur ta zdëpnin në mes të rrugës. Do të kishin mundur ta vrisnin, ta zhvishnin lakuriq. Ç'mund të bëjë njeriu, kur është aq i pambrojtur?!

Kur u kthye Ristoja nga puna, e gjeti me libër ndër duar. U çudit. Djali i tij nuk e kish qejf të lexuarit. Ai gjithë kohën e kalonte duke luajtur në kompjuter ose duke ***„shfletuar"*** kompjuterin. ***"Shfletonte"*** filma pa numër… Të tillë e njihte Ristoja të birin.

Duke gjykuar nga kjo, nga mënyra se si e mbushte Cvetkoja jetën e vet, Ristoja ishte tepër i brengosur për të ardhshmen e tij. Ishte i brengosur, por ç'mund të bënte?! Më në fund, një natë, krejt papritur, krejt pa kujtuar, Cvetkoja, për herë të parë me një libër në dorë! Për herë të parë me një libër në dorë, ndoshta që nga klasa e pestë e shkollës fillore dhe, për herë të parë, ndoshta pas 7 apo 8 vjetëvet, e përshëndeti atin e vet me ***„Mirëmbrëma, tatë!"***

Darinka, si gjithmonë në dhjetëvjetëshin e fundit, ishte e zymtë dhe e ftohtë. Gjysh Miquni po heshtte.

Cvetkoja nuk i tha asgjë Ristos për ngjarjen me djemtë e panjohur, kurse Ristoja, nga ana e vet, ndjeu një lehtësi të pashpjegueshme. Djali i tij, atë natë, ishte ndryshe. I ndoqi lajmet bashkë me prindët, hëngri darkë bashkë me ta, pastaj kaloi në dhomën e vet dhe e vazhdoi leximin. Nuk po lexonte dispenca fakulteti. Po lexonte diçka tjetër. Diçka për kulturë të përgjithshme. Kjo ish disafish inkurajuese për Riston.

POLITIKA MË E MENÇUR

Etiketimin e malazezëvet si ***„shqiptarë"***, që në të vërtetë vinte nga paraqitja e beftë e Stevan Jovanoviqit, dikush e quajti politikë të çmendur. Pikërisht tash, kur më shumë se kurrë na duhet shkuarja mirë midis sërbëvet dhe malazezëvet, po bëhet zhurmë e po ngrihet tym mbi njëfarë prejardhjeje shqiptare të sajuar, të shpikur. Në Beograd dhe në Novi Sad rrojnë me mijëra malazezë. Befas është futur si një erë, si një stuhi, thashethemi sikur shumë prej këtyre malazezëve kanë një përbërje gjenetike ndryshe nga sërbët. Është krijuar një gjendje e papërcaktuar që i mban njerëzit pezull. Një gjendje jo vetëm e papërcaktuar, por edhe e rrëzikshme, sepse kjo do të mund ta çonte punën deri te përçrja, që, veç tjerash, do të thoshte që Sërbia të mbetej pa një dalje në det.

Kundër këtij mendimi ka reaguar organizara ***„Djelmoshat e Stevanit“.*** Përfaqësuesit e atij grupimi, përkundrazi, këtë ndërmarrje për zbulimin e së vërtetës gjenetike e quanin si politikën më të mençur të sërbëvet të vërtetë. ***„Duke i cilësuar malazezët shqiptarë,“*** pohonin ata, ***„ne arrijmë rezultat të kundërt: Midis 2 mundësive, o shqiptar, o sërb, nuk ka në botë ndonjë malazias që do të pranonte opcionin e shqiptarësisë. Në ndërkohë, nëpër Mal të Zi po qarkullojnë pikëpamje, apo, më mirë të themi, shaka për një të quajtur shkëputje. Atëherë, ne u themi malazezëvet: 'Epo, mirë! Në mos daçi të rrini me ne, shkoni me shqiptarët! Ju edhe ashtu jeni dofarë shqiptarësh, të sërbizuar në kushesdi çfarë rrethanash.' Nuk do të ishte çudi të improvizohej, ndoshta në Tivar ose në ndonjë vend tjetër, edhe ndonjë gosti të vogël si ajo e Srebrenicës. Kjo është e vetmja mënyrë që ta arrijmë atë që dëshirojmë.”***

NA DUHET TË JETOJMË

Momo Gërnçareviqi i nxori mbi tavolinë 2 shishe me verë dhe nga një copë të madhe salami dhe djathi kaçkavall. I mori 3 gota, i mbushi dhe i vendosi para Ristos, para Borkës dhe para vetes. ***“Gëzuar!” “Me çfarë rasti?”*** E pyeti Ristoja. ***“Fitova një dhuratë.”*** Sqaroi Momoja në stilin më të shkurtë të mundshëm. Por s'kish shumë nevojë për të bërë sqarime. Ristoja e dinte se si taktizonte Momoja me keqbërësit. Ai i gjurmonte me ndihmën e agjentëvet, i zbulonte dhe i linte ta çonin veten deri në prag të burgosjes. Në atë çast, keqbërësit, që t'u shmangeshin prangav et, ofrojnë ryshfete, që me fjalë të tjera, do të thotë: Ofrojnë ndarjen e plaçkës me nëpunësit e shtetit. Momoja me siguri do t'i ketë zbuluar shpërthyesit e asaj shitoreje, i ka kërcënuar dhe e ka fituar ***“dhuratën”.***

Sallami ishte i shijshëm, vera, e përkryer! Hanin dhe pinin në heshtje. Secili mendonte në mënyrën e vet. Borka dukej se nuk po i hynte thellë thelbit të çështjes. Ristoja s'e kish bërë, as nuk do ta bënte kurrë atë punë. Por as nuk do t'i lejonte vetes që të ekspozohet si një ruajtës i moralit. Megjithatë nuk mundi ta kalojë në heshtje gjithë kohën, sepse as kjo nuk i shkonte karakterit të tij. Kur e çoi afër fundit gotën e vet, ai e ngriti lart dhe tha: ***„Epo. Le të na rrojnë dyqanthyerësit!“*** Borka qeshi me zë. Buzëqeshi edhe Momoja, shumë hapur dhe pa djallëzi. E çuan afër të mbaruarit edhe mezen. Borka i mlodhi qelqet dhe mbështjellëset. Gotat i lau dhe i vuri në sirtarin e raftit. Shishen dhe ambalazhet i shtiu në 2 qese të zeza dhe i vuri në shportën e mbeturinavet. Momoja e mbylli krejt atë punë me një kombinim të përshtatshëm filozofik. ***“Duhet të jetojmë, por duhet edhe të kënaqemi në jetë.”***

EDHE YTATË I KA VRARË KUSHËRINJTË E VET

Në orën 10 e sollën Stevan Jovanoviqin. Kockat e tëmthavet i kish dukshëm të fryra. Veçanërisht binin në sy skajet e vetullavet. Ristoja ia dha tekstin e printuar me titull ***„Fondet e Arkivit të Stevanit".*** Stevani e shfletoi me gjakftohtësi atë tufë letrash A4 e vuri mbi gjunjë dhe priti. Ristoja e pyeti nëse kish lidhje me të ajo lëndë e printuar. ***„Natyrisht."*** U përgjegj Stevani. ***„Kjo është puna ime. Në dosjet e arkivit tim ju mund t'i gjeni të gjitha të dhënat se si ne sërbët e kemi vënë në jetë strategjinë e spastrimit të trevavet tona jugore. Që të mund të dalim në brtegdet, ne jemi të detyruar që ta hapim rrugën tonë. Ke parë si hapet rruga përmes një pylli, duke prerë drurët? Kur, në vend të drurëvet ka njerëz, duhen prerë kokat e njerëzvet."***

Nëse Ristoja do t'ia lejonte, ai do të fliste gjithë ditën pa pushuar. Stevani i takonte atij lloji të pandehurish, të cilët në vend të heshtjes zgjedhin llomotitjen e pafundme, deri sa hetuesi t'u bëjë pyetjen tjetër. ***"Kush jua dërgonte ata raporte, ata njoftime nga terreni?"*** E pyeti Ristoja. Stevani e shikoi me një farë, si të thuash, habie të pazakonshme. ***'A thua vërtet nuk e di ky njeri kush ia dërgon shtetit sërb rapotet zyrtarë?'*** Heshti vetëm pak sekonda, pastaj filloi si përherë, rrjedhshëm, qartë dhe bindshëm: ***"Beogradi është plot e përplot me dëshmitarë të atyre ngjarjeve. Vetëm një pjesë e vogël e beogradasvet të sotëm nuk ka marrë pjesë në ato ekspedita të mbuluara me lavdi. Pensionistët tanë, duke ndenjur nëpër parqe midis lulevet, ditë për ditë i kallëzojnë e rikallëzojnë këta episode të pafund, që këtu janë hedhur me shpejtësi e me ngut."*** Kur e shqiptoi fjalën ***"këtu"***, ai e çoi pak përpjetë tufën e letravet, që Ristoja e të tjerët ta kishin më të qartë. ***"Këtu nuk ke as 0,2 për qind të lëndës që unë e disponoj në Arkivin e Akademisë Sërbe të Shkencavet e Artevet. Njerëzit tanë, sot shumica pensionistë, kanë marrë në kohën e vet dekorata, medalje trimërie dhe lavdërime pa fund në lidhje me trimëritë dhe veprat e tyre heroike të pakundshoqe. Shumica prej atyre atdhedashësve të merituar nuk kanë lindur në Beograd, por u janë dhënë këtu punë dhe banesë pikërisht për meritat e tyre poshtë në terren, të përshkruara fare shkurt në këto pak letra. Kush i ka vrarë më pa kursim shqiptarët, ai ka gëzuar këtu në Beograd më shumë privilegje. Sot në kryeqytetin tone, shumica e nëpunësvet ose kanë marrë pjesë vetë në këta aksione,"*** (Ai përsëri e çoi përpjetë tufën e letravet të printuara, sikur donte t'i peshonte edhe njëherë.) ***"ose prindët e tyre kanë qenë aktorë dhe autorë të drejtpërdejtë të atyre aksioneve."***

Ristoja e kaloi nëpër mendje frazën e mbrëmshme të lexuar në internet: ***„Vrasësit e shqiptarëvet, a ishin njerëz apo bisha?!"*** Pastaj shtoi pa vetëdije, gjithashtu brenda vetes: ***"Banorët e sotëm të Beogradit, pasardhës të shqiptarvrasësvet, sip o e frymëzojnë vetëveten?! Me humanizëm apo me të kundërtën e humanizmit?!"***

"Mjaft!" E ndërpreu Ristoja Stevanin me zë të lartë. Me zë më shumë se të lartë. ***"Domethënë, ti pranon se je marrë me të këtilla punë në atë të quajturin Arkiv!" "Vetëkuptohet që atje kam punuar. Më ka punësuar shteti. Gjëja e vetme që këtu nuk kuptohet, që është kundër çdo gjëje që ka ndodhur dhe ndodh në shtetin tonë, është që ata, të cilët kanë vrarë shqiptarë dhjetëfish më shumë se unë, kanë marrë medalje trimërie, ndërsa unë vuaj në një qeli burgu. Kjo është e padrejtë! Kjo vërtet është e padrejtë!" "Por ti ke asgjësuar familjen tënde!"*** Bërtiti Ristoja. ***"Edhe ytatë ka vrarë kushrinjtë e vet!"*** Ia ktheu i pandehuri me të njëjtën latësi zëri. ***"Për tëtatë, për shkun Miqun Kilibarda, kapiten i klasit të parë, kam në Arkivin tim një informacion të zgjëruar."*** Ristoja nuk po mund ta ndërpriste, sepse aty ishin të pranishëm kolegët e tij, Prof.Dr.Velko Velimiroviqi, milicët, sekretarja… Stevani në ndërkohë po vazhdonte, si një rubinet i hapur uji: ***"Ytatë së pari ka luftuar, në të vërtetë, ka masakruar shqiptarë në anët e Plavës. Ka vrarë aty kushërinjtë e vet të një gjaku. Pastaj, me porosi të posaçme të Svetozar Vukmanoviqit, është transferuar në Korpusin e Shkup-Vardarit dhe atje e ka vazhduar të njëjtën punë, asgjësimin e shqiptarëvet. Ka fituar dekoratat përkatëse, ka përfituar një punë prej të privilegjuari dhe një banesë në mes të Beogradit. Kurse ti më shitesh sikur krejt këto nuk m'i ditke. Ytatë ka vepruar si një shqiptar i ndershëm dhe ka marrë atë që ndershmerisht i ka takuar. Ti, ndërkaq, po vepron sikur je anëtar i partisë separatiste të Ibrahim Rugovës. Do të marrësh edhe ti atë që takon." "Mirë!"*** Tha prerazi Ristoja. ***"Nënshkruaj këtu! Ke të drejtë ta lexosh para se të nënshkruash."***

I BIRI I KËNGËTARIT

Doktor V.Velimiroviq u përshëndet ftohtë me Riston e me të tjerët, dhe shkoi. Gjatë seancës ai nuk pat folur asnjë fjalë. Ish i zbehtë si një rubë. Megjithatë, asnjëri prej të pranishmëvet nuk tha asgjë. Velkoja ishte vetë mjek dhe mund të kujdesej vetë për vete. Por, sapo Velkoja doli, Momoja nxitoi t'u rrëfejë Ristos dhe Borkës njërin prej senzacionevet më të fundit: ***"Kemi gjëra të reja lidhur me doktorin tonë."***

Zonja Velimiroviq, bashkëshortja e Velkos, thuhet se para 20 vjetësh paska pasur lidhje intime me një shqiptar. Ka qenë këngëtari i njohur, Lulgjuraj, nga Malësia e Madhe. Ndërsa Velkoja po merrej me kërkime në fushën e kimisë, ajo ka bërë dashuri krejt normalisht me këngëtarin. Në atë kohë askush nuk shqetësohej nga një e tillë aventurë dashurore, sepse ashtu veprohej gjithandej anembanë Beogradit. Çifti bashkëshortor Velimiroviq kishin një fëmijë, Stanishën. Ai binte në sy si një djalosh veçanërisht i hijshëm dhe kish talent të veçantë për muzikën. Ishte student në fakultetin e muzikës, ishte virtuoz në disa instrumente dhe bënte pjesë

rregullisht në formacionin e Filarmonisë së Beogradit. Velko Velimiroviqi e donte djalin e vet mbi çdo gjë në botë.

Por, me formimin e të fundit shoqëri të ekstremistëvet nacionalistë me emrin ***"Djelmoshat e Stevanit"***, në pajtim me programin e tyre, në procesin e verifikimit të prejardhjes së secilit sërb, papritur ka lindur një dyshim: Ç'ne një bir mjeku e kimisti të jetë i talentuar për muzikë?! Si mbështetje për këtë, gjithsesi, dyshim të pabazuar, ka shërbyer edhe pamja e jashtme e Stanisha Velimiroviqit. Ai nuk ishte si i jati me pamje të verdhë të zbehtë, por ishte i zeshkët dhe shumë tërheqës në shoqëri. Ishte kariznatik, siç do të thuhej ndryshe. Lulgjuraj tani jetonte në SHBA. Është marrë një kampion i gjakut të tij dhe është çuar në laborator. I njëjti veprim është kryer edhe me gjakun e Stanisha Velimiroviqit. Analizat gjenetike kanë dëshmuar parrëzueshëm që ati i vërtetë i Stanishës nuk ishte Prof.Dr.Velko Velimiroviqi, por shqiptari nga Malësia, llagapi i të cilit ishte Lulgjuraj. Nëna, vetëkuptohet, ishte zonja Velimiroviq. Lajmi është përhapur rrufeshëm në krejt Beogradin.

Mund të përfytyrohet sa e rëndë është kjo ngjarje për doktor Velkon. Në një anë, ai gjithë jetën ia ka kushtuar gjetjes së mjetevet efikasë për asgjësimin e shqiptarëvet, në anën tjetër, tani dilte që mu në shtëpinë e vet e ka ushqyer, rritur, dashur, përkëdhelur, deri edhe adhuruar, një pjesëtar të po asaj race të urryer. Shpirtin e tij doemos do ta ketë mbuluar diçka shumë më e rëndë se lemeria. Ish i zbehtë si një leckë. Nuk kish thënë as edhe 1 fjalë, përveç kur është përshëndetur dhe ka dalë. Ngatërresa e tragjedisë së tij ishte madje më e komplikuar se ajo e stevan Jovanoviqit, sepse këtu kish të bënte edhe me tradhti bashkëshortore. Si do ta shikonte tash e tutje Velkoja gruan e vet?! Si do ta shikojë tash e tutje Velkoja djalin e vet, që realisht s'është i tiji?! Ç'do të mendonte tash Velkoja për ata mbi 7000 fëmijët shqiptarë, të cilët, prej helmevet të tij të luftës, as sot nuk janë shëruar?!

Momoja nuk e sqaroi nëse ky njoftim kish dalë në internet, apo ish thjeshtë një bisedë kafeneje. Gjithsesi, me zbulimin e internetit, krejt bota i ngjan një kafeneje sferike të stërmadhe.

BIHORASIT, NË KOPSHTET E FËMIJËVET

Papritur, Arkivin e Akademisë Sërbe të Shkencavet e Artevet e braktisën 3 pastruese. Pastruesja, e cila para ca ditësh pat pritur ekipin hetues, u është afruar e trembur 2 shoqevet të saja. Ajo u ka thënë atyre që kish parë në Arkivin e Stevanit shqiptarë të panumërt, që heshturazi dilnin nga dosjet, zbrisnin prej raftevet, rreshtoheshin njëri pas tjetrit dhe niseshin për diku. Pastruesja ish njëmijë për qind e sigurtë që i kish parë këto që po thoshte. Tmerri në fytyrën e saj ishte i

papërshkrueshëm. Pastrueset, pa u menduar më gjatë, e kanë braktisur punën dhe kanë dalë përjashta, duke iu shmangur Arkivit të Stevanit. Të nesërmen janë paraqitur te drejtori administrativ dhe kanë dhënë dorëheqjen. Kurrfarë sqarimesh, kurrfarë pohimi që, krejt ç'thoshin ato, ishin rezultat i bestytnivet të pakuptimta, nuk ua mbushën dot mendjen. Assesi nuk kishin pranuar të hiqnin dorë nga vendimi për të mos u kthyer kurrë më në atë vend pune. Në të vërtetë, që kur Stevani e pat kryer makabrin, as nëpunësit e atij Arkivi nuk hynin atje rregullisht si më parë, duke i arsyetuar mungesat në mënyra të ndyshme.

Gazetat nuk shkruanin asgjë, por lajmi u përhap në krejt qytetin. Njerëzit filluan të kenë frikë. Ecnin me kujdes, duke parë andej e këndej, që të mos u shfaqeshin diku befas shpirtrat e atyre shqiptarëve të vrarë. Shumica e banorëvet të Beogradit ishin të bindur që pastrueset i kishin parë me të vërtetë ata shpirtra. Në ekranet e vegjël të kompjuterëvet të vet, mbështetur në të dhënat e njoftimit, të emetuar në internet, njerëzit filluan të llogaritnin numrin e shqiptarëvet, të pushkatuar, të vrarë, të therur, të djegur dhe të mbytur me rrahje dhe u dukej që, nëse vërtet ata shpirtra kishin arritur të dilnin jashtë murevet të atij Arkivi, në Beograd s'kish mbetur më vend për njerëzit e gjallë. Veçanërisht në orët e natës, jo vetëm gratë dhe fëmijët, por edhe meshkujt, sidomos ata që kishin marrë pjesë vetë në masakrat, nuk para dilnin nga banesat. Dukej sikur Beogradi e kish burgosur vetëveten. Në fantazinë e njerëzvet, zhvilloheshin skena të çuditshme. Kurse pengesa më e pakapërcyeshme ishte se ata shqiptarë, të vrarë njëherë, nuk mund të vriteshin për së dyti.

Rruga ***„Nikolla Teslla"*** dallohej prej rrugëvet të tjera me qetësinë e saj ndijshëm të këndshme. Banorët e asaj pjese të qytetit pothuaj asnjëherë nuk shqetësoheshin prej të dehurvet, prej rrahjevet, prej zhurmës së motoravet. Në një largësi prej nja 500 metrash gjendeshin 2 kopshte fëmijësh. Morta e njërës prej pastrueseve të Arkivit punonte në njërin prej atyre kopshteve. Fëmijët po luanin qetësisht në hapësirën e tyre plot me lodra. Përnjëheresh, edukatores, motrës së asaj pastrueses, iu duk sikur në ato hapësira kish hyrë një numër shumë madh i fëmijësh të panjohur. Ajo u ngrit në këmbë, e tmerruar. Shikonte rreth vetes e llahatarisur. Kopshti ishte plot me të atillë fëmijë të panjohur. Ishin të veshur me grykëse të bardha, por fytyrat e tyre ishn here të përgjakura, herë të përcëlluara nga zjarret, të shkrumbuara, herë si të mbuluara me akull. Për fat, fëmijët, që po merreshin me lodrat e veta, nuk po vinin re asgjë. Edukatorja ngutshëm iu avit shoqes së vet. ***"A po sheh diçka?"*** E pyeti. ***"Çka të shikoj?" "Kopshti është plot me fëmijë të panjohur!"*** Kolegia u shtang. Pa rreth vetes. Erdhi me vrap edhe edukatorja e tretë. ***"Oh! E tmerrshme, e tmerrshme, e tmerrshme!"*** Bërtiste e para, kurse 2 të tjerat s'dinin ç'të bënin. Paritur edhe atyre iu duk sikur po shihnin diçka. ***„Janë më shumë se 1000!"*** Tha njëra, ndërsa e treta, pa qenë fare në vete, pyeti dikënd si

nëpër ajër: ***„Prej nga po vini?!“ „Po vimë prej Bihorit.“*** Ishte përgjigjja. ***„Dëgjoni! Thonë se kanë ardhur prej Bihorit!“***

Edukatoret nuk dinin ç'të bënin tjetër, veçse t'i thërrisnin fëmijët e kopshtit të vet, sa të ish e mundur pa ngutje e pa shqetësime, dhe t'i nxirrnin përjashta, pa ditur a do të mund të ktheheshin prapë në ata ambiente, tashmë të okupuar prej shpirtravet të fëmijëvet bihoras të masakruar. Të nesërmen i njëjti tmerr u përsërit edhe në kopshtin tjetër të rrugës ***„Nikolla Teslla“.***

Edukatoret e të gjithë kopshteve të Beogradit kanë mundur ta lexojnë përsëri fragmentin Ploja e Bihorit, në njoftimin e internetit me titull ***„Fondet e Arkivit të Stevanit“. Janar 1943: Fëmijë therur kryesisht me thika701. Fëmijë të pjekur në zjarin e shtëpivet të djegura 705. Fëmijë të ngrirë në përpjekje për t'u fshehur në male 447. Gra të vrara 340. Gra të masakruara 185. Gra të ngrira 266...“ „Fëmijë të therur, fëmijë të djegur, fëmijë të ngrirë“... „Fëmijë të therur, fëmijë të djegur, fëmijë ngrirë“...***

“A edhe këtë e kanë bërë?! Pyeste veten avokati Mirko Zvonar, duke u endur i vetmuar poshtë e përpjetë Kalemegdanit.

A MOS JENI JU?!

Borka, së paku siç dukej ato ditë, e kish humbur për gjithmonë ekuilibrin e vet shpirtëror.

Ecte nëpër rrugët e blinduara në akull dhe i dukej sikur secili kalimtar, më i moçëm se 50 vjeç, mund të ishte vrasësi i të paktën 1 njeriu. Ata që ishin më të rinj se 50 vjeç i dukej se po përgatiteshin për vrasjet e ardhshme, për një plojë të radhës. Shumë asish tashmë ndodheshin në të quajturit fronte lufte e, në të vërtetë, në vendet ku po zbatohej plojë mbi popullatat civile. Ploja mbi popullatat civile s'ka kurrfarë lidhjeje me fushat e betejavet. Ua ngulte sytë drejt e në fytyrë kalimtarëvet konkretë dhe i pyeste (natyrisht, jo me zë, por me një murmurimë të brendshme): ***„A mos jeni Ju?!“*** duke vlerësuar nga të mbajturit e tyre, ajo gjithnjë e më shumë po bindej që shumica e atyre kalimtarëve nuk kënaqej vetëm me nga 1 vrasje. Kur të atillë njerëz gjenden në vorbullat e gjakderdhjevet, nuk dinë çfarë bëjnë. ***„A mos jeni Ju?!“ ... „A mos keni vrarë Ju njerëz në Kosmet?!”***

E ngiste ***“Fiqon”*** e vet nëpër rrugët dhe avenytë e Beogradit. Veçanërisht në vendet ku detyrohej ta ulte shpejtësinë, shikonte herë djathtas, herë majtas. ***„A mos jeni Ju?!“*** Gravet dhe vajzavet nuk mund t'ua drejtonte të njëjtën pyetje me të njëjtën përmbajtje. Kuptohej vetëvetiu që shumica e gravet nuk kishin mundësi të merrnin pjesë direkt në asgjësimin e banorëvet të Kosmetit. Por prapë secila prej

tyre e kishte një lidhje të drejtpërdrejtë me etërit, me bashkëshortët, me bijtë, të cilët kishin therur me duart e veta kushedi sa shqiptarë. Pikërisht me këtë kuptim Borka u drejtonte edhe gravet të njëjtën pyetje: ***„Mos jeni Ju?!“ „A mos je ti ajo që ke fjetur në krevatin bashkëshortor me njërin prej atyre shqiptarvrasësve?!“ „A mos je ti ajo që i ke dhënë bekimin djalit tënd, kur është nisur për të vrarë apo kur është kthyer nga vrasjet?!“*** A mund të jenë krenare gratë beogradase kur lexojnë ***„Fondet e Arkivit të Stevanit“*** ose diç të ngjashme?! Nuk po gjente dot përgjigje.

Parkoi në një vend. I duhej të kalonte 50 metra më këmbë. Një mashkull ezmer, i trashë, rreth të 60-avet, po i afrohej lëshueshëm dhe me pamje guximtari, duke hapur sytë diku drejt qiellit. ***“A mos jeni Ju?!”*** Pyeti Borka Smilaniqi, këtë herë me zë. ***“Urdhëro?!”*** Reagoi me të shpejtë dhe dukshëm i trembur njeriu trashaman. ***“Më falni!”*** Tha dhe u fut brenda katërkëndëshit të burgur. Iu desh të priste 1 minut kohë përpara ashensorit. Nuk po dinte për çfarë të mendonte. Thjeshtë, nuk po mund të mendonte për asgjë.

„KAM ARDHUR TË TAKOJ VRASËSIN TIM“

E shtyu drynin në bravë. E rrotulloi 2 herë. I mshoi dorezës. Në karriken e saj ish ulur një vajzë 22-vjeçe. ***“Po Ju…si keni hyrë këtu?”*** U afrua. Tash vajza nuk po rrinte në karrike, por më këmbë pak më tutje. Qëndronte, kurse pamjen e kish të tejdukshme, si ajër. ***“Ju...“*** Tentoi Borka të fliste. ***„Kam ardhur të takoj vrasësin tim.“*** U dëgjua një përgjigje e qartë dhe e zëshme. Por pamja e vajzës tashmë kish humbur. Ishte zhdukur. Mbi tavolinë qëndronte një foto e madhe e Svetllana Jovanoviqit. E kish pasë lënë vetë Borka mbrëmjen e kaluar.

Po dridhej. Nuk po i jepej as të ikte nga zyra, as të rrinte në zyrë. Ishte jashtë vetëves. Koka po i bubullonte. Nuk po guxonte as të ulej. Hyri Momoja, i freskët sikur të ish prej bore, duke përhapur atmosferë akulli. Kuptohej që, para ardhjes, e kish pirë një gotë uiski në barin më të afërm. ***„Të ishe dashnorja ime, në vend do të të kisha puthur.”*** I tha Borkës, duke shetitur rrotull tavolinavet dhe duke ‘rregulluar’ herë njërën, herë tjetrën karrike. ***“E falenderoj Zotin që s’jam aq fatkeqe!”*** Foli Borka dhe sakaq u ndie e çliruar prej vagullimit të pakmëparshëm. U ul pranë tavolinës. Svetllana rrinte shtrirë përpara saj. ***“Si ka mundur ai njeri të vrasë një të këtillë krijesë?!”*** Pyeti Borka ndërsa te dera u shfaq edhe shefi i saj, i rëndë dhe tej mase i vrënjtur. Ajo vendosi që kurrë më nuk do të hynte vetëm në zyrë, pa qenë edhe Ristoja aty.

CIMBALEVIQ, TË LUTEM!

Kish pirë aq shumë, sa, jo vetëm gjuha, por krejt trupi, i qe bërë dru. Çohej, ecte nëpër kafe, dilte në rrugë, bërtiste. Bënte hapa të pasigurtë mbi sipërfaqen e akulluar të trotuarit, pengohej, por nuk rrëzohej. Kthehej prapë në kafe, porosiste me zë të lartë dhe prapë ecte me zikzake, duke e derdhur pijen mbi dyshemenë edhe ashtu të lagur.

"Shtatë milionë herë u kemi bërë thirrje sërbëvet dhe malazezëvet që të kthehen në Kosmet. Por ata nuk duan të shkojnë atje. Pse nuk duan?! Sepse sërbët e duan më shumë Sërbinë se Kosmetin, kurse malazezët duan Malin e Zi! Kosmeti s'është Sërbi!..Të lutem, Cimbaleviq, më thuaj sinqerisht: A është Kosmeti Sërbi?! Ti ke jetuar atje shumë vite dhe ke hequr pisërinë deri sa e ke rregulluar për të ardhur këtu në Beograd...Por dua të ma thuash sinqerisht. Me profesion je profesor. I di këto gjëra më mirë se kushdo tjetër. Të vlerësoj si një mik të vërtetë. A është Kosmeti Sërbi?!Vetëm kaq dua të di prej teje."

Largohej nga tavolina. Bënte hapa drejt derës. Edhe nëse ishin të 2 kanatet hapur, ai do të mbështetej herë në njërin, herë në tjetrin krah, gjersa më në fund do të arrinte ta kapërcente pragun. ***„Rrini këtu!" ("Ostajte ovde!")*** Do të bërtiste, pastaj do të shtonte me gjysmë murmurimë: ***"Rrini këtu, dielli i qiellit të Kosovës nuk do t'ju ngrohë si ky i yni!"*** Këtë varg të Shantiqit, të ndryshuar simbas gjendjes së shpirtit të tij, do ta përsëriste nga 10 herë, duke u lëkundur rrugës, gjer tutje në thellësi, pastaj do të kthehej sërish në kafe. Paguante para se kamerieri t'ia mbushte gotën. ***„Profesor Cimbaleviqi! Të lutem, ma sqaro: Ku gjendet Sërbia e Re? Për të Vjetrën e dimë që është atje... Atje ku nuk ka sërbë."*** Heshtte gjatë, duke rrotulluar midis gishtavet gotën gjysmë të zbrazur, pastaj do t'i drejtohej sërish Cimbaleviqit, duke shikuar, ose tavanin e pijetores, ose kalimtarët përtej perdes së madhe, që ishte e tejdukshme. ***„A ka sërbë në Sërbinë e Re?! Qe! Kjo më intereson mua... Por lahutarët thonë se edhe Shkodra pranë Bunës është i Sërbisë. Rrejnë lahutarët!"***

Më në fund do të largoheshin nga pijetorja edhe klientët e fundit. Dera e pijetores do të mbyllej. Avokati Mirko Zvonar do të gjendej në mes të rrugës. Rruga do të ish, në atë orë nate, krejt e zbrazët. ***„Rrini këtu! Dielli i qiellit të Kosovës nuk do të ju ngrohë si ky i yni!..."*** Do të rrëshqiste, rrënkonte mbyturazi, ngrihej dhe nisej prapë, tepër i pasigurtë. ***„Në të vërtetë, as këtu s'ka diell."*** Do të murmuriste dhe prapë do të provonte për të ecur.

KËRVOGRADI

Përmbi qytet po sitej një borë e hollë. Beogradi, në ditë të tilla, do të ishte vërtet një qytet mirëfilli i bardhë. Edhe ndërtesat e larta, edhe të ulëtat, edhe rrugët e ngushta, edhe të gjërat, edhe lokomotivat, edhe vagonët, edhe tramet, edhe

autobusët, si dhe veturat e panumërta, çdo gjë ish mbështjellë në të bardhë. Dhe ish më shumë se ftohtë. Shpirtravet njerëzorë nuk u kihej për kurrfarë argëtimi. Ngjante çdo gjë e ngrirë gjer në palcë.

Ngjante sikur ishin shkrirë më një, edhe bota e gjallë, edhe bota jo e gjallë. Bota e vdekur. Le të jetë qyteti i bardhë, le të jetë i gritë! Le t'i shtresohet përsipër 1 metër borë, poshtë asaj mbulese, sado të trashë, gjthsesi nuk ish e mundur t'i ndaje as t'i veçoje, shpirtrat e të gjallëvet nga shpirtrat e të vdekurvet. Fluturonin harabelat prej drurit në dru, iknin me shkathtësi ose mblidheshin në vendet ku era me borë nuk do t'i kapte. Ishin, pra, zogj krejt të përditshëm e krejt të zakonshëm. Por nuk mund të gjeje qoftë edhe 1 beogradas, të cilit të mos i shkonte mendja që, atë ditë, në ata zogj, nuk do të mund të gjendej shpirti i një njeriu të vrarë, ikur prej Arkivit të Stevanit. Ai njeri, i asgjësuar dhunshëm, ai njeri i pafajshëm, ai shqiptar që s'i kish borxh askujt, i strehuar brenda atij harabeli të vockël, me ngulm po kërkonte atë natë vrasësin e vet, nëpër rrugët të mbuluara me borë.

Vrasës! Vrasës! Pijetoret ishin plotepërplot me njerëz të veshur trashë. Porositnin nga diç të ngrohtë. Harabelat fluturonin në pjesët e sipërme të vitrinavet, atje ku era nuk e çonte dot borën dhe, me sqepthat, u binin xhamavet. Në ata çaste tejet të magjishëm të të rënit shkujdesshëm me sqep mbi xham, asnjë i pranishëm në pijetore nuk do të përmbahej pa e çuar shikimin në atë drejtim. Shpirti i ndonjë shqiptari të vrarë, strehuar fshehtas në gjoksin e atij harabeli fluturues, pa dyshim që e ka diktuar dikund asgjësuesin e vet, vrasësin e vet, dhe pikërisht prandaj ai harabel po i binte xhamit me sqep.

Do ta kish diktuar dhe do ta kish njohur vrasësin e vet, por kush do të dinte prej të pranishmëvet cili është i vrari, i fshehur në gjoksin e harabelit?! Kështu do të kuptonim edhe për cilin prej nesh është fjala. Nëse nuk e di shpirti i kujt rreh krahët prapa dritares, nuk ke mundësi të dish as se për cilin prej nesh është fjala. Disa nga klientët paguanin, ngriheshin dhe dilnin, duke çuar tinëz shikimin te harabelat. Ata thjeshtë iknin, por e dinin që s'do të gjenin vend për t'u fshehur!

Së bashku me të atilla vorbulla mendimesh, rrinte pezull në ajër, tash edhe brenda pijetores e jo vetëm përjashta, një shtangie e pashpjegueshme. Që nga tavolinat dejt tavanit ngihej një avull. Njerëzit e ndiqnin me shikime atë avull dhe u dukej sikur krejt hapësira ishte plotepërplot me shqiptarë "të Stevanit". Në asnjë pijetore njeriu nuk mund të ndihej i qetë. As në pijetore dhe as diku gjetkë. Aq sa mund të përfytyrohet një hapësirë pa ajër, aq mund të përfytyrohej ajri i Beogradit pa vektima shqiptare.

Një numër jo i vogël beogradasish njihte personalisht një ose disa nga pjesëmarrësit në ato ploja kundërshqiptare. Nuk ish vështirë t'i njihje, sepse vetë

shisnin mend. Kuptohet, ditësh të qeta e jo në ditë si këto, kaq të ftohta. Në një të këtillë të ftohtë secili përpiqej si e si të mos vihej re. Fshiheshin. Heshtnin. Por kjo nuk do të thoshte se nuk njiheshin.

Beogradasit e pafaj, ata të papërgjakurit, ndiheshin dyfish të paqetë. Ndiheshin të trishtuar, të ndrydhur. Të trishtuar dhe të ndydhur, se ishin të detyruar të duronin praninë , në ajrin e tyre, të miliona viktimave shndërruar në shpirtra dhe të trishtuar e të ndrydhur edhe sepse ishin të detyruar të duronin në mjediset e tyre edhe praninë e një mase të stërmadhe bashkëqytetarësh të përgjakur.

Këndej, sado që të shtresohej bora e bardhë sipër Bepgradit, bardhësia e saj nuk ish në gjendje t'i mbulonte vrushkujt e përgjakjes. Beogradi po bëhej përhetë e më shumë një qytet gjaku. Qytetgjak! Kërvograd!

LISTAT

Flokët e borës, në mbrëmje, kryqëzoheshin me tufëzat e dritavet. Të kryqëzuarit e dritës me vrundujt e borës, sikur sajonte ca fije letrash që fluturonin. Letra që fluturonin! Letra fluturuese të panumërta binin mbi krejt Beogradin. ***"Listat e shqiptarëvet të vrarë!"*** Tha dikush papritur.

Kjo vërejtje krejt e rastit, kjo tekë e dikujt për t'i lidhur ngjarjet e ditës me motin, gjatë natës u shndërrua në një novelë të mirëfilltë frikëpërhapëse. Mbrëmë, bashkë me borën, kanë rënë edhe listat e qindra mijë shqiptarëvet, të masakruar diku në krahinat e jugut. Ato lista paskan fluturuar prej tashmë të shumënjohurit Arkiv të Stevanit, qenkan ngritur përpjetë, lagur atje lart dhe rënë poshtë gjysmë të aklluara, duke mbuluar lemerishëm kretj sipërfaqen e Këvogradit.

Listat e shqiptarëvet të asgjësuar masivisht! Aq shumë ishin, sa që, prej tyre, është krijuar, përsipër borës, një shtresë e trashë me dëshmi krimesh. Vrasësit, të cilët në Beograd, tashmë Kërvograd, janë me mijëra, mbështilleshin me mbulesa të trasha, qepur pikërisht prej aso letrash të akulluara. Mbështilleshin, ndonëse brenda tyre mbretëronte një i ftohtë i padurueshëm.

Atyre që kalonin përpara ASSHA-së u dukej sikur ato fletëza fluturuese të panumërta ngecnin pa pushim te dritaret e saja. Akademia Sërbe e Shkencavet dhe Artevet, katërkatëshe, më saktë, pesëkatëshe dhe impozante, papritur u mbështoll me copëza letrash të varura. Dritaret e saja treshe, në formë këtëkëndëshash të tejzgjatur, u gjetën të zbukuruara me çarçafë dhe shami, në të cilat qenë renditur mijëra emra shqiptarësh të privuar jete, në të gjitha luftërat e shkuara dhe në të gjitha kohët kinse pa luftëra. Kryeveprat skulpturore, vendosur në skajet e katit të epërm, papushim po derdhnin mijëra trakte, të cilët fluturonin rreth godinës duke u

rrotulluar dhe kapeshin ku mundnin: në pjesët midis dritarevet, në ballkonet, në apsidat e 3 dritarevet të mëdha, dhe ngjanin ashtu me ca perde shfytyruese, të ngjashme me rrobat cope-copë të përbindëshavet.

Ç'po ndodhte ashtu me pamjen madhështikërkuese të asaj Akademie?! A mundet, vallë, dikush ta shpjegojë thelbin e të atillë vagullimeve, aq të furishëm, në atë mëngjes akujsh të thëllimtë?!

COPË TRURI. TRU JO I PLOTË.

Diku rreth orës 5 të mëngjesit, Akademia Sërbe e Shkencavet dhe Artevet, tmerrësisht e frikshme, ngjante me një copë të madhe truri. Zot na ruaj! Pse jo krejt truri, por vetëm një copë?! Në njërin krah Aleksandar Palas Hoteli, Kisha Katedrale, Bajrakli Xhamia, në krahun tjetër, Muzeu Popullor, Teraziet, Hotel Moska, që të gjitha ishin të mbingarkuara me borë. Të gjitha ato godina, atë mëngjes, ngjanin me diçka. Por me trurin, madje me një copë tru, me tru të copëtuar, e tillë pamje nuk mund të gjendej askund.

Shtresat e borës së ngrirë, të ngjitura, më mirë të thuhet, të kallkanosura pas murevet, ballkonevet dhe dritarevet të Akademisë (sepse ashtu i ishte tekur erës së fortë), kishin bërë që ajo krijesë artistike e konstrtuktuar me të tjerë qëllime, brenda natës kish marrë me të vërtetë pamjen e një cope truri, madje duke llogaritur aty-këtu disa të çara, ajo kish marrë pamjen e disa copave trunore. Tru i grirë. Tru i copëtuar.

Që një ndërtesë akademike t'i përngjajë trurit, kjo nuk do të habiste asnjeri. Akademia është institucion diturie. Ajo rrezaton dituri dhe mençuri, duke i shpërndarë gjithandej rreth vetes në formë librash dhe duke i çuar tek njerëzit, me ndërmjetësinë e shkollavet. Rrezet e predikimevet të saj depërtojnë, qysh prej fëmijërisë, deri te të gjitha kategoritë e shtetasvet të ardhshëm të atdheut. Rrezet e diturivet dhe mençurivet akademike depërtojnë dhe hyjnë në kokat e mësuesvet dhe mësimdhënësvet, në kokat e gazetarëvet, shkrimtarëvet dhe artistëvet, në kokat e juristëvet, në kokat e oficerëvet dhe ushtarëvet. Rrezet e diturivet dhe mençurivet akademike hyjnë jo vetëm në kokat, por edhe në zemrat e pjesëtarëvet të populli, por edhe jashtë atij populli. Mu për këtë, askush nuk do të habitej kur ndërtesa e një akademie të ngjante me një tru njeriu. Por Akademia Sërbe e Shkencavet dhe Artevet, atë mëngjes, ironikisht nuk i përngjiste një truri të shëndoshë, por I përngjiste një përbëjeje trunore të stërcopëzuar, lemerisht frikësuese.

Lumenjtë e automobilëvet rridhnin ngadalë, por pa ndërprerje, duke buruar prej prej rrugëvet anësore: të Vuk Karaxhiqit, të Gjura Jakshiqit, të Uskokëvet, të Delivet, të Car Llazarit dhe të Caricë Milicës. Njerëzit e shikonin të shtangur atë

pamje të tmerrshme rrënqethëse, por pakkush ish në gjendje që ta shpjegonte. I ngitnin makinat drejt Teatrit dhe drejt Qeverisë Republikane, derdheshin në Bulevardin e Kral Millanit. Disa dilnin në Bulevardin e Car Dushanit nëpërmjet rrugë Francuska, ndërsa të tjerë, me kahje të kundërt, ngitnin në rrugën e Brankos drejt Beogradit të Ri.

Të gjithë e ndienin që në shpirtrat e tyre diça ishte thyer pakthyeshëm. Nuk ishin mësuar me një të tillë pamje të njërit prej institucionevet më të rëndësishëm dhe njëkohësisht më të bukur të qytetit të tyre. Një tru ngjyrë hiri në të verdhë i ndarë copash! Ruajna Zot! Më në fund iu kujtua dikujt që ta krahasojë atë pamje halucinativo-fantastike me produktin e saj të vërtetë dhe të prekshëm. Natën e shkuar, siç po flitej gjithandej, krejt Beogradi ishte tejmbushur me shpirtra shqiptarësh të masakruar, kthyer papritur në lugetër. 4 breza, 4 shkallë gjeneratash të beogradasvet dhe të sërbëvet të tjerë, tashmë prej 1 shekulli e gjysmë janë marrë kryesisht me asgjësimin e populatës shqiptare. Në qoftë se truri i akademisë sonë do të kish qenë i plotë, ai tru nuk do t'i kish dhënë popullit të vet një educate të atillë të përbindshme.

PROBLEM JANË TË GJALLËT, JO TË VDEKURIT

"Kujtesa e parë.

Beogradi është plot e përplot me shqiptarë. Prof.Dr.Stevan Jovanoviqi i ka analizuar të gjitha këto me një kriter shkencor rreptësisht rigoroz. Grumbulli i parë zbulohet me një analizë fare të thjeshtë të llagapevet. Ata janë vërtet shumë më tepër se ç'do të mund t'i kishim përfytyruar deri më sot.

Zotoviq, Zogoviq, Zemiroviq,Vukshaliq, Veshoviq, Shtilanoviq, Shtekoviq, Shoshkiq, Shkundiq, Shkuletiq, Sheshlia, Sheshel, Shaliq, Prentoviq, Prentiq, Plakiq, Nushiq, Nilloviq, Nikeziq, Maleshoviq, Lumeziq, Lopiçiq, Leshoviq, Leshkoviq, Leshiq, Lesheviq, Lekoviq, Lekiq, Llaliq, Llaleviq, Krijeviq, Kreunoviq, Klajiq, Klajeviq, Kilibarda, Kaleziq, Kaleviq, Egriq, Golemadiq, Gashiq, Gjekanoviq, Gjonoviq, Gjokoviq, Gjokiq, Drekalloviq, Dediq, Çalloviq, Qosiq, Cuckiq, Burmazoviq, Buriq, Brigjanin, Bullatoviq, Balosheviq, Baloviq, Balasheviq.

Kemi të tillë shqiptarë me dhjetëra mijë. Nuk është vështirë të gjenden. 'Djelmoshat e Stevanit' kanë marrë përsipër që t'i njohin personalisht dhe një nga një.

Grumbulli i dytë do të mund të përcaktohej me shqyrtimin e tëgjitha amëzave. Na duhet t'i kalojmë nëpër duar të gjitha martesat e llagapevet të mësipërm me

qytetarët tanë joshqiptarë. Aty renditen për shembull kushërinjtë nga dajat, kushërinjtë nga tezet, kushërirat nga dajat, kushërirat nga tezet, të gjithë nipërit dhe të gjitha mbesat, të cilat kanë çfarëdo lidhjesh me Llaliqtë, Qosiqtë, Nushiqtë, Kilibardët etj. etj.

Grumbulli i tretë i kriptoshqiptarëvet, të cilët deri tash kanë jetuar midis nesh pa u penguar, nuk mund të përcaktohet në kurrnjë mënyrë tjetër, përveçse me rrugë laboratorike. Domethënë, me analizt gjenetike të AND-së. Bëhet fjalë në të vërtetë për mijëra jashtëmartesorë, si dhe gjoja brendamartesorë. Me kategorinë e jashtëmartesorëvet është më lehtë të veprohet, sepse ata ekzistojnë në lista në shtëpitë e fëmijëvet. Por me kategorinë e gjoja brendamartesorëvet, në fakt të fëmijëvet, për të cilët mendohet se u njihen etërit, nuk është fort lehtë të veprohet. Dihet ndërkohë që atin e vërtetë të cilitdo fëmijë askush nuk e njeh përveç nënës së tij. Ky grumbull kriptoshqiptarësh, gjithsesi tepër e rrëzikshme, për të cilët ne e dimë që janë me shumicë, na detyron të ndërmarrim një shqyrtim të përgjithshëm të analizavet gjenetike të të gjithë shtetasvet tanë.

Kujtesa e dytë.

Anembanë Beogradit është përhapur rrufeshëm këto ditë një përrallë absurde mbi gjoja bashkëveprimin midis shqiptarëvet të vdekur dhe atyre të gjallë. Shqiptarët e vdekur i ka sistemuar tashmë nëpër rafte Prof.Dr.Stevan Jovanoviqi në Arkivin e tij të nëndheshëm. Prof.Dr.Stevan Jovanoviqi ka gjithashtu meritën, që ka zbuluar me mijëra shqiptarë të gjallë, të cilët lëvizin lirshëm nëpër krejt Beogradin. Sërbët e Beogradit duhet ta mbledhin mendjen njëherë e mirë: Prej atyre shqiptarëve të nëndheshëm të arkivavet, sërbëvet nuk u vjen kurrfarë rrëziku. E vetmja kërkesë e jona është që ata të mos përmenden fare. Rrëziku u vjen sërbëvet prej këtyre që rrojnë midis nesh, që shtiren sikur janë sërbë dhe të cilët kërkojnë të kenë të drejta të barabarta me ne. I gjithë meraku ynë momentalisht është përqëndruar te shqiptarët e gjallë, jo te të vdekurit."

E mbaroi leximin. Nuk i tha askujt asnjë fjalë, por u ndie tepër e dërrmuar. Të gjitha këto mund të jenë të vërtetra, i tha vetëvetes.

DIÇKA MË TË MENÇUR

Riston e lajmëruan me telefon. Cvetkoja gjendej në spital. Kur doli në boulevard, makinat e policisë lëviznin poshtë e lart duke u rënë sirenavet. Nuk e pat të qartë nëse ato lëvizje kishin të bënin me ngjarjen. Deshi t'i telefononte komandirit të milicisë. E nxori celularin, por ndërroi mendje.

Cvetkoja ish i mbështjellë i tëri me fasha. Të vetmet pjesë që i dukeshin, ishin: syri i djathtë dhe goja, edhe ajo e mavijosur. ***"Duhej të kisha ushtruar karate."*** I tha ai të jatit, duke u përpjekur që ngjarjen ta kalonte me humor. Por s'ish koha për humor. Sulmuesit, e kishin dërrmuar me goditje të pamëshirshme.

Preteksti kish qenë që Stevan Jovanoviqit ende nuk i ishte hequr akuza. Cvetkon e kishin pasë porositur që këtë punë doemos ta kryente. Ky nuk e kish kryer detyrën dhe e kish marrë ***"racionin"*** e parë të shpërblimit. Për të gjitha këto Cvetkoja nuk i tha asgjë Ristos. Nuk ishte në natyrën e tij, që të rrëfente çdo hollësi, sidomos atje ku ato nuk i hynin askujt në punë. Tha vetëm kaq: ***"Më kanë rrahur si të marrë, duke më quajtur shqiptar i ndyrë. Të kisha ushtruar karate, mbase do t'i kisha mundur."*** 2 a 3 ditë më parë, Cvetkoja, në prani të Ristos, me gjysmë shakaje, i kish thënë plakut Miqun: ***"O gjysh Miquni, ty tashmë nuk të duhet revolja. A mund ta kalosh në emrin tim?"*** Ristoja vetëm tash e kuptoi që e gjithë kjo kish qenë e paralajmëruar. Erdhi mjeku. Ai e siguroi Riston që djali nuk kishte lëndime të rëndë dhe që së shpejti do të përmirësohej. Kur përsëri ngelën vetëm, Ristoja i tha me zë të ulët: ***"Revolja dhe karateja janë ana më e varfër e medaljes. A mund të shpikim diçka më të mençur?" "Do të na duhet, vërtet, të bëjmë diçka më të mençur."*** E siguroi të jatin Cvetkoja, duke i lëvizur buzët me ngathtësi.

Darinka priti deri sa Ristoja doli nga spitali dhe vetëm atëherë shkoi te Cvetkoja. Ngjante si komedi në mes të gjithë asaj ngjarjeje të rëndë, por Cvetkoja u përmbajt. Nuk tha asgjë. Bëri sikur nuk e kish vënë re atë sjellje aq të pamend të nënës. Të jetojnë në të njëjtën banesë, të ushqehen bashkë, të takohen njëri me tjetrin oreçast dhe të mos shkojnë të 2 prindët bashkë për të parë djalin e dërrmuar!? Vërtet, e gjithë kjo ngjante me komedi, përzier me njëfarë tragjedie cinike. Iu afrua krevatit. Ia preku vendet e lënduar, duke i shoqëruar veprimet me një lloj logorie: ***"Të më ishe rrëzuar me makinë, do të kisha qarë. Të më ishe bjerrë atje ku biren djemtë më të vlertë të Sërbisë, duke derdhur gjakun e të turqizuarvet, do të kisha kënduar sonte." "Nënë, të lutem! Mos u mërzit!"*** Mezi arriti të fliste, nëpërmjet buzëvet të ntrashura. Darinka i preku ato buzë me gishtat që i dridheshin. Ishin të mavijta. Edhe vetulla e djathtë, që s'ishte e mbështjellë, ish e mavijtë. Syri i majtë dhe krejt pjesa e majtë e fytyrës nuk i shiheshin. Për të gjitha këto Darinka fajsonte Riston. Ai ishte fajtor për të gjitha, prandaj edhe vuan tani ***"fëmija i saj"***. Ndenji pranë tij më shumë se 2 orë. Cvetkoja ndjehej mirë me nënën afër, prandaj dhe e zuri gjumi. Ai flinte, ajo e shikonte, pa ditur si t'ia vinte emrin krejt asaj që po ndodhte rrotull saj. Erdhi infermierja. (Cvetkoja i hapi sytë përtueshëm.) Ajo ia pa temperaturën. Kontrolloi punën e zemrës. E vendosi lart shishen me lëngje mjekues, duke i rregulluar tubat që vareshin tatëpjetë, dhe i foli Darinkës me zë qetësues: ***"Do të bëshet shumë mirë."*** Darinka u ngrit. Donte ta puthte ***"fëmijën e saj"***, por nuk kish ku ta puthte. Në vend të të puthurit, ajo i tha: ***„Po të kisha***

mundësi, nuk do ta lejoja as të vijë këtu.“ „Nënë, na duhet të shpikim diçka tjetër.“ I tha Cvetkoja.

EDHE KJO NA DUHEJ

Cvetkon e nxorën nga spitali. Rinte shtrirë në krevat i mbështjellë me fasho dhe ngjante me mumjet e Egjiptit. Darrinka rrinte pranë tij me duar të lidhura rreth gjunjëvet. Lëkundej djathtas-majtas dhe logoriste me gjysmë zëri: ***“Edhe kjo na duheeej!.. Edhe kjo na duheeej!”***

Cvetkoja e dinte çfarë nënkuptonte nëna a tij me atë fjali kushedi sa here të përsëritur: ***“Edhe kjo na duheeej!”*** Prej kur e mbante mend, ajo kish qenë më shumë se e pakënaqur, thuajse e dëshpëruar, pse Ristoja ndjehej malazias. Dëshironte që edhe ai, si bashkëshort i saji, i cili kish vite që rronte në Beograd, të fliste më në fund ekavisht. Të mos thoshte ***lijep***, por ***lep***, të mos thoshte ***svijet***, por ***svet***, të mos thoshte ***bijedan***, por ***bedan***. Sa herë që Ristoja, qoftë edhe me dialektin e vet e me asgjë tjetër, do t’i shfaqte vetitë e veta malaziase, ajo do të shqetësohej sa s’ka më. Pikërisht për ato veti malaziase të ruajtura me ngulm, Darinka ishte e patolerueshme edhe ndaj vjehrrit të vet, tashmë të tejplakurit Miqun Kilibarda. Por ishte shumë e kënaqur që të paktën i biri, Cvetkoja, nuk dallohej fare prej beogradasvet të tjerë.

Në vitet e parë Ristoja bënte shaka me të, duke shfaqur me qëllim ndonjë veti të vendrrënjës, kurse ajo i kundërvihej përherë me nervozizëm: ***“Të lutem shumë, mos më ngacmo!”*** Më vonë Ristoja nuk po e duronte dot, veçanërisht kur ajo sillej ashpër me të jatin. Të gjithë këta mosdurime sollën me kohë divorcin faktik të tyre, ndonëse ende jetonin në të njëjtën banesë.

Si një gjëmë, prej një qielli prej kohësh të ngarkuar me re të zeza, doli papriur që burri i saj nuk ishte as malazi, në kuptimin siç e kish konsideruar ajo, por njëfarë shqiptari i malazezuar, në të vërtetë i sërbizuar. Këtë risi vërtet të hidhur nuk e kish përsëritur tashmë me qindra here dhe binshëm shpjeguar vetëm ai i burgosuri i Ristos, por në një pjesë të madhe të Beogradit ishte tashmë krejt e qartë që burri i saj nuk ish as malazi, as sërb, por një lloj shqiptari i konvertuar, pra i shfytyruar. Në vendin ku ajo punonte atmosfera u bë papritur e pezullt. Koleget e saja befas i patën ndërprerë shakatë e përditshme. I dukej sikur ish e rrethuar me tela me gjemba.

Ja tani, edhe djali i saj i dashur, fëmija i saj i shtrenjtë, i pazëvendësueshmi Cvetkoja i saj, qe rrahur rëndë pikërisht se djemtë e Beogradit e konsideronin shqiptar. A ka turp më të madh?! Ka ngrënë shkopinj, jo siç ndodh zakonisht midis nxënësvet të 2 shkollave të ndryshme, midis tifozëvet të sportit, midis studentësh

provincialë dhe qytetarë, por si pjesëtar i një kombi krejt tjetër, në shekuj armik të Sërbisë. Nuk e kishin quajtur as malazi, as kroat, as gjerman, por i kishin ngjitur nofkën më të keqe të mundshme: shqiptar!

Darinka do të mund të përballonte çdo gjë, por jo këtë hata kaq të madhe! Kjo kurrsesi nuk mund të durohej! Ishte turpi më i madh i mundshëm! Nuk guxoi madje as të shkonte te puna, se do ta shigjetonin shigjetat e të gjithë syve rreth e rrotull: ***"Ka fjetur 25 vjet me një shqiptar dhe na shtirej sikur nuk e dinte!"***

Darinka i shtërngoi edhe më shumë duart rreth gjunjëvet të vet dhe rënkoi me dhimbje: ***"Edhe kjo na duhej!"***

Cvetkoja u përpoq ta hapte syrin e djathtë: ***"Nënë!"*** Darinka nuk luajti vendit. ***"Nënë, a po më dëgjon pak!" "Po të dëgjoj, o biri im!" "Ka ardhur koha që edhe ne të 2, unë edhe ti, të ndyshojmë diçka brenda nesh." "Ç'të ndyshojmë?!"*** E pyeti e ëma. ***"Nuk po di! Por po e ndiej që kemi diçka edhe ne të 2 për të ndryshuar."***

IDE GJENIALE

Momo Gërnçareviqi, si përherë, edhe të nesërmen mbas ngjarjes me Cvetko Kilibardën, ishte plot entuziazëm. Ai atë ditë kish zgjedhur të lëvdonte ***"Djelmoshat e Stevanit".*** Djem të përkryer. Të guximshëm. Operativë. Gjenerojnë ide gjeniale. Projekti i tyre kryesor ka qenë: bashkimi, deri në shkrirje, i Kishës Pravosllave Sërbe dhe i Partisë Komuniste, në vazhdim Socialiste të Sërbisë. Shkrirja më një e këtyre 2 pikëpamjeve diametralisht të kundërta, ka qenë, më një anë e pakuptueshme, e çuditshme dhe fantastike vetëm për t'u menduar, le më të realizohej, në anë tjetër, krejt e kuptueshme, aspak e çuditshme, aspak fantastike. Edhe njërët, edhe tjerët janë në radhë të pare sërbë. Ka qenë Kisha Pravosllave Sërbe ai institucion që ka mbajtur gjallë kombin sërb për më shumë se 770 vjet. Komunistët sërbë, nga ana e tyre, në thelbin e vet, gjithë jetën kanë qenë e kanë mbetur pravosllavë. Pas kësaj, aty s'kish asgjë për t'u çuditur, por prapë ideja e ***"Djelmoshavet të Stevanit"*** duhej vlerësuar si një ide gjeniale. Thelbi i marksizmit ka qenë rrënimi institucional i religjionevet.

Ideja e dytë gjeniale e ***"Djelmoshavet të Stevanit"*** ish e lidhur me gjeografinë. Sërbia e sotme, sipas tyre, është e copëzuar dhimbshëm dhe mjerueshëm. Ajo, o sot o kurrë, duhet të unifikohet dhe të forcohet në truallin e vet dhe në atdheun e saj shumëshekullor. Kufiri ynë i sotëm jugor i përkohshëm, fillon te Shën Naumi në breg të Liqenit të Ohrit. Ndërpritet, duke lënë momentalisht, qytetet e moçm sërbë, Vlorën dhe Durrësin në duart e shqiptarëvet. Por vetëm momentalisht. Sepse ata qytete, herëdo kurdo, duhet t'i kthehen Sërbisë. Pastaj, ai kufi i yni i këputur,

nga Shën Naumi duhet të lidhet me Shën Vladimirin pranë Ulqinit, të ngjitet përpjetë Adriatikut nga Ulqini në Zarë. Dubrovnikun nuk na lejohet t'ua lëmë kroatëvet. Kufiri ynë perendimor tashmë është ngulur mirë në transhetë e Bosanska Krajinës si dhe në shkëmbinjtë e Likës sonë të lënë pas dore. Ndërkaq, duke u kthyer drejt veriut, kufiri ynë mbërrin deri te Segedi dhe Temishvari. ***"Kjo është, pra, platforma e Djelmoshavet të Stevanit. Këtë ma ka rrëfyer pikërisht mbrëmë një kolegu im në 'Francuska 7'".*** U tha në fund Momo Gërnçareviqi Ristos dhe Borkës.

Ristoja e pat dëgjuar deri atëherë pa thënë asnjë fjalë. Ishte i lodhur. Natën që shkoi nuk kish fjetur as gjysmë ore. Gjithë natën e kish gdhirë pranë Cvetkos. Duke e ditur që Momoja ishte i prirur për të bërë muhabet gjithë ditën mbi idetë gjeniale e të pavdekshme të atyre të përkryerve ***"Djelmosha të Stevanit"***, Ristoja më në fund e ndërpreu: ***" O Gërmçareviq!"*** I thirri duke iu drejtuar qëllimisht me llagap. ***"A e di ti që ata të quajturit 'Djelmosha të Stevanit' mbrëmë e kanë rrahur djalin tim për vdekje?!"*** Momoja nuk dinte asgjë. Luajti rolin e të habiturit, madje u duk sikur shtangu. Ristoja e ndërroi temën e bisedës. Në zyrë u vendos qetësia dhe ata i kaluan diku 1 orë e gjysmë në një atmosferë pune, të thuash, për t'u pasur zili.

Por, kur Ristoja zbriti në laboratorin e kriminalistikës, Momoja sërish filloi të përpunojë idetë, rreth të cilavet ish biseduar 1 natë më parë te ***"Francuska 7".*** E dinte që Borka nuk do ta ndërpriste. Kish aty një varg problemesh, të cilët sërbët bashkëkohorë duhej t'i zgjidhnin në të mirë të vet. Problemi i parë ishte: të gjithë banorët pravosllavë që jetonin në territorin e Jugosllavisë, duhej të quheshin sërbë. Edhe hercegovasit pravosllavë duhet të quhen sërbë, edhe krajishnikët, edhe malazezët. Në rast se ndonjëri prej këtyre popujve do të kërkonte diç tjetër, do të ishte më rëndë për atë vetë, se sa për sërbët. Interesi i tyre është, thoshte Momoja, që ata ta quajnë veten sërbë. Problemi i dytë: shqiptarët që ende banojnë në territorin e Kosmetit, të Maqedonisë, të Malit të Zi, duhet thjeshtë të shfarosen ose të dëbohen. Tjetër rrugëdalje nuk ka. ***"Nga 1877-a e deri më sot, i kemi vrarë dhe groposur, ose përzënë pa pushim, herë në drejtim të Turqisë, herë në drejtim të Evropës, e megjithatë nuk ia kemi arritur që t'i pastrojmë ato hapësira. Tash është koha e fundit që njëherë e përgjithmonë të mbarojmë punë me ta. Le ta përfundojmë ç'na ka mbetur me kroatët, të sigurojmë një dalje të gjërë në det nga Zara deri në Ulqin, të mbytim sa të jetë e mundur më shumë boshnjakë të turqizuar, pastaj t'u kthehemi shqiptarëvet. Ja, ky është plani ynë minimal. Por ekziston edhe një plan maksimal. Hungarezët i kemi shtyrë tashmë në drejtim të veriut. Vojvodinën thuajse e kemi spastruar prej hungarezëvet. Na ka mbatur Segedi e, me kohë, do t'ia bashkëngjisim edhe atë vendit tonë. E kemi edhe***

Timishuarën. Atje njerëzit tanë po unojnë ditë e natë. Si po të duket një program i këtillë?” E pyeti Momoja Broken. ***“A s’është me të vërtetë madhështor?!”***

Borka po rrotullonte nëpër duar fotografitë e viktimavet të Stevanit. Kufoma e Predragut kish nja 10 fotografi marrë nga anë të ndyshme. Të gjitha fotografitë ishin tejet rrënqethëse. Ish aq e tmerrshme t’i shihje ato pamje, saqë Borkën e zuri frika se mos mbetej vetëm në atë zyrë. Nuk i interesonte për çfarë fliste Momoja. I interesonte vetëm të flasë dhe të mos i teket edhe atij të dalë gjëkundi.

Momoja ndërkaq vazhdoi: ***„Ka aq shumë vitalitet në përmbajtjen tonë gjenetike, sa një ditë do bëhemi kombi më i fuqishëm në Evropë.“ „A më të fuqishëm se gjermanët?!“*** Pyeti Borka. ***„S’do mend! Ne jemi qysh tash më të fortë se gjermanët, nëse merren parasysh lidhjet tona të gjakut me rusët dhe me bjellorusët.“***

O ZOTI IM!

Ristos, vetëkuptohet, nuk i pëlqente, as të kalonte, as t’i afrohej, as të rrinte në shtëpinë ku kish ndodhur krimi. Por i pëlqente të rrinte me zonjën Vidosava Kërstiq-Jovanoviq. Ajo ishte, në kuptimin e vërtetë, një grua e magjishme… I telefonoi, pastaj u nis... Milicët rrinin ende para portës së Stevan Jovanoviqit. Vidosava e priti në lulishten e vet. I tha që të parkonte brenda oborrit. ***„Vajzat kanë punët e tyre.“*** I tha. ***„Ne do të rrimë në katin përdhes.“*** Dhoma e pritjes ishte e rregulluar me shijen e zonjës së shtëpisë: ish edhe ajo e magjishme. Kolltuqet prej lëkure, ngjyrë kafe të errët, perdet poashtu ngjyrë kafe, por të çelëta dhe të tejdukshme. Mbi tavolinëzën e ulët, një tufë lulesh të freskëta. Në mure, 2 piktura të mëdha, vepra të 2 piktorëve të njohur sërbë. Përballë kolltukut, ku u ul Vidosava, ish vendosur portreti i bashkëshortit të saj të ndjerë, shenjë e qartë që i kish ndenjur besnike që nga koha e vrasjes.

Si në krejt Beogradin, në atë dimër vërtet të pazakontë, as këtu, e veçanërisht këtu, biseda nuk mund të lidhej me asnjë temë tjetër, përveçse me Stevan Jovanoviqin dhe me çdo gjë që lidhej me të. Beogradi ish mbushur plot me tregime mbi gjithfarë fanitjesh të frikshme. Vidosava tha se ishin numëruar pëmbi 70 plaka, të cilat, duke ndenjur natën në ballkone, kishin pare, perms xhamash të mbyllur, se si, nëpër rrugët e Beogradit, jo ecin, por rrjedhin kolona të pafundme shqiptarësh të përbindshëm. Flisnin e tregonin gjithandej episode të çuditshëm. Burimi i atyre lumenjve të frikshëm njerëzish të vdekur, veshur në të bardha, ishte Akademia Sërbe e Shkencavet dhe Artevet. Prej andej niseshin dhe lëviznin në të gjithë drejtimet, që, para se të gdhihej, të ktheheshin sërish në vendbanimin e tyre, në bodrumet e asaj akademie.

Kur dilnin prej podrumesh të Akademisë, shpirtrat s'kishin nevojë që t'u hapej ndonjë derë e posaçme. Ata përbiroheshin nëpër hekurat e kryqëzuar të dritarevet, ngjiteshin edhe lart në ambientet e akademisë dhe rridhnin pastaj tatëpjetë në formë ujëvarash. Nën dritën e hënës bora e bardhë dukej trefish më e bardh dhe më shkëlqyese. Varganët e shpirtravet, të kthyer në lugetër, veshur në të bardha, në mes të një të atillë bardhësie, nuk do të dalloheshin, sikur të mos kishin edhe një nuancë ngjyre të verdhë. Shumica e kokavet ishin të prera, prandaj të zotët e tyre i mbanin në duar, pikërisht ashtu siç pat vepruar Shën Gjon Pagëzuesi këtu e 2000 vjet më parë. Kish plot edhe të përcëlluar e të djegur. Eshtrat e tyre të karbonizuara trokëllinin rrënqethshëm poshtë pëlhuravet të bardha, por të pudrosura me blozë të zezë. Plagët e plumbavet ishin të mbështjella me fasho, sikur dikush donte t'i mjekonte, por në sipërfaqen e secilës fashë dukeshin njolla të freskëta gjaku.

Varganët, heraherë edhe këngëtonin disa këngë të pakuptueshme, sigurisht në gjuhën e tyre. ***"Krejt kjo i ngjan një folklori të ri."*** Përfundoi Vidosava. ***"Thonë që njerëzit nuk flënë, nuk i zë gjumi vite me radhë, në procesin e krijimit të vepravet folklorike." "Ndërkaq, po atyre njerëzve, u duken të vërteta që të gjitha."*** Tha Ristoja. ***"Por edhe është në një farë mënyre. Krejt këto lidhen me ngjarje reale dhe jashtëzakonisht tronditëse. A mund të përfytyrohet një tmerr më i tmerrshëm se ky, prej të cilit na ndajnë vetëm 40 centimetra mur?" "A e ke vështirë të jetosh në këtë shtëpi, tashmë me hije të rëndë?"*** E pyeti Ristoja papritur. ***"Shumë, shumë Vështirë!"*** Tha Vidosava.

Në orët e vona Ristoja u çua dhe shkoi në shtëpi të vet.

Që në korridor u dëgjua një si gjëmim i nëndheshëm i Miqun Kilibardës. Ristoja hyri në dhomën e të jatit me të shpejtë. Plaku lëvizte gjymtyrët nëpër ajë sipër krevatit dhe pa pushim përsëriste: ***"O Zoti im! O Zoti im!"*** Ristoja iu avit te kryet: ***"Tatë, çfarë ke?!"*** E kapi për duarsh, ia fërkoi parzmat. Miquni u ngrit përgjysmë dhe prapë tha: ***„O Zoti im!"*** U desh më shumë se 1 minut, që plaku më në fund të kthjellohej disi dhe të vinte më vete. Ishte krejt i zhytur në djersë. Edhe këmisha, edhe kanotierja, edhe ndërresat e poshtme. U zgjua edhe Cvetkoja. E ndihmuan që të ndërrohej. ***„Gjysh, a pe diçka në ëndërr?"*** E pyeti Cvetkoja . ***„Asgjë s'kam parë në ëndërr, por çdo gjë ishte më shumë se e vërtetë. Erdhën 2 shqiptarë dhe m'u sulën për të më mbytur me thonj. Ishin pikërisht 2 prej atyre që unë i kam vrarë dikur. Njërin e pata vrarë në Vuthaj. E pata lidhur te një kumbull dhe e vrava me revole. Tjetri qe përpjekur të na ikte dhe unë e kam rrëzuar me breshëri automatiku. Sonte m'u shfaqën të 2 dhe deshën të më mbytnin."*** U zgjua edhe Darinka. Doli nga dhoma e vet në fustan të natës dhe u mbështet te dera, aty ku Ristoja dhe Cvetkoja po kujdeseshin për Miqunin. ***„Ka pirë gjysmë litre raki rrushi e s'është për t'u çuditur as me kuçedrën të jetë kacafytur."*** Ristoja nuk iu

përgjigj. Cvetkoja po i rregullonte mbulesën plakut të tronditur dhe tepër të shqetësuar. Ana e majtë e kokës së cvetkos dukej si e mbuluar me hije. Këmbën e majtë e kish ende të mbështjellë me fasha.

GOTAT E VRERIT

Avokat Mirko Zvonari ishte atë natë vërtet krejt i dehur. Rrinte në të njëjtën tavolinë me Cimbaleviqin e moçëm dhe vetë pyeste, vetë përgjigjej: ***„Ti, profesor, je malazi. Ke shkuar nga Mali i Zi në Kosmet. Je zhvendosur. Ke jetuar atje, mirë ke qenë, por prapë s'të ka pëlqyer. Me 100 mundime më në fund ia ke dalë të vish këtu në Beograd. E tash po të thonë që të kthehesh në Kosovë. 7 milionë herë të kanë bërë thirrje. A mund ta përfytyrosh ç'do me thënë që dikush të të thërrasë 7 milionë herë e ti të mos i përgjigjesh? Që dikush të të trokasë në derë 7 herë dhe ta mërzit shpirtin. Jo më 7 milionë herë e të bësh sikur nuk e dëgjon!"*** Pushonte herëpas'here. E thante në çast gotën, e pinte me fund, pastaj e rrotullonte midis gishtavet si diçka enigmatike. ***„Gjithsesi unë jam i detyruar të të pyes ty: Pse nuk të thërrasin të kthehesh në Mal të Zi? 7 milionë herë të kanë thirrur të shkosh në Kosovë dhe as edhe 1 herë të vetme s'të ka thënë kush: Profesor, kthehu në Mal të Zi! Nuk e di si i kupton ti këto gjëra. Duhet të jetë këtu një filozofi e thellë. Ka malazezë e sërbë që kanë kaluar nga Franca në SHBA. Askush nuk u ka thënë atyre qoftë edhe 1 herë të vetme: Kthehuni në Francë! Nuk është krijuar kurrfarë organizate për kthimin e sërbëvet dhe malazezëvet në Francë. Shteti ynë nuk ka shpenzuar as edhe 1 dinar me qëllim kthimin e sëbëvet dhe malazezëvet në SHBA ose në Francë. Ka sërbë edhe në Hungari. Askush nuk po i thërret që të kthehen në Sërbi. Ka sërbë në Timishuarë. Askush nuk po u bën thirrje që të kthehen këtu. Vetëm ti do të mund të m'i sqaroje të gjitha këto."*** E rrëkëlleu edhe një gotë. Iu duk se kish qenë bosh dhe thirri: ***„Kamerier! Pse është e zbrazët kjo gotëza ime?!"*** Kamerieri vrapoi me shishen në dorë dhe ia mbushi. Mirko Zvonari pagoi menjëherë. Si gjithnjë. ***„Te ju malazezët ekziston një parim me shumë vlera: Njerëzi dhe trimëri (Çojstvo i junashtvo). A është trim ai që vret fëmijë? A ka thërrime njerëzie te ai malazias, i cili djeg shtëpi dhe që, brenda në ato shtëpi, i shndërron në thëngjill njerëzit e gjallë? A ke lexuar ç'thuhet në rrjetet socialë ç'krime kemi bërë ne sërbët dhe ju malazezët nëpër Shqipëri?! Të lutem, mos më fol më për njerëzi të malazezëvet! As për njerëzi, as për trimëri!"*** Kamerieri ia mbushi sërish gotën. Mirkoja e mbante midis 3 gishtave dhe e shikonte me ngulm lëngun brenda gotës. Bënte përpjekje për t'u përqëndruar. Sytë e tij tash u ngjanin llambavet elektrike. Por llamba të lagura, të veshura me mjegull: ***„Një gotë mjalti kush e piu, e s'e zhyti në gotë helmi!? (Çashu meda josh niko ne popi, shto je çshom zhuçi ne zatopi!)"*** I tha, jo Cimbaleviqit, por gotës dhe e përsëriti: ***"Një gotë mjalti kush e piu!.. Ma***

jep edhe një!.. Por jo!.. S'kam më me se të paguaj... Do të më japësh vetëm ujë. Madje nga ai i ndoturi!" Iu kthye sërish profesorit: ***„A e di ti, Cimbaleviq, që Kosova nuk është Sërbi?! Të kam pyetur disa herë. Të lutem, mos u mërzit! Ty nuk të kanë mërzitur 7 milionë thirrje që të kthehesh në Kosovë. A e dinë akademikët tanë që Kosova s'është Sërbi?! E dinë! Natyrisht që e dinë!... Atëherë, kur e dinë, sepse s'është e mundur të mos e dinë, pse nuk dalin me një deklaratë të përbashkët, me një letër të hapur, me një libër të bardhë, në të cilin t'ia sqarojnë popullit të vet, me fakte historikë, që Kosova nuk është Sërbi?!Qe, se po ta them unë! Sepse brenda tyre nuk ka asnjë fije njerëzillëku! Sepse brenda tyre nuk ka asnjë shkëndi trimërie! Akademikët tanë janë aq mizerabël, sa që prej lindjes deri në vdekje e tërheqin veten për hundësh. E di ti ç'do të thotë, ta tërheqësh veten për hundësh? Ata nuk shohin dhe nuk dëshirojnë të shohin asgjë përtej hundës së vet. Të lutem, mos më kundërshto! Kanë punësuar në ata arkivat e tyre një qytetar naiv, e kanë fryrë me disa pseudoide të vetat jo vetëm shkurtpamëse, por edhe jonjerëzore. Kanë prodhuar prej tij një kriminel latent dhe tash më bën thirrje Nëna Sërbi që ta mbroj një të atillë kriminel... O, Nëna ime, Sërbi! Ma jep një gotë helmi, t'ia thaj fundin!"*** U ngrit rrëmbimthi dhe u nis për diku. Ecte me hapa që e shtynin herë djathtas e herë majtas. Kristalet e akullit thyheshin me tërsëllimë nën këpucët e tija.

NUK KAM KOMENTE

Momoja e solli në zyrë lajmin më të ri. Para ndërtesës së filarmonisë, gazetarët i janë qepur Stanishë Velimiroviqit. Filarmonia këto ditë po përgatit një koncert. Stanisha ecte nëpër trotuar, duke mbajtur në krahë një instrument muzikor futur në kllëf. Dukej krejt i qetë, megjithse s'mund të mos e dinte ç'po flitej dhe ç'po ndodhte rrotull tij.

Nëna e tij, para 2-3 ditësh, ka kërkuar borërisht divorcin. Botërisht ka deklaruar se ati natyror i djalit të saj është Lulgjuraj, ish-këngëtari i Beogradit. Ndërsa ka thënë edhe se, mbas divorcit me burrin e saj të tashëm legjitim, Prof.Dr.Velko Velimiroviqin, do të kërkojë të emigrojë, bashkë me të birin, në SHBA, sepse atje prej vitesh rron zoti Lulgjuraj, bashkëshorti i saj i vërtetë dhe ati i vërtetë i Stanishës.

Gazetarët janë shfaqur befas. S'ka dyshim se i kishin zënë pritë, duke ditur që muzikanti i ri e kish rrugën pikërisht andej. Stanisha ka refuzuar t'i përgjigjet çfarëdo lloj pyetjeje, por gazetarët kanë qenë veçanërisht këmbëngulës. Kanë ecur bashkë me të deri te hyrja dhe kanë kërkuar të hyjnë kudo që ai të hynte.

Më në fund, Stanisha ka qenë i detyruar të lëshojë pë, por vetëm me kusht që me të shkonin 2 gazetarë, jo më shumë. Ka zgjedhur një gazetar të Beogradit dhe një të Zagrebit dhe ka hyrë bashkë me ta në ushtrimoren e vet.

„Sot ka për t'u botuar intervista e tij", tha Momoja, ***„por dihet qysh më parë se si ka reaguar."***

„Nuk kam komente", ka qenë thelbi i deklaratës së tij. „***A e pranon që nuk je djali i zotit Velko Velimiroviq?" „Nuk kam koment." „A e di që ati yt natyror është këngëtari i njohur nga Malësia?" „Nuk kam koment." Nëna jote ka kërkuar divorc." „Ajo është puna e saj." „Ajo e ka deklaruar qartë që ti je fryti i dashurisë së saj me Lulgjurajn.""Ajo prapë është puna e saj." „A do të shpërngulesh edhe ti në SHBA?" „Jo. Unë jam qytetar i Beogradit dhe do të mbetem beogradas gjithë jetën." "Nëna jote ka deklaruar se ty këtu të rrëzikohet jeta. Ka thënë se bashkëshorti i saj i deritashëm, Prof.Dr.VelkoVelimiroviqi, ka helmuar mijëra fëmijë shqiptarësh dhe se do të të helmojë edhe ty në mënyrën më mizore." "Jo!"*** Ka thënë Stanisha***. "Si, jo?!" "Nuk kam koment."***

"***Cilat janë marrëdhëniet me kujdestarin tënd të deritashëm?" "Nuk kam koment." "Por midis jush duhet të ketë ndodhur njëfarë ndryshimi pas gjithë kësaj." "Nuk kam koment, ju lutem!" "Stevan Jovanoviqi i ka vrarë edhe djalin, edhe vajzën e vet, duke e ditur që vetëm ai e jo dikush tjetër është ati i tyre. A nuk i fikohesh ti të njëjtit fat?" „Jo. Kjo s'është puna ime. Kjo është punë e të tjerëvet dhe le ta zgjidhin të tjerët. Detyra ime është të merrem me muzikë. Fundi gjithsesi do të vijë një ditë. Se kur do të vijë ai fund, kjo nuk varet qind për qind prej meje. Dhe nuk do të thosha që edhe jetët tuaja varen qind për qind prej jush."***

"Ka thënë që nuk ka komente," shtoi në fund Momoja, ***„por shihet qartë që anon nga shqiptarët. Fundja, as që do të mund të mendohej ndryshe."***

"Pra, ti mendon se nuk është e mundur të anohet edhe nga njëri, edhe nga tjetri?!" Pyeti Ristoja dhe menjëherë e qortoi veten në heshtje: ***"Ta hajë dreqi! A s'është e mundur që edhe unë të pozicionohem: pa komente?!"***

EDHE I VERBËT, EDHE I SHURDHËT

Në internet Gugëll, njëfarë Armando Bovino, nën titullin ***"Bota e verbët"***, kish perifrazuar Ernest Heminguejin. Shprehjen ***"Për kë bien kambanat?"*** e kish zëvendësuar me ***"Për kë shkrepin vetëtimat?"*** dhe ***"Për kë bubullojnë bubullimat?"*** Bota e sotme, shkruante ai, megjithëse me mundësi të jashzakonshme informacioni, mbetet gjithsesi, edhe e verbët, edhe e shurdhët. Nuk

ka sy për të parë, nuk ka veshë për të dëgjuar. I mungojnë 2 prej organevet më të domosdoshëm. Organi i shikimit dhe organi i dëgjimit. Thënë më përgjithshëm, duke mos përfshirë këtu përpjekjet individuale dhe grupore vetëmohuese, heroike e thuaj ç'të duash tjetër, konkluzioni ynë është që Njerëzimit të sotëm i mungojnë ndjenjat e njerëzishmërisë.

Kemi përpara 2 pamje, për shkak të të cilavet bota do të duhej ditë-natë të demonstronte. Pamja e parë është ajo e Bosnjës së sotme. Ç'nuk punohet atje!? Thonë që myslimanët e Bosnjës po provokojnë konflikte të armatosur. Dhe dihet që ata myslimanë të Bosnjës s'e kanë as në cep të mendjes për të bërë luftë me sërbët. Sërbët dhe malazezët i vrasin ata njerëz pa kurrfarë provokimi. I vetmi shkak i atyre vrasjeve është përkatësia fetare. Malazezët dhe sërbët i takojnë besimit pravosllav dhe dihet që 70% e tyre nuk besojnë në Zotin e pravosllavëvet. Myslimanët e Bosnjës poashtu 70% ka kohë që nuk i falen Allahut. Megjithkëtë, kjo ndarje, në të vërtetë, e paqenë, fetare po e asgjëson atë popull. Sërbët dhe malazezët po vrasin. Po vrasin fëmijë, të cilët, megjithse ndoshta janë të regjistruar si myslimanë, sipas rregullavet nuk i takojnë asnjë religjioni, sepse dei në 18 vjeç çdo qenie njerëzore konsiderohet e pamaturuar mendërisht... Pamja e dytë është ajo në Kosovë, e djeshmja dhe e sotmja. Këto ditë rrjeti social i internetit ka zbardhur vetëm një pjesë të vogël të genocidit sërb e malazias mbi shqiptarët. Është aktualizuar vetëm periudha nga viti 1912 deri në vitin 1947. (Ne ju lutemi ta lexoni prapë, edhe 2 herë, edhe 4 herë, atë njoftim më se rrënqethës!) I kanë asgjësuar pamëshirshëm dhe po përgatiten që edhe pasardhësit e tyre t'i asgjësojnë në të njëjtën mënyrë. Ekziston për atë vepër një plan lufte me emrin ***"Potkovica".*** I quajnë irredentistë, i quajnë separatistë, i quajnë terroristë. Quajnë shqiptarët e Kosovës terroristë, në një kohë kur 80% e vrasësvet të atyre shqiptarëve jeton në Beograd. Jeton dhe gëzon aty të gjitha të mirat materiale, shpërblim për një të kaluar jonjerëzore.

Bota do të duhej t'i kishte të shëndoshë organet e të parit e të dëgjuarit, dhe vetëdijen të shëndoshë, dhe ndjenjën njerëzore, që të gjitha këto të mund t'i vlerësojë kthjellët dhe me vërtetësi.. Por, për fat të keq, as njerëzimi i sotëm nuk po i ka ato që më së shumti do t'i duheshin.

Riston e pyetën të nesërmen a ish njohur me këtë artikull. ***"Jo."*** Tha Ristoja. ***"Nëse do të lexoja çdo gjë që shkruhet në internet-kafanë, do të detyrohesh gjithë natën ta kaloj atje."*** Gazetarët tentuan t'i marrin diç më tepër, por Ristoja, me hapa të shpejtë, u fut në ndërtesë.

Në 2 ditët e tjera në Gugëll-internet temën kryesore e zinte pyetja: Kush ishte në të vërtetë ai Armando Bovino?! A ish vërtet italian, siç mund të shikohet nga emri,

apo dikush tjetër fshihej prapa atij emri?! A kish ai artikull lidhje me tashmë të njohurin vargun popullor: ***"O Sërbi, o nëna ime, edhe e verbët, edhe e shurdhët!"*** dhe a konstatohet po kjo gjendje tragjike e pandjeshmerisë njerëzore edhe te popuj të tjerë, përveç te sërbët?!

NË DUART TONA

Seanca tjetër e rregullt dëgjimore me të pandehurin, nuk i solli hetuesisë asgjë të përcaktuar, që do të mund të merrej në konsideratë gjatë gjykimit. Stevani llafosej pa u penguar, sikur të gjendej në një pritje. Në të vërteë, siç po konstatonte Ristoja, jo vetëm i pandehuri i tij, vrasësi i trefishtë, Stevan Jovanoviqi, nuk ishte më në duart e tija, por krejt burgu po sillej si i pavarur prej hetuesisë, i pavarur prej drejtorisë së burgut, madje i pavarur edhe prej vetë shtetit. Edhe vetë drejtoria e burgut , i dukej Ristos, qe vënë në anën e të burgosurvet, duke plotësuar gati çdo kërkesë të tyre, deri edhe dhënie lejesh të posaçme për të shkuar deri në shtëpi dhe për t'u kthyer. Stevan Jovanoviqi, në atë burg, pa dyshim luante rolin udhëheqës. Mbante rregullisht fjalime, duke bërtitur me zë gjëmimtar që prapa hekuravet. Të burgosurit dhe të paraburgosurit, që mbaheshin në dhoma të mëdha, me grupe, ku nganjëherë bëheshin edhe nga 25 vetë, u jepnin urdhëra gardianëvet të hapnin dyert kur Stevani mbante fjlaime. E dëgjonin udhëheqësin, duartrokisnin, bërtisnin, pastaj, kur Stevani mbaronte, kështilloheshin qetas për të ardhshmen. ***"Je bërë si një harambash në këtë podrumin tonë."*** I tha Ristoja. ***"Po. Ata janë djelmoshat e mi."*** Iu përgjegj Stevani. ***"Vendosim së bashku për çdo gjë që na duhet." "Domethënë, krejt bota është në duart tuaja."*** Desh të shprehet me ironi Risto Kilibarda, por mori një përgjigje krejt të papritur: ***"Krejt bota është në duart tona."*** Deklaroi fare natyrshëm Stevani. ***"Ne e udhëheqim Sërbinë, Sërbia udhëheq botën. Evropa është e detyruar të plotësojë çdo kërkesë tonën. Kina është krahun tonë. Bota e Tretë është krahun tonë. Ne i vrasim myslimanët, shtetet myslimanë janë miqtë tanë më të sinqertë. Amerika nuk guxon të na kundërvihet, sepse, sa herë të na teket, e mbledhim Këshillin e Sigurimit." „E marrim me mend."*** (Ristoja duhej t'u përshtatej sjelljevet të Stevanit.) ***„E marrim me mend që Amerikës dhe Kinës u teket të na kundërvihen?" „Në rast se do të na kundërvihej Kina, ne edhe miqtë tanë kemi një varg mundësish që ta dëmtojmë themelisht. Kemi Tajvanin, kemi Tibetin, kemi ujgurët." „Po kundër SHBA-së çfarë armësh mund të përdorim?" "Amerika nuk guxon të na kundërvihet. Por në qoftë se ajo do të guxonte të na fyejë në çfarëdo mënyre, edhe ne do të dimë si t'i bëjmë ballë. Kemi ne në SHBA mbështetje mjaft të fuqishme." "Hall ju qoftë!"*** E përgëzoi me sarkazëm hetuesi. ***"S'do mend, hallall na qoftë! Por ti shumë shpejt do ta marrësh edhe pjesën tjetër të shpërblimit."***

Milicët ia vunë prangat. Stevani, në çastin kur po mbyllej dera, shtoi me zë kërcënues: ***"Do ta marrësh edhe ti shpërblimin! Si të gjithë shqiptarët!"***

QURRA DHE LOT

Fragment nga artikulli ***"QORRE KJO BOTË". "Lajmi që 80% e beogradasvet ishin të lidhur, drejtpërsëdejti ose tërthorazi, me vrasjet në territoret ku jetonin shqiptarët, nuk do t'i habiste analistët. Ata do ta dinin që ata njerëz i ka vrarë dikush. Do të dinin që dikush i ka masakruar ata qindra mijë banorë. Dhe në fund, do të dinin që ai dikushi rron diku. Vrasësit e asaj mase të vrarësh kanë ekzstuar realisht. Kanë bërë krim. Kanë vrarë, mbytur, djegur, copëtuar, hedhur në puse, hedhur në ujë, kufomat mbuluar me të shpejtë me gjithfarë materialesh, dhe janë kthyer në shtëpitë e veta që të kujdesen pa u penguar për familjet e veta. Të gjitha këto analistët do të mund t'i pasqyrojnë, sapo të njiheshin me përmbajtjen e Arkivit të Stevan Jovanoviqit. Arkivi i Stevan Jovanoviqit ishte përsosurisht transparent. Madje edhe sikur të publikohej regjistri i autorëvet të atyre vrasjeve, me emrat dhe llagapet e tyre, për analistët ajo nuk do të përbënte asgjë të jashzakonshme. Shteti jugosllav i kish arsyetuar qysh më përpara që të gjithë ata operacione ushtarakë e joushtarakë dhe nuk mund të pritej që po ajo Jugosllavi të nxirte para gjyqit kryerësit konkretë të atyre operacioneve. Jugosllavia u ishte mirënjohëse kryerësvet të zellshëm të urdhëravet të caktuar ushtarako-shtetërorë, sado që ata urdhëra të ishin jonjerëzorë. Ajo i ka dekoruar ata zbatues, në të vërtetë vrasës, i ka shpërblyer me grada dhe me medalje, i ka emëruar në poste me përgjegjësi në administrate, u ka lidhur pensione në kushte shumë të favorshëm. Krejt këto analistët do t'i kuptonin mirë.***

E vetmja gjë që analistët ndoshta nuk do ta kishin të qartë, është kjo: Si ka pasë mundësi të ndodhë që prindët, vëllezërit dhe bijtë e atyre dhjetëra mijë shqiptarësh të vrarë e të masakruar, të jetonin në të njëjtin shtet me asgjësuesit plot 60 vjet dhe të mos ketë ndodhur as edhe një hakmarrje. 100000 baballarë, vëllezër e bij shqiptarësh të masakruar kanë jetuar në të njëjtën ngrehinë shtetërore bashkë me 100000 vrasës të bijvet, vëllezërvet dhe baballarëvet të vet dhe megjithatë nuk ka ndodhur as edhe një gjakmarrje. Nuk do të bëhej më pyetja, ç'popull është ai që vret. Do të bëhej pyetja, ç'popull është ai që duron. Pikërisht në këtë pikë analistët do të ndaheshin në 2 grupe. Njërët do të mendonin që populli shqiptar është një popull i pazhvilluar, i pavetëdijshëm, skajisht primitiv. Tjerët do të mbronin qëndrimin që populli shqiptar është njëri prej përfaqësuesve më të moçëm të kulturës evropiane.

Pjesa e dytë e enigmas, e cila do t'ua zinte shul rrugën analistëve, do të ishte pyetja: Si ka mundur të ndodhë e gjithë kjo në prani të Botës së Qytetëruar, dhe

kjo Botë e Qytetëruar të mos e ketë thënë asnjë fjalë për këto ngjarje kaq rrënqethëse?! Verbëria dhe shurdhëria e të quajturës botë demokratike ndaj një të këtillë holokausti të zbatuar në mënyrën më makabre, do të ishte skajish shumë shqetësuese. Do të arrinim kështu te një shkallë e atillë pasigurie, sa që analistët do të detyroheshin të shtronin edhe pyetjen: Bota e sotme e qytetëruar, e quajtura botë demokratike, që njëkohësisht duhet të jetë edhe botë humane, mos është e pavetëdijshme në qenien e vet dhe edhe sot e kësaj dite primitive dhe e pamoralshme, sa edhe të dikurshmit SODOMAS dhe GOMORRAS, të cilët Zoti i pat ndëshkuar me shfarosje?!"

Fill poshtë këtij artikulli, firmosur sërish me Armando Bovino, qëndronte, ndoshta për shkak të renditjes alfabetike, shkrimi me titull ***"Qurra dhe lot"***. Në analizën periodike të Gugëll-kompanisë doli që artikullin ***"Qurra dhe lot"*** e paskëshin klikuar 98% e lexuesvet, kurse artikullin ***"Qorre kjo botë"*** vetëm 2%. Kjo ishte ndoshta dëshmia më e freskët që, jo vetëm Sërbia, por krejt bota vazhdonte të mbetej edhe më tej e verbët dhe e shurdhët.

STEVAN, RUAJE SHËNDETIN

Stevanin e sollën përsëri të prangosur deri te zyra e Ristos. Ristoja, si zakonisht, dha urdhër që t'ia hiqnin prangat dhe filloi menjëherë, jo me pyetje, por me një lloj propozimi.

„Kam vendosur të të liroj. Do ta shkruaj akt-akuzën në atë mënyrë, që gjykata të jetë e detyruar të nxjerrë përfundimin se s'ka të dhëna që ti ke kryer ndonjë krim, dhe do të të lirojmë menjëherë." „Po shqiptarët kush i ka vrarë?!" Pyeti Stevani. ***„Dikush tjetër."*** Iu përgjegj Ristoja, duke mos dashur të hyjë në debate, ishin apo s'ishin shqiptarë viktimat e tija. ***„Pasi ti të jesh liruar, ne, si rregull, do t'i vazhdojmë hetimet. Ata hetime do të zgjasin disa muaj. Në pamundësi për ta zbuluar kryerësin e vrasjevet, gjykata do të jetë e detyruar ta mbyllë dosjen."***

Stavan Jovanoviqi nuk u pajtua kurrsesi me versionin e Ristos. E refuzoi me vendosmeri propozimin e tij, duke shtuar që, të këtilla prapaskena, janë cilësi vetëm e Kamarillës Shqiptare, dhe se Ristoja, në këtë mënyrë, e kish vërtetuar edhe njëherë që ishte shqiptar. ***„Të 3 bashkëkombësit e tu i kam vrarë unë, prandaj kam plotësisht të drejtë të kërkoj edhe meritat përkatëse. Më nxirrni para gjyqit dhe unë do ta proklamoj publikisht që i kam hequr qafet unë e jo dikush tjetër të 3 ata armiq potencialë të kombit tonë. Gjyqi do të më lirojë dhe ti do të më paguash dëmin moral edhe material."***

Ristoja u zemërua shumë nga fjalët e Stevait. Dha urdhër që ta prangosnin dhe që, bashkë me të, të shkonin në një tjetër këqyrje në vendin e ngjarjes. E rrasën në

makinën e burgut. Ristoja u ul, bashkë me Borkën dhe pjesëtarët e tjerë të ekipit, në xhipin e prokurorisë. Shkuan fillimisht te shtëpia e Stevan Jovanoviqit.

Stevani, krejt gjakftohtë, i rrëfeu të gjitha ato që kishin ndodhur atë mëngjes. Se si më parë, e kish goditur Jasminën, ndërsa ajo ishte ende në gjumë, se si ish ngjitur në katin e dytë dhe vrarë atje, me sëpatën e gjakosur, Predragun, se si pastaj kish arritur ta ndalë edhe Svetllanën, e cila qe nisur të hidhej nga dritarja.

Milicët e shoqëronin në çdo hap. Ristoja shkonte para tij dhe bënte pyetjet. Borka ndiqte me kujdes xhirimet, edhe të pyetjevet të Ristos, edhe të përgjigjevet të Stevanit, ndërsa kamera e prokurorisë po e përjetësonte vizualisht krejt përshkrimin e ngjarjes.

Vidosava kish pasë dalë prej shtëpisë së vet dhe kish kërkuar t'i afrohej Stevanit, por milicët nuk e kishin lejuar as të hynte në oborr. Ish krijuar zhurmë. Ristoja i qe afruar me ngut: ***"Të lutem, mos më detyro të shkel rregullat!"*** I kish thënë me zë miqësor. Vidosava ish qetësuar. I kish ndjekur me shikim lëvizjet e milicëvet dhe të Stevanit, i cili ecte krenarisht midis tyre. Në momentin e fundit u dëgjua porosia e saj: ***"Stevan, të lutem, ruaje shëndetin!"***

NUK KA EFEKT!

Nga vendi ku kish ndodhur krimi, grupi i makinavet të prokurorisë shkoi në Akademinë Sërbe të Shencavet e Artevet, në vendin ku autori i krimit kish pasë tentuar për t'i shmangur apo fshehur viktimat.

E shkarkuan të burgosurin para hyrjes së tashmë të njohurit Arkiv. Ristoja e pyeti Stevanin. ***"Përse tentove që viktimat e tua t'i futësh brenda kësaj ndërtese?"*** Stevani u përgjigj qetë edhe shtruar: ***"Këtu e kishin vendin. Të gjithë shqiptarët e vrarë ne i rrasim në këtë ndërtesë. Është një praktikë e jona tradicionale." "Por ju nuk sillni këtu trupat e viktimavet të asgjësuara."*** Stevani u lëkund pakëz, por sakaq e gjeti përgjigjen: ***"Ka këtu një lloj dallimi. Ne këtu depozitojmë letrat, në të vërtetë, dokumentet mbi asgjësimin e tyre të përgjithshëm. Depozitojmë njoftimet, fotografitë, pasqyrat përmbledhëse, filmat… Isha i tronditur. Mendova se ish e njëjta gjë."***

Ristoja u sigurua nëse Borka e kish xhiruar çdo gjë që u tha përpara arkivit dhe urdhëroi që Stevanin ta futnin brenda, që të mund të vazhdonte kqyrja. Hynë, në shoqërim të 3 milicëve të armatosur, Stevani, Ristoja, Borka dhe ndihmësmjeku, i cili po zëvendësonte Dr.Velko Velimiroviqin. Ish i pranishëm edhe drejtori i Arkivit, por roli i tij ishte i padomosdoshëm, sepse shpjegimet do t'i bënte vetë autori.

Stevani shpjegonte çdo gjë sipas rendit, duke demonstruar ashtu përvojën e vet të jashtzakonshme. ***"Këtu keni ndarjen ku pasqyrohet veprimtaria e përgjithshme e njerëzvet tanë që veprojnë në territoret ku jetojnë shqiptarë. Nëpunësit shtetërorë, punonjësit e administratës, punonjësit e arsimit, punonjësit e shëndetësisë. Që të gjithë ata kanë në terren rol të dyfishtë: Të kryejnë ose të bëjnë sikur po e kryejnë detyrën legale dhe detyrimisht të njoftojnë mbi çdo gjë që ngjet në mjediset e popullatës shqiptare.***

Kjo këtu është ndarja e shërbimevet informative, nga vendet ku shqiptarët kanë emigruar: Turqi, Greqi, Itali, SHBA, Australi, Gjermani, Zvicër, Suedi… Secili vend ka raftin përkatës.

Këtu keni ndarjen e banorëvet me përkatësi nacionale sllave në të quajturën Shqipëri. Ata punojnë, shërbejnë, rrojnë, mund të merren me çfarëdo pune në atë shtet të vogël, por, qoftë me vetëdije, qoftë pa vetëdije, ata janë të obliguar t'i shëbejnë atdheut, dmth Sërbisë. Ne kujdesemi që njerëzit tanë në atë shtet të vogël, të zënë pozita sa më të përshtatshme, psh të punësohen nëpër minisrira, në institucione të ndyshëm kulturorë, në mënyrë që t'i vlejnë sa më shumë atdheut tëtyre, Sërbisë, duke rrënuar në atë shtet fare të vogël çdo gjë që është pengesë për ne. Këto janë dosjet e Tiranës, këto janë të Shkodrës, të Korçës, të Peshkopisë, të Kukësit. Kudo ku ka një nënshtetas të atjeshëm, i cili nuk ndjehet shqiptar, ne sakaq e fusim në kllapa. Zotërinj, kjo është një veprimtari e vazhdueshme, shumë e frytshme e njëkohësisht shumë e shtrenjtë, e shtetbërjes sonë që nga Mesjeta e këndej. Parimi ynë kryesor është: Nëse jemi të detyruar ta pranojmë ekzistencën e atij shteti të vogël me emrin Shqipëri, atëherë ai shtet le të jetë sa më i dobët, në mënyrë që një ditë të mund t'i çlironim edhe ato krahina.

Këtu keni korpusin e stërmadh të të pakësuarit masiv të shqiptarëvet. Kush vjen këtu, fiton përshtypjen që s'ka mbetur më shqiptar i gjallë në botë.

Stevani papritur filloi të thërrasë: ***"Thjeshtë fare: NUK KA EFEKT! Nuk bën dobi! Ne i vrasim, ata shtohen! Na e kanë zaptuar Beogradin! Efekti është zero! Nuk..."*** I ngeci fjala. ***„Nuk ka shpresa! Nuk ka shpre-sa!"***

Shikimi i Ristos u takua me shikimn e zëvendësuesit të Velkos. Grykësja e tij e bardhë dhe çanta, ishin dëshmi që, megjithatë, kish rrugëdalje. Milicët i neutralizuan duart dhe këmbët e Stevanit. Ndihmësmjeku injektoi në muskujt e krahut të Stevanit ilaçin e duhur.

Iu desh të prisnin rreth gjysmë ore, që Stevani ta merrte veten dhe ta vazhdonin këqyrjen.

PROVO, NË QOFSH TRIM!

"Këtu keni ndarjen e pakësimit numerik të shqiptarëvet. Pakësimi me shumicë. Që do të thotë, asgjësim masiv dhe pa numër i atyre popullatave. Etiketat i kam shkruar unë një për një me dorën time. Spastrimi masiv i Prokuples. Numri i të vrarëvet, të djegurvet, të therurvet. Spastrimi masiv i Medvegjës. Secili fshat ka dosjen e vet. Për shembull, qe njëra prej tyre: Shillova. Pogromet tanë nëpër Drenicë. Shfarosja e fshatarëvet të Bihorit. Dimër, 1943. Vetëm fëmijë të Bihorit, çuar në vdekje, 1853 copë. Bistrica e Pejës, e turbullt dhe e qelbur kufomash të kalbura. Qyteti i Uroshit që ata i thonë Qyteti i Ferizit, varr shqiptarësh. I keni edhe shifrat, kurse brenda janë listat emër për emër. Qyteti Bitol që ata i thonë Manastir, bashkë me rrethinat. Ai krah tashmë është spastruar. Kasaphanë meshkujsh të të gjitha moshave, Zajaz pranë Kërçovës. Kasaphanë rekrutësh. Pranë Shkupit, rreth 500. Në Tivar, disa mijë. Pranë Triestes, mbytje me gaz, domethënë helmim duke u larë nën dushe, si në dhomat e gazit. Suharekë, gjitharat nëna të shqiptarëvet. Vepër e djelmoshavet tanë. Podujevë, tufa korbash mbi trupa të kalbur shqiptarësh. Të gjitha etiketat i kam shkruar vetë me dorën time.A mund të ecim më tutje?"

Ristoja kalonte përpara raftevet dhe lexonte etiketat kalimthi. Në shpinat e dosjevet të trasha ishin shkruar me një dizajn elegant emrat e të gjithë qyteteve shqiptarë me gjithë rrethina. Në disa raste, me të njëjtin emër qenë rreshtuar edhe nga 4 dosje. Duke dalë nga njëra e ndarë, Ristoja lexoi edhe njëherë mbishkrimin sipër raftevet: ***„ASGJËSIMET MASIVË TË POPULLATAVET SHQIPTARE".*** Titulli i dollapit të fundit ishte: ***„Lista e atdhetarëvet sërbë, të merituar. Shpërblimet, dekoratat, mirënjohjet." "Këtu e kam vendin edhe unë."*** Tha Stevani, pastaj vazhdoi më tutje:

"Këtu keni tash ndarjen, ku mund të lexoni ndëshkimet një nga një të PRIJËSVET të ndyshëm shqiptarë. Përshkrimi dhe njoftimet. Pagesat për secilën vrasje. Vrasja e Azem Galicës, të quajtur Azem Bejta. Ai Azemi ka pasë tërhequr pas vetes nëpër pyje e nëpër male edhe të shoqen. Dosja mbi vrasjen e Isa Boletinit dhe të shpurës së tij, në Podgoricë. Vrasja e Dedë Gjo Lulit. Vrasja e Stefan Gjeçovit, që ata i thonë Shqefën. Vrasja e Mustafa Qullit dhe shokut të tij Çerçiz Topullit. Bjerrja e Osos, domethënë Osman Kukës në Vraninë. Bjerrja e Bajram Currit në një shpellë. Atë e ka neutralizuar Ahmet Zogu, paguar prej nesh, i cili më vonë në mënyrë të pabesë dhe të pandershme e ka tradhtuar qeverinë tonë. Vrasja e Ramë Sadrisë. Të dhëna të plota. Vrasja e Mehmet Konjuhit. Vrasja e Mehmet Shpendit. Gjeto Coku. Bajram Daklani. Jakup Feri. Zenel Gjoleka. Hasani nga Prishtina. Haxhi Zeka nga Peja. Shaban Polluzha. Jusuf Gërvalla. Enver Hadri. Ali Hadri. Përballë këtyre rafteve, ka dosje edhe

njëherë kaq. Por duhet ta kuptojmë njëherë e përgjithmonë: Sado shumë që të vrasim një e nga një, ata nuk do të mund t'i shfarosim kurrë. Është e domosdoshme që, krahas asgjësimevet në masë dhe dëbimevet, të përdoren edhe mjete të tjerë modernë: kimia, bakterologjia, deri edhe intervenimet me armë atomike! E pse jo?!

Këtu keni të ndarën e shpërnguljevet të shqiptarëvet për në Turqi, për në shtetin e vogël Shqipëri, dhe në vitet e fundit drejt vendevet të Perendimit, në gjithfarë formash. Gjithë këtë hapësirë unë e kam quajtur: Galeria Fshesometër". (Ristoja lexoi mbishkrimin ***„METLOMER-GALERIJA"***). ***„Metodën e pastrimevet, të fshirjevet me fshesë,"*** vazhdoi Stevani, ***„e kanë përdorur shumë shtete, për shembull Turqia, Greqia, por shprehjen ‚metlomer-galerija' jam unë i pari në botë që kam përdorur. Fshesa është vegla e pastrimit. Pas shembullit të fjalëvet të përbëra: ujëmatës, nxehtësimatës, avujmatës, kjo fjalë e përbërë na përcakton probabilitetin e fshesës. Kjo pra është , siç edhe shikohet, një galeri, një korridor i thellë nëntokësor. Në këtë krah janë të rreshtuar raftet me të dhëna mbi përzënien e shqiptarëvet, mbi spastrimet e territorevet tanë prej racës së shqiptarëvet. Dosjet janë të renditura sipas vitevet."*** Ristoja lexoi: 1877, 1878, 1912, 1913... ***„Në krahun e djathtë të galerisë,"*** tërhoqi vëmendjen Stevani, ***„kemi të dhënat mbi gjendjen: sa shqiptarë kanë mbetur ende në territoret tanë. Këto të dhëna, deri para 2-3 vjetësh, kanë qenë tepër brengosëse. Mjaft të përmendim numrin e banorëvet, i cili, deri në vitet që i përmenda, ka qenë vërtet alarmues në shtetin e vogël të ashtuquajtur Shqipëri. Atje numri i banorëvet kish arritur gati 4 milionë. Por, për fatin tonë dhe për meritën tonë, gjendja u përmirësua shpejt dhe dukshëm: Prej asaj Shqipërie vitesh të fundit kanë ikur më shumë se 2 milionë shqiptarë. Këto këtu janë dosjet e eksodit të tyre dramtik prej vitit 1990 e këndej. Ajo ikje e tyre ka qenë rezultat i njërës prej punëvet tona më dinake dhe më të suksesshme. Një gjysmë shekulli kemi punuar për atë qëllim... E tash po shpresojmë që së shpejti t'i përzëmë edhe nja 1 milion e gjysmë prej Kosmetit."*** Stevani u zhvendos në krahun e djathtë të korridorit. Mbi shpinën e secilës dosje ish shënuar numri i të dëbuarvet, i të ikurvet, i të shpërngulurvet. Në vazhdim ishin vënë në rresht një numër jo i pakët raftesh të zbrazët. Dukej se ishin të papërdorur. Stevani i tregoi me dorë: ***„Këta rafte i kemi përgatitur për shqiptarët që do t'i dëbojmë nga Kosmeti vitesh të ardhshëm. Rrethimi i planifikuar ushtarak, siç kam marrë vesh prej miqvet të mi, do të ketë formën e potkoit."*** Ristoja u kujtua që te të gjitha ndarje kish parë nga disa rafte bosh.

Stevani nuk dinte të ndalej. ***„Këtu keni të ndarën e analfabetizmit dhe të mosarsimimit. Na është dashur që, me një dokumentim të posaçëm, ta pasqyrojmë një gabim shumë të madh të komunistëvet tanë, e më së shumti të Marshallit Tito, i cili u pat lejuar shqiptarëvet shkollimin në gjuhën e tyre.***

Shikoni: Në Greqi nuk ka ndodhur kështu, sepse atje nuk ka arritur të triumfojë komunizmi. Duke lejuar shkollimin në gjuhën shqipe, i është bërë një padrejtësi e madhe Sërbisë. Arsimi dhe të shkruarit nuk do t'u shërbente shqiptarëvet për asgjë, veçse për të shumëfishuar banditizmin e tyre. Popujvet të egër nuk u ka hije, nuk u shkon për shtati kurrfarë shkollimi.“

„Mjaft!“ U dëgjua urdhëri i beftë i Risto Kilibardës. Tha ashtu, atëherë iu drejtua drejtorit të arkivit: ***“Kush i paguan gjithë këto?!”*** Drejtori ra ngushtë: ***“Epo, ne paguajmë.” “Kush ju?” “Ne.” “Mirë, ju, por kush ju paguan JU!” “Ne na paguan shteti.“ „Po mendoj...“*** U mundua Ristoja ta qartësojë dialogun me sa më pak tendosje nervash. ***“Po mendoj, nëpërmjet cilit institucion vjen paraja deri te ju?”*** Vetëm atëherë drejtori i ***„Arkivit të Stevanit“*** e kuptoi që do t'i duhej të përgjigjej pak më drejt: ***„Epo, vetëkuptohet, zoti hetues, krejt kjo kalon përmes Akademisë. Të gjithë këta fonde janë të ASSHA-së, tepër të rëndësishëm për hulumtimet shkencorë. Shkenca nuk mund të përparojë pa dokumente arkivorë.“***

Stevanin e vunë sërish në pranga, para se të dilnin jasht ndërtesës. Pastaj ekipi ngau me shpejtësi drejt të quajturvet ***„trarë“.*** Ristoja kërkoi që Stevani të çohej lart në zyrë.

“Ulu!” Tha prerë. ***“Hiqjani prangat!.. Uluni edhe ju!”***

Zotëroi një qetësi memece. Ristoja nuk u ul. ***“Të kam propozuar që të të liroj, sikur gjoja je i pafajshëm, gjegjësisht, sikur faji yt nuk është vërtetuar. Nuk pranove. Kërkove që të shpërblehesh.“*** U end nëpër zyrë pak sekonda, u kthye dhe vazhdoi: ***„Kurse tash jemi të detyruar ta zgjërojmë lëndën e hetimevet. Jemi të detyruar që në akt-padi të përfshijmë edhe Akademinë Sërbe. A e ke të qartë?! Nesër do të arrestojmë kreun e Akademisë Sërbe të Shkencavet dhe Artevet.”***

“E kam të qartë!” Tha Stevan Jovanoviqi. ***„Provo, në qofsh trim!”***

GËNJEN COFTINA!

Në të vërtetë, Ristoja e dinte fort mirë se nuk mund të zinte luftë me Akademinë. Gjithë ditën nuk qe i qetë dhe nuk e zuri gjumi thuajse gjithë natën. Herë shtrihej, duke u rrotulluar poshtë mbulesavet, herë çohej ndenjur, në një pizhamë me vija të gjëra, dhe shfletonte gjithfarë doracakësh të drejtësisë. Më në fund, afër mëngjesit, mezi fjeti. Kur u zgjua, kish kaluar ora 9.

Në xhamat e jashtëm, dritaret ishin të veshura me akull. Darinka dhe Cvetkoja kishin shkuar në punët e veta. Miquni, si përherë, fliste me veten, ulur afër

ngrohëses. Ristoja e piu një gotë qumësht me kafe, veshi pallton dhe e mbështolli qafën me një shall të trashë.

Kishte dëgjuar, para disa ditësh lidhur me një studim shkencor, botuar në një revistë kroate. E kish kërkuar atë revistë. Nuk e kish gjetur dhe i qe dashur „të shfletojë“ internetin. E gjeti studimin. I tha Borkës që ta printonte.

Ishte një studim i gjërë, i edituar në 3 vazhdime. Ristoja e kuptoi që të lexuarit e atij materiali, për të tepër të mërzitshëm, do t'ia merrte gjithë ditën, por e kish një plan konkret, i cili po e detyronte të mbërthehej pas karrikes.

Bëhej fjalë për një kinse kthesë në krejt shkencat e sllavistikës, të papritur dhe gjithsesi të çuditshme. Autori pohonte me këmbëngulje që sllavët, edhe të Jugut, edhe të Lindjes, edhe të Perendmit, një pjesë të rëndësishme të kulturës e kishin marrë prej banorëvet të Ilirisë. Arsyetimi ishte mjaft i zgjëruar, i mbështetur kryesisht në disa fakte historikë të patrajtuar deri tani, gjegjësisht fakte të nënvleftësuar. Qëndrimi i tij ishte i vendosur dhe i palëkundur: ***"Gjuhët e sllavëvet nuk mund të studiohen duke u nisur nga vetë gjuhët sllave. Shkenca e sllavistikës, që të jetë e suksesshme, është e detyruar të bazohet te gjuhët më të vjetra të Evropës."***

Ristoja, atë pjesë të shqyrtimit e lexoi me njëfarë interesimi. Iu duk sikur autori kish gjykuar njaft arsyeshëm. Por kur kaloi te pjesa etimologjike e artikullit, duke qenë se s'ua kish fare haberin ligjësivet gjuhësore fonetike, jo vetëm që po e lodhte të lexuarit, por gradualisht edhe po nervozohej.

Fjalët në gjuhët sllave renditshin njëra pas tjetrës, duke u shpjeguar, nga ana e autorit, me gjuhën e sotme shqipe. Ristoja nuk e njihte gjuhën shqipe, prandaj detyrohej t'i pranonte pohimet e shkencëtarit apriori, sikur vërtet ish ashtu. Kjo e rëndonte shumë Riston, sepse nuk ish mësuar të pranojë qoftë edhe mendimin më të rendomtë, pa iu mbushur mendja. Megjithatë, e detyroi veten ta lexonte krejt ç'ish shkruar aty.

Fjala e parë ishte ***BALEGA***, sepse renditja qe bërë sipas alfabetit. Sqarohej me fjalën shqipe ****balëgë***, ndërsa Ristoja bëri aty për aty pyetjen: Pse të mos kish qenë kjo fjalë më parë sllave dhe pastaj ta kenë marrë shqiptarët prej sllavëvet? ***BARZAST***, shqip: ****i bardhëzë***. ***BDETI***, shq. ****me bdi***. ***BIGAR***, shq. ****mbi gur. BILJKA***, shq.****me mbi***. ***("Gënjen cofëtina!") BLATO***, shq. ****baltë. BLAVOR***, shq. ****bullar***. ***BOS***, shq. ****bath***. (Ristoja e lexonte: "***b-a-t-h***", prandaj nuk i përputhej kurrsesi me sërbo-malazezishten: „***bos***".) ***BRAV***, shq. ****berr.*** („***Gënjen cofëtina!") BREG***, shq. ****mb(ë)reg. („Gënjen cofëtina!") BREME***, shq. ****e barme. BREZA***, shq. ****bardhëzë***.

Në tekst kish plot shpjegime, por Ristoja nuk i kuptonte. Lexonte vetëm titujt dhe krahasimet e shkurtër me gjuhën shqipe. Deri edhe fjalën ***albanski (shqip),*** nga padurimi e thoshte: ***alb.***

BRIGA, shq. ****me bre. BUJATI***, shq. ****mb(ë)ujë***. Germa ***ë*** (e me 2 pika) po e bezdiste më së shumti, sepse s'ia kish haberin fare si duhej shqiptuar. ***BUJOL***, shq. ****mb(ë)ujëlë***, e shqiptoi: ***mbe-u-je-le. BUJON***, shq. ****mb(ë)ujënë***, e shqiptoi: ***mbe-u-je-ne***. Nuk e kish të qartë as në sërbo-malazezishten, ç'kuptim kishin këto 2 fjalë. ***BUNAR***, shq. ****me bunue. („Gënjen cofëtina***! Kjo fjalë është thjeshtë sërbe e malaziase.") ***BUS,*** shq. ****butësë. („Bu-te-se. A ka lidhje me autobusin? Ah! Por kjo është një copë dhe! Nuk ka fare lidhje me mjetet e transportit. Më vraftë Zoti, me çfarë jam i detyruar të merrem!") CILJ***, shq. ****me qëllue***. (U përpoq ta shqiptonte: ***me kue-lue***". Pastaj, i mërzitur tha me vete: „***As edhe një gjë s'po e marr vesh!") DIM***, shq. ****tym. (Tim, në gjuhën tone, ekip futbolli. Nuk ka kurrfarë kuptimi.") DINAR,*** shq. ****dhi. ("D-h-i. Ose jam unë budalla, ose ai autori I artikullit është njëfarë fantazisti!") DLETO,*** shq. ****dalëtë, ("da-le-te"). DRHTATI***, shq. ****dridh(ëh).*** E shqiptoi: ***„dri-d-h-e-h")***

Si dhe në shumë raste të tjerë, kish edhe këtu krahasime me gjuhën ruse. Ristoja sërish nuk po arrinte ta kuptonte, as ta pranonte, se si gjuha shqipe do të mund të arrinte deri në Rusinë e largët.

DRUGA, shq. *dru. ***(„Ç'mund të jetë kjo druga?") DRVO***, shq. ****dru. („Gënjen cofëtina!") FRULA***, shq. ****me fry*** (Ristoja u mundua të shqiptojë: "***me fri, me fru***". Nuk u kënaq as me njërin shqiptim, as me tjerin. ***"Në qoftë e vërtetë që dikur kemi qenë shqiptarë, pikërisht kjo do të ketë qenë arsyeja që e kemi braktisur atë gjuhë.") FRUS,*** shq. ****fruth, ("fru-t-h"). GRABITI***, shq. ****(kë)rrabë, ("ke-ra-be"). ("Qe, edhe në rusisht!")***

Hoqi pisërinë, deri sa, më në fund, ia doli ta lexojë krejt atë listë fjalësh, për të cilat autori ngulmonte që mund të shpjegoheshin vetëm me gjuhën shqipe. Sipas autorit, kjo ishte njëra prej dëshmivet më të parrëzueshme se iliro-arbërit kanë qenë një faktor tepër i rëndësishëm në përhapjen e kulturës evropiane midis sllavëvet.

Shumicën e atyre etimologjive Ristoja e shoqëronte me shprehjen e tij tashmë standarde: ***"Gënjen cofëtina!")***

GRLO, GROB, HLJEB, HRANA, HVALA, KACA, enë që malazezët e përdorin përditë, ***KIŠA, KLAS, KLJUN, KOLENO, KRAJ. ("Gënjen cofëtina! Si është mundur të merret si huazim kjo fjalë e jona kaq e zakonshme ?!") KRUH, KUKURUZ, LAKAT. "Zot na ruaj prej kësifarë pseudoshkencëtarësh!" NEDJELA, ORAH, OTAC,*** shq. ****atë. "Qe tash edhe PLLANINA, fjalë me***

prejardhe shqiptare!" Pastaj ***PLEME, PRDA, RAME, RAVAN, RAVNICA*** e tj. ***REKA, RIJEKA*… *"Dhe s'mbeti ndër ne as edhe një fjalë vendi!" SENO, SIJENO, SLAMA, STRANA, STROPOŠTATI SE, TATA, TETKA, VATRA*** dhe para fundit edhe ***VLAGA***, shq. ****me lagë***.

Me zor arriti t'i lexojë 5-6 fjalët e fundit. Ndjehej i shterruar përtej çdo kufiri. Megjithatë, vendosi ta marrë në pyetje të pandehurin edhe njëherë, gjatë natës. Nuk shkoi në shtëpi. I mbylli sytë gjysmë ore në kolltuk, porositi një kafe te dezhurni dhe, të zakonshmen e tij, një gotë raki rrushi. Borka mbërriti në kohën e caktuar. Dha urdhër që ta sillnin Stevanin, por i paralajmëroi që të ishin të vëmendshëm.

UNË NUK DI SHQIP

Ia vuri përpara artikullin e çuditshëm filologjik dhe e urdhëroi: ***"Lexo me zë!"*** Stevani filloi ta lexojë përtueshëm.

Borka shënonte me stenografi çdo gjë që thuhej, por në të njëjtën kohë incizoheshin të gjitha edhe auditivisht. Milicët u munduan të kuptonin për çfarë po bëhej fjalë. Por shpejt hoqën dorë. Rrinin të palëvizshëm në krahë të Stevanit dhe ngjanin me ca menekinë në shitoret e tekstilevet. Ndihmësmjeku, i cili zëvendësonte Prof.Dr.Velko Velimiroviqin, e ndiqte heshturazi të lexuarit e Stevanit.

Kaluan ashtu disa minuta. Stevani po e shqiptonte me ngathësi tekstin e printuar. Thjeshtë po belbëzonte. Ristoja e ndiqte te kopja e vet.

Në një çast, rrëmbimthi dhe me vendosmeri, Stevani pushoi së lexuari. ***„Për çfarë më duhen këto?! Kujt i shërbejnë këta budallallëqe?!" „Si po thua?!"*** E pyeti Ristoja, duke u shtirur i habitur. ***„A nuk je ti një specialist i këtyre punëve?! Ti je një filolog i jashtzakonshëm! Ke ngritur më këmbë krejt burgun, duke shpjeguar me sokëllima prejardhjen e qytetarëvet tanë!" "Kam thënë të vërtetën." "Hë pra, thuaje edhe tash të vërtetën! Na e shpjego a është fjala GRANICA fjalë shqipe?!" "Jo. Këtë unë nuk e pranoj kurrsesi." "Fjala PLANINA, fjala RAVNICA, fjala KRAJ, a janë fjalë me prejardhje shqiptare?" "Po gënjen!"*** Kundërshtoi Stevani dhe shtoi***. "Gënjen ti dhe ky që i ka shkruar këto fantazira. Gjuha sërbe është gjuha më e pastër në botë! Në këtë gjuhë nuk ka kurrfarë përzierjesh të huaja! Gjuha sërbe mbështetet në gjuhën starosllave." "Pra, ti shprehimisht po e mohon mundësinë që fjalët PLANINA, RAVNICA, KRAJ, dhe disa mijëra njësi të tjera leksikore të renditura në këtë shkrim, kanë farë lidhjeje me gjuhën e shqiptarëvet?!" "Unë nuk e njoh gjuhën e shqiptarëvet."*** Tha me zë të ulur Stevan Jovanoviqi. Ristoja e kish ditur qysh më parë që i pandehuri i tij nuk e dinte gjuhën shqipe, por qëllimisht po bënte të habiturin. ***"Ç'po na thua, pash***

Zotin!?" "Ja, ashtu. Nuk kam pasë dëshirë ta mësoj atë gjuhë egërsirash." "A nuk e njeh fare gramatikën shqipe, fjalorin e shqipes dhe shqyrtimet etimologjikë që lidhen me atë gjuhë?" "Ta thashë njëherë dhe nuk do të përsëris këtu gjithë natën: Gjuhën e shqiptarëvet nuk e njoh dhe nuk kam aspak dëshirë për ta mësuar. Ti, nëse të duhet, sepse, natyrisht, e ke gjuhën e gjyshërvet të tu, merri librat e Rugovës dhe mësoje!"

Ristoja brofi në këmbë, i rrasi të dyja duart në xhepat e pantallonavet dhe iu afrua Stevanit nga prapa: ***"Ma shpjego tash si ke mundur të zbulosh që llagapi vajzëror i bashkëshortes tënde është me prejardhje shqiptare!"*** Stevani tentoi të kthehet. ***"Këto m'i kanë shpjeguar shkencëtarët në Danimarkë dhe në Francë." "Dhe ti u ke besuar atyre, pa dyshuar se mos gënjenin?!" „Shkencëtarët nuk gënjejnë." "Pash Zotin!"*** Ristoja urdhëroi që aparati i incizimevet të kthehej atje ku ish përdorur fjala ***me gënjye***.

"Po gënjen!.. Gënjen ti dhe ky që i ka shkruar këto fantazira! Gjuha sërbe është gjuha më pastër në botë. Në këtë gjuhë nuk ka kurrfarë përzierjesh të huaja."

"Çfarë do të na thuash tani? A gënjejnë shkencëtarët?!" "Ata më kanë bindur me ato që m'i kanë thënë." Ristoja u kthye te vendi i vet. U ul dhe u mbështet me të 2 bërrylat mbi tavolinë: ***"I pandehuri Stevan Jovanoviq! Nuk ka asnjë thërrime të vërtete në ato ç'na ke thënë deri tash. E vërteta është krejt tjetër, kurse ti je i detyruar të na përgjigjesh pse i vrave: bashkëshorten tënde, djalin tend më të dashurin dhe vajzën tënde jashtzakonish të bukur! Na i sqaro të gjitha këto dhe le ta mbarojmë këtë punë qysh sonte!"***

Ky ishte qëllimi i Risto Kilibardës. Kjo ide i kish ardhur në mendje atë ditë në mëngjes: Ta akuzojë Stevanin, 3 herë vrasës, si një kriminel të çfarëdoshëm, duke hedhur poshtë çdo alibi mbi gjoja frymëzimin e tij patriotik. Në të vërtetë, Stevan Jovanoviqi ishte psiqikisht i çrregulluar dhe opinioni kurrsesi nuk duhej manipuluar me gjithfarë manovrash politike. Në këtë mënyrë, edhe ASSHA-ja shkarkohej nga përgjegjësitë e saja.

KOT TË JESH I VËMENDSHËM

Dita ishte dyfish më e ftohtë se e djeshmja. Rreth orës 8, Borka, milicët dhe ndihmësmjeku u shpërndan për në shtëpira. Ristoja ndenji edhe 2 orë në zyrë. E piu kafen dhe: 2, ndoshta 3 gota raki. Bëri muhabet me Momon. Momoja e informoi mbi zhvillimet e fundit në Beogradin e këtij mëngjesi të ngrirë akull. Kurrë më parë Beogradi nuk kish qenë i kapluar me një të këtillë koracë të akullt jetëvrasëse. Dukej sikur ai akull nuk do të shkrinte kurrë.

U çua. U vesh. Mori shallin.

"Ditën e mirë!" "Ditën e mirë! Ki kujdes rrugës! Ji i vëmendshëm kur të ngasësh makinën!"

Kur u fut në ashensor, Ristoja e shtiu revolverin në xhepin e djathtë të palltos. Xhepi i palltos stoftrashë ishte mjaft i thellë, ashtu që, nga jashtë, nuk mund të dallohej asgjë.

Qarkullimi ishte shumë i dendur. Në bulevardin kryesor në Terazie po bëhej një demonstratë. Masa e demonstruesvet po brohoriste zellshëm, por, se çfarë po kërkohej, nuk ishte ende e qartë, sepse ishin larg. Kur u avit, çdo gjë u sqarua. Demonstruesit po kërkonin mësymje mbi Kosovë dhe Metohi. ***„Kosmeti është i yni! Kosmeti është Sërbi!"*** Këto ishin 2 parullat e tyre kryesore. Midis pankartavet të shumta gjendeshin edhe tabela ku shkruhej me dizajn ngjyrash të forta ***„Djelmoshat e Stevanit".*** Ristoja tentoi të kthehet në të djathtë, në rrugën Nushiqeva, por e kish të pamundur. Iu desh të vozisë në të njëtin drejtim. Prapa njërës nga banderolat me shkrimin ***„Djelmoshat e Stevanit",*** shkruhej me shkronja të mëdha, bërë me dorë të lirë: ***„Vdekje Risto Kilibardës!"*** Atë parullë e mbanin 2 djem. ***„Turp të keni!"*** Murmuriti ashpër Ristoja dhe i vuri syzet e diellit. Me të majtën e ngiste makinën, të djathtën e mbante te revolja. E dinte që krejt kujdesi ishte i kotë, por megjithatë, gati pa vetëdije, sillej si në një film triller.

Vargani i demonstruesvet po mbarohej. Qarkullimi tashmë ishte rralluar. Papritur i fërshëlleu furishëm fare afër një mercedes i zi. Vozitësi frenoi qëllimshëm gjysmë metri tej Ristos, i nguli Ristos një shikim kërcënues dhe fërshëlleu sërish për nja 50 metra. Prapë frenoi. E priti Riston. Ia nguli shikimin edhe më të egër. Në të njëjtën kohë Ristoja pa që në krahun tjetër i qe afruar një tjetër mercedes i zi. Edhe ai vepronte si i pari. Frenoi, kërcënoi me shikim të ashpër në drejtim të Ristos dhe u largua, që ta prisnin diku më tutje të 2 mercedesët bashkë.

Ristos nuk i mbeti tjetër, veçse të ngiste në rrugën e vet, nëse do t'ia lejonin rrethanat. Ish krejt e kotë të ishe i vëmendshëm.

SI TË VEPROHET?!

Udhëheqësi i ***"Djelmoshavet të Stevanit"***, me nofkën Obren Careviq, u takua, në këndin e një restoranti luksoz të hotel ***"Moskës"***, me njërin prej akademikëvet më në zë. Nuk dihej a ishte i zgjedhur, i vetëzgjedhur, apo mbase i emëruar, por dihej që pikërisht ai, me emrin Obren Careviq, ishte udhëheqësi i më së resë organizatë të nacionalistëvet më të zjarrtë sërbë. Akademikut nuk i shihej as edhe një qime, as në kokë, as në fytyrë, përveç vetullavet, të cilat gjithsesi mund të ishin të

ngjyrosura. Obreni e shfrytëzoi rrethanën që të tregohej ndaj akademikut njëkohësisht edhe i lirë, edhe i afërt. ***"Profesor!"*** Tha ai. ***"Do të duhej të të shihja në ndonjë nudo-plazh, që të ta përcaktoja ngjyrën e flokëvet." "Në daç, mund edhe t'i zbërthej pantallonat."*** Iu përgjegj akademiku.

Erdhi kamerieri. Porosia ishte nga ana e Obren Careviqit. Kemerieri u shërbeu me të shpejtë aperitivin. U shkëmbyen edhe 2 apo 3 shaka, pastaj, pa humbur kohë, filluan bisedën serioze. Gjendja ishte më shumë se alarmante. Rezultatet e analizavet laboratorike, zbatuar në krejt Beogradin, ishin jashtë çdo parashikimi. Komunizmi kish bërë që, në Beograd , në periudhën prej 40 vitesh, të lindnin prej etërish shqiptarë dhe nënash sërbe aq shumë fëmijë, saqë tash numri i gjysmësërbë-gjysmëshqiptarëvet nuk mund të përllogaritej as përafërsisht. Dukej sikur më shumë kishin fjetur shqiptarët me gratë sërbe, se burrat e atyre grave. Çunat dhe gocat, lindur deri në vitin 1950, kishin tash edhe vetë fëmijë edhe nipër. Ata, të cilët ishin lindur pas 1970-s, bum i kopilëvet shqiptarë, ishin tash shumica studentë, madje, për dreq, midis më të mirëvet. Obreni dha shembullin e një shqiptari nga Tetova, i cili shiste gështenja e kikirikë para njërës prej kinemave kryesore të Beogradit. Ai shqiptar ka qenë çiftëzuar fshehurazi me të gjithë personelin femër të asaj kinemaje, pa prezervativ, dhe janë lindur prej tij plot 15 fëmijë. Ajo kinema kish qenë shndërruar, në ata vite, në një harem të një lloji krejt të veçantë.

Kategoria tjetër e gjysmëshqiptarëvet ishin shqiptarët prej vitesh të sërbizuar. Siç e kishin vërtetuar tashmë hulumtimet shkencorë, një numër i stërmadh (Careviqi e përdori qëllimisht shprehjen: ***i stërmadh***), një numër i stërmadh sërbësh, e veçanërisht malazezësh, janë me prejardhje prej arbërvet të dikurshëm. Që të mos turqizoheshin, ata u shndërruan në malazezë dhe në sërbë. Do Drekalloviq, do Llaliq, do Shekullarca, do Bukumiroviq, Gjonoviq, Gjokiq, Gjokoviq, Lekiq, Lesheviq. Beogradi është plot me të këtillë, sikur edhe të themi çerekshqiptarë, por gjithsesi sërbë me gjak jo të pastër. ***„Na ka dalë,"*** shtoi në fund Obren Careviqi, ***„që, në Beograd, na jetojnë më shumë kriptoshqiptarë, se sa shqiptarë të mirëfilltë në Tiranë. Ç'të bëhet me ta?!"***

LE T'U VIJË TURP

Pas mendimit të profesorit të Akademisë Sërbe të Shkencavet e Artevet, ASSHA, krejt ajo popullatë as mund të vritet, as të dëbohet. ***„Dhe nuk duhet madje as në publik të flitet shumë për këtë çështje. Ne duhet ta dimë. Ne kemi detyrë që krejt këto t'i studiojmë me hollësi, duhet të kemi listat e të gjithë këtyre banorëve, mundet, në raste të posaçëm, t'i thuhet në vesh njërit apo tjetrit individ, t'i***

sqarohet prej nga e ka prejardhjen, mund të zbatohen edhe dënimet aty-këtu, dhe çdo gjë përfundon këtu.“

„Në anë tjetër, ajo që ne mund dhe duhat ta propagandojmë gjërësisht, është që me këmbëngulje dhe në mënyrë të përditshme, të vëmë në dukje cilësitë negative të shqiptarëvet, ku i kanë dhe ku s'i kanë. Këtë e kemi bërë edhe deri tash, këtë duhet edhe ju, trashëgimtarët tanë, ta vazhdoni pa harruar. Pa e lënë pas dore. Ne e dimë që edhe shqiptarët janë popull si të gjithë popujt. Që edhe ata kanë cilësi edhe pozitive, edhe negative, si të gjithë popujt e tjerë. Por kurrsesi nuk na lejohet të shkruajmë për vetitë e tyre pozitive. Aq më pak për virtytet e tyre.“ ***„Marko Milanovi e ka shkruar librin 'Jeta dhe doket e shqiptarëvet',*** vërejti Obren Careviqi. ***„Marko Milanovi edhe vetë ka qenë një shqiptar.“*** Sqaroi akademiku. ***„Ai na është larë e lyer dhe ka kërkuar të na hyjë në zemër ne sërbëvet në mënyrën e vet. Ne do ta përmendim atë si një shkrimtar sërb, por librin e tij për shqiptarët nuk do ta zëmë në gojë thuajse fare. Fundja, edhe s'është kushedi çfarë.“***

Akademiku bisedonte, ndërsa Obreni hante dhe dëgjonte. Kur e kish fjalën Obreni, akademiku pa pushim punonte me pirun edhe me thikë. Kur do t'i përtypte njërën pas tjetrës disa copa mishi të pjekur, shoqëruar me pirunj sallate, kur krejt ato do t'i përcillte me gllënjka vere, akademiku do t'i fshinte buzët dhe do të fillonte sërish me instrukcionet e vet, duke i ilustruar edhe me shembuj veprimtarish konkrete.

„Para ca vitesh ne kemi organizuar njërën prej konfetencave tona shkencore në Cetinjë. Të gjithë ne, që merremi me këto punë, e dimë fort mirë që Cetinja dhe rrethinat e saja deri në shekulli XV kanë qenë banuar me arbër. Por kjo ne nuk na intereson. Ne na intereson që ta paraqesim si tokë sërbe shtetin që quhet Shqipëri. Në atë konferencë u verifikua dhe u vërtetua që krejt Shqipëria e sotme në Mesjetë ka qenë e banuar me sërbë. Shqiptarët aty paraqiten si blegtorë, si nomadë krejt primitivë, sërbët si një popull me nivel të lartë kulture. Kështu kemi punuar ne, kështu duhet edhe ju të punoni. 500 tituj librash të ndryshëm dhe broshurash kemi publikuar në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, madje në disa gjuhë, kundër shqiptarëvet. Në asnjërin prej atyre 500 librave nuk është folur mirë për shqiptarët. Në të njëjtën kohë, gjyqet tanë kanë shqiptuar kundër po atyre shqiptarëve dënime me burg që, marrë së bashku, bëjnë gjithsej 500 mijë vjet. Pra, shqiptarët, anembanë shtetit tonë, në 40 vjet të ekzistencës së Jugosllavisë Socialiste, kanë kryer 500 mijë vjet burg. Tani, çfarë po mendon ti? Si do të reflektojë kjo te këta beogradasit tanë gjysmëshqiptarë?! Këtyre do t'u vijë turp nga prejardhja e tyre dhe do të përpiqen që të tregohen sa më besnikë ndaj këtij kombi, ndaj kombit tonë, në të cilin kushedi se si janë gjendur. Synimi i tyre kryesor në jetë do të jetë, që të fshehin çdo lloj lidhjeje me paraardhësit e

tyre të përbuzur, të paraqiten si urrejtës të papërmbajtur ndaj shqiptarëvet dhe si adhurues të zjarrtë të Sërbisë.“

Obradi e shkundi edhe pikën e fundit të verës. Nuk po ia lejonte vetes të pinte, siç vepronte zakonisht në ambiente të tjerë. Në ambiente të tjerë atë e njihnin si një pirës të panginjshëm. Atje ai dinte t'i zbrazte brenda 1 nate edhe 15 shishe verë të kuqe. Dinte ta spastronte nga tryeza një gjysmë derri të pjekur, por sonte, me qëllim që të linte para profesorit përshtypjen e një djaloshi të matur, piu vetëm 1 shishe verë. E shkundi dhe tha: ***„Profesor, unë zakonisht i thaj nga 15 të këtilla, por sonte po më duhet të përmbahem për shkakun tënd.“ „E di“,*** tha profesori. ***„por megjithatë nuk do të na bënte keq edhe nga 1.“*** Porositën edhe nga 1 shishe verë. Profesori ishte i kënaqur. Darka e punës u mbyll me optimizëm. ***„Le të turpërohet prej vetëvetes secili shqiptar! Kjo është strategjia jonë permanente e propagandës.“*** E mbylli takimin përfaqësuesi i Akademisë Sërbe të Shkencavet dhe Artevet.

PARADA E NDERIT

Bora nuk shkriu për një kohë të gjatë. Në të gjithë vendet, atje ku nuk kishin kaluar borëpastrueset, bora praktikisht ishte kthyer në akull. Pritej një valë e ajrit të jugut, i cili do të depërtonte këndej nëpër Gjerdap dhe përpjetë Moravës, por kjo mirësi e klimës kish vonuar të vinte.

Në një të tillë situatë të akullt më keq e kishin lypësit dhe endacakët. Të përzënë dhe të përndjekur nga milicia, ata qenë detyruar të zhvendosen drejt periferisë, në thellësi të parqevet, por as atje, doemos për shkak të ftohtit të madh, nuk kishin mundur të stacionohen. Në atë mënyrë, masa e lypësvet, ulokëvet dhe sakatëvet, ish e detyruar ta kalonte natën në lëvizje.

Po i ngushëllonte vetëm një rreze e fatit, që, atë natë, ndodhej midis tyre edhe Sanija e bukur. Ajo, vjedhurazi, i kish ikur zonjës Vidosava Kërstiq-Jovanoviq. I kish shetitur thuajse të gjitha rrugët e qendrës së Beogradit. Thënë më drejt, ajo kish kaluar me vrap nga rruga në rrugë, duke kontrolluar fytyrat e pothuaj secilit kalimtar, se mos e gjente djaloshin që e kish përdhunuar i pari. Djaloshin që ajo e quante: ***DASHURIA E PARË***. Në fund, nuk ka ditur të kthehet dhe ka mbetur në shoqërinë e endacakëvet, siç i kish ndodhur edhe shumë herë të tjera. Te stacioni i trenit kish zënë dhe hequr ***VALLEN E BRANKOS***, tashmë gjithandej shumë të njohur. Aty ishin bashkuar jo vetëm lypësit, endacakët dhe jetëmët, por edhe një pjesë e mirë e udhëtarëvet që gjendeshin në stacion duke pritur trenat. Kish ardhur një çast, kur ajo valle, duke pasur Sanijen në ballë, kish marrë një pamje thuajse të madhërishme. Por, papritur, ka intervenuar milicia dhe vallja është shpërbërë.

Sanija ka ikur, që të mos përsëritej rasti i një nate të mëhershme, kur milicia e kish mbajtur në arrest në një nga podrumet më të ftohtë. Ajo natë kish qenë më e ftohta, por edhe më e papërballueshmja, sepse, me radhë e pa radhë, e kishin përdhunuar të gjithë rrjepacakët dhe hajnat e xhepavet, rrasur aty atë natë prej milicisë. Prandaj dhe iku, duke e mbajtur vrapin shumë larg, diku në thellësi të Koshutnjakut.

Ka tentuar të pushojë, por nuk ka mundur të qetësohet as 5 minuta prej të ftohtit. Ia ka nisur sërish të kërcejë e të këndojë: ***„Valle, Valle, rretherrotull, e harlisur, e furishme! („Kollo, kollo, naokollo, villovito, pllahovito!)“*** Lypësit dhe endacakët mezi kanë pritur që ta shoqëronin. Këndonin të gjithë, bërtisnin të gjithë, kërcenin të gjithë, pas ritmin të Sanijes. Ajo e tundte shaminë me dorën e djathtë, kurse me të majtën mbahej fort te një mjekërshtrembër, dorështrembë dhe këmbështrembër, një lypës, i tëri lëkurëzi. Lëkurëzi, jo se ishte zezak, por se nuk lahej me muaj e ndoshta me vite. E kish mjaft vështirë të duronte erën e qelbur të tijën, por parapë mbahej tek ai, sepse, nëse do ta lëshonte, krejt vallja do të copëzohej. Kohë mbas kohe lëshonte nga një britmë: ***„Këndoni, o lypës!“*** Nganjëherë melodia e saj do të pësonte shkëputje, do të ndërpritej, prej një ritmi shumë më të shpejtë, që shoqërohej me fjalët ***„Op, zhica-zhica!“*** Në ata raste edhe ajo ish e detyruar të lëvizte me atë ritëm, deri sa sërish të rikthehej te e saja melodi e pazëvendësueshme ***„Valle, valle, rretherrotull, e harlisur, e furishme!“***

Krejt papritur, në mes të atij koncerti unikal, u dëgjuan disa thirrje të thekshme prej thellësisë së pyllit: ***„O, ka vdekur njeriu i pasur!“*** Thirrja u përsërit shumë herë: ***„O, ka vdekur njeriu i pasur! O, ka vdekur njeriu i pasur!“*** Vrapuan të gjithë atje. Dëgjoheshin vetëm hapa të shpejtë. Dikush e kish një llambë dore. Sanija u tmerrua. Mbi borën e akulluar ishte shtrirë zoti Mirko Zvonar, avokat, të cilin zonja Vidosava e pat angazhuar për të mbrojtur fatkeqin Stevan! Ai rrinte me duar e këmbë të hapura, duke shikuar me sy të ngrirë degët e pagjethuara të pyllit dhe qiellin e qelqët. Sania e hoqi rrobën e vet dhe mbuloi me të trupin e Zvonarit. Ish një mënyrë veçanërisht solemne. 2 lypëse ia afruan këmbët njërën pranë tjetrës, duart ia kryqëzuan pëmbi parzma, fytyrën ia mbuloi Sanija, me, tashmë të njohurën në krejt Beogradin ***„Shaminë e Brankos“.*** Dikush propozoi që të lajmërohej milicia. Sanija ndërhyri vendosmërisht: ***„Duhet më parë t'ia bëjmë nderimet ne që jemi këtu!“***

Lypësit u rreshtuan rreth avokatit të vdekur dhe heshtën solemnisht. Njëra nga lypëset e hoqi pallton e vet prej supesh dhe mbuloi me të trupin gjysmëlakuriq të Sanijes. Dikush shprehu një mendim: ***„Të zëmë Vallen e Brankos përrreth tij.“*** Sanija prapë foli me ton të fortë: ***„Jo! Ai ka merituar shumë më tepër, kurse Vallja arrin vetë deri këtu. Ne nuk jemi të denjë për madhështinë e këtij njeriu.“***

Milicët e përshkuan pyllin me të thirrura dhe fishkëllima bilbilash. Endacakët dhe lypësit nuk u shpërndanë. Ata pritën të heshtur. U krijua sakaq kortezhi mortor. Në qetësinë e shurdhët, ajo paradë e pashembullt nderi, kaloi përmes pyllit, deri sa trupi i Mirko Zvonarit u vendos në makinën e spitalit. Sania nuk e këndoi më kurrë Këngën e Brankos.

KËRKIM NDJESE

Ristoja ecte shqetësueshëm nëpër zyrë, me të dyja duart të futura në xhepa. Zyra qe e zbrazët. Sa herë aty nuk ishte Momoja dhe sa herë nuk kishte seancë hetimesh, Ristos i dukej se zyra ishte e zbrazët. I dukej sikur aty s'kish njeri, edhe sikur Borka të ish e pranishme.

U ndal pak momente para dritares. E lëshoi shikimin përmbi pyll, një pyll i dendur dhe gjithmonë i trazuar, i cili shtrihej tutje, përtej territorit të burgut. Ndenji ashtu, duke përjetuar gjithë ç'mund t'i ofrojë njeriut një shikim mbi një pyll të madh, pastaj u kthye dhe u ndal ushtarakisht përpara Borkës, me duart në pozicionin gatitu.

"Borka, unë ty duhet të të kërkoj ndjesë!" Tha krejt papritur. Borka e pa më shumë se e çuditur. ***„Por për çfarë, të lutem?! Ne kurrë nuk jemi zënë! Madje as grindur!" „Nuk jemi zënë,"*** sqaroi Ristoja, ***„por unë duhet të të kërkoj ndjesë, sepse kam menduar gabim për ty."*** Borka u skuq. ***„Gjithmonë kam menduar gabim për ty!"*** Shtoi Ristoja***. „A do të mund të më falësh?!"***

PASTHËNIE

Mbi fatin e mëtejshëm të Stevan Jovanoviqit, Risto Kilibardës dhe pjesëmarrësvet të tjerë të këtyre ngjerjeve, nuk kemi mundur të marrim vesh thuajs asgjë. Në Kosovë, pikërisht atëherë, u shfaq Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Pas një hezitimi të gjatë, ndodhi, më në fund edhe ndërhyrja e NATO-s. NATO-ja i bombardoi forcat ushtarake sërbe dhe instalimet e ushtrisë sërbe. Kosova u shpall shtet dhe u pranua prej shumicës së shtetevet të botës.

I vetmi prej pjesëmarrësvet në këta rrëfimet tanë, i cili përmendet në ngjarjet e mëtejshme, është Obren Careviqi. Ai, në vitin 1999, therte njerëz nëpër Kosovë. Vitesh në vazhdim, është pare si ilegal në Mitrovicën e Veriut dhe në Zveçan. Shfaqet, gjithashtu, kohë pas kohe, edhe në Graçanicë, Deçan dhe në vende të tjerë të së quajturës ***"trashëgimi sërbe"*** fetaro-pravosllave, në shekuj perendi përdhosëse.

***

Gjokë Dabaj - Klos, 1984 - Durrës, 2013.

Publikuar te "***pashtriku-org***" në gjuhën sllave, 2013.

Përkthyer nga sllavishtja në shqip, tetor-nëntor, 2014.

SHËNIME SQARUES

1. ***"Kolo,kolo, naokolo!/ Vilovito, plahovito!"***

„Valle, valle, rretherrotull!/ E harlisur, e furishme!"

***

"Crnogorče, care mali, / ko te ovde još ne hvali!"

"Malazi, o mbret i vogël, kush këtu nuk të lëvdon!"

***

Janë vargje nga poema shumë e njohur ***„Kolo" („Vallja")*** e poetit sërb Branko Radiçeviq (Branko Radičević), ku himnizohet bashkëjetesa dhe bashkimi i sllavëvet të jugut, ide së cilës ia bënë varrin vetë sërbët. Boshnjakja Sanije dhe malazezi Miqun Kilibarda i shprehin reminishencat e kësaj „valleje" secili në mënyrën e vet, gjithsesi, tepër tragjike.

***

2. ***„Drzneš li dalj, čućeš gromove!"***

„Po guxove më tëhu, do të dëgjosh bubullima!"

Është një varg nga vjersha ***„Otadžbina" („Atdheu")*** i poetit patriot sërb Gjura Jakshiq (Đura Jakšić). Stevani e përdor këtë varg në delirin e tij tashmë patologjik.

***

3. ***"Ostajte ovde,/ sunce tuđeg neba neće vas grijati kao što ovo grije!"***

"Rrini këtu,/ dielli i qiellit të huaj nuk do të ju ngrohë siç ngroh ky yni!"

Vargje brilantë të poetit hercegovas Aleksa Shantiq (Aleksa Šantić). Mirko Zvonari i përdor këta vargje për sërbët, duke u thënë që dielli (i huaj) i Kosovës nuk mund t'i ngrohë siç i ngroh ky i tyre, i Sërbisë.

***

4."***Času meda još niko ne popi, što je časom žuči ne zatopi."***

"Got'n e mjaltit askush dot s'e piu, t'papërzier me gotë helmi."

Vargje të poetit malazias Petar Drugi Petroviq- Njegosh (Petar Drugi Petrović-Njegoš). Edhe këta vargje i përdor avokati Mirko Zvonar nën peshën e dëshprimit të vet të pafund.

***

5. ***"Istraga Poturica" ("Përndjekja e Turkoshakëvet",*** është emërtimi i një aksioni dhune e shfarosjeje, që kanë kryer malazezët pravosllavë mbi bashkëkombësit e vet të islamizuar në fillim të shekullit XIX. Stevani, me të drejtë, e konsideron luftën shfarosëse mbi muslimanët e Bosnjës si ***"Përndjekja e Dytë e Turkoshakëvet"***.

***

PËRMBAJTJA

1.Parathënia.

2.Vorbullat qiellore.

3.Nuk kam nerva.

4.Rrufa.

5.Mençuria (në vazhdime).

6.Për ç'lloj pisllëku është fjala?

7.Rutinë.

8.I pëlcet njeriut delli i ballit.

9.Vlerësimi visual i krimit.

10.Përcaktimi.

11.mos u bëni merak.

12.Shkallë e lartë zhvillimi.

13.Numrat 802 dhe 803.

14.Vallja e Brankos.

15.Kërdia.

16.Vrragat e së pares dashuri.

17.O tatë, të lutem!

18.Viktima pasionesh të shfrenuar.

19.Shansi i fundit dhe i vetmi.

20.Turp i padëgjuar.

21.Heroizëm në emër të atdheut.

22.Koktej brenda në varr.

23.Për hater të Darinkës.

24.Kë ka vrarë Stevan Jovanoviqi?

25.Turpi i radhës.

26.Në kulmin e Përndjekjes së Dytë.

27.Shesheli shqiptar.

28.Vargu i kriptoshqiptarëvet.

29.Zonja e zezë e dyzuar.

30.Përgatitjet.

31.Varrimi.

32.shembull i një humanizmi të përkorë.

33.Një e vërtetë e trishtueshme.

34.Profesioni ynë: Të bëhemi të bezdisshëm.

35.Thirrja e shtatëmiliontë.

36.Është dashur të martoheshe atje.

37.Një avokat inekzistent.

38.Nëpër fondet e një arkivi.

39.Megjithatë, jemi njerëz.

40.Edhe Karaxhiqi është i dyshimtë.

41.Shembull frymëzimi.

42.Debate rasti.

43.Dhe grindje.

44.Sërbëvet, ç'u mbetet tjetër?

45.Detyrimisht.

46.Politika më e mençur.

47.Na duhet të jetojmë.

48.Edhe ytatë i ka vrarë kushërinjtë e vet.

49.I biri i këngëtarit.

50.Bihorasit në kopshtet e fëmijëvet.

51.A mos jeni ju?!

52.Kam ardhur të takoj vrasësim tim.

53.Cimbaleviq, të lutem!

54.Kërvogradi.

55.Listat.

56.Copë truri. Tru jo i plotë.

57.Problem janë të gjallët, jo të vdekurit.

58.Diçka më të mençur.

59.Edhe kjo na duhej.

60.Ide gjeniale.

61.O Zoti im!

62.Gotat e vrerit.

63.Nuk kam komente.

64.Edhe të verbët, edhe të shurdhët.

65.Në duart tona.

66.Qurra dhe lot.

67.Stevan, ruaje shëndetin!

68.Nuk ka efekt!

69.Provo, në qofsh trim!

70.Gënjen cofëtina!

71.Unë nuk di shqip.

72.Kot, të jesh i vëmendshëm.

73.Si të veprohet?

74.Le t'u vijë turp!

75.Parada e nderit.

76.Kërkim ndjese.

77.Pasthënie.

78.Shënime shqarues.

79.Përmbajtja.

~~~~~~

GJOKË DABAJ: KRIZIS ARHIVARA (BEOGRADSKA HRONIKA)
~~~~~~

http://www.pashtriku.org/ngarkimet/dokumentet/Gjoke-dabaj-Krizis.pdf

~~~~~~

© Pashtriku.org, Dhjetor 2014
~~~~~~